



# PROJEKSIONE PËR NJË ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM

Rrjeti Shqiptar  
i Grave në Shkencë  
Qendra rajonale  
për zhvillim të qëndrueshëm

Revista - 1  
Shkurt 2018



**FRIEDRICH  
EBERT**   
**STIFTUNG**



RRJETI SHQIPTAR I  
GRAVE NË SHKENCË





RRJETI SHQIPTAR I  
GRAVE NË SHKENCË



**FRIEDRICH  
EBERT**  
  
**STIFTUNG**

**Revista**  
**PROJEKSIONE PËR NJË ZHVILLIM TË  
QËNDRUESHËM**

Botimi i parë

*Përgatitur nga: “Rrjeti Shqiptar i Grave në Shkencë”  
Qendra Rajonale për Zhvillim të Qëndrueshëm  
Mbështetur nga: Fondacioni “Friedrich Ebert”, Zyra e Tiranës*

Shkurt 2018

Botimi u mundësua nga:

Fondacioni “Friedrich Ebert”

Zyra e Tiranës

Rr. “Abdi Toptani“, Torre Drin, Kati 3-të, Kutia Postare 1418

Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 04 2250986 / 04 2273306: Fax: +355 04 22622067

[www.fes-tirana.org](http://www.fes-tirana.org)

Viti i Botimit: 2018

Përpunimi grafik dhe shtyp: Albdesign PSP

ISSN:

Publikimet e Fondacionit Friedrich Ebert nuk mund të përdoren për arsye komerciale pa miratim me shkrim.

# Përmbajtja:

faqe

|  |    |
|--|----|
| <b>Profili i rrjetit</b> .....   | 5  |
| Zhulieta Harasani, Koordinatore e Rrjetit Shqiptar të Grave në Shkencë   |    |
| <b>Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm - Analizë e kurrikulës së arsimit të mesëm e të lartë në Shqipëri</b> ..... | 7  |
| Prof.as.dr. Marjana Sinani, Dr. Evis Mastori, Dr. Albana Markja  |    |
| <b>Zhvillimi i qëndrueshëm dhe Ligji 80/2015 i Arsimit të Lartë për Kërkimin Shkencor në IAL</b> .....             | 21 |
| Prof. Dr. Anila Paparisto  |    |
| <b>Zhvillimi i qëndrueshëm nga këndvështrimi i shkencave të natyrës</b> .....                                      | 27 |
| Prof. Dr. Mimoza Hafizi  |    |
| <b>Çështje të reformës në drejtësi në projektionin e zhvillimit të qëndrueshëm</b> .....                           | 31 |
| Prof. Dr. Aurela Anastasi  |    |
| <b>Prindërit biologjikë – aty ku ligji mbështet shkencën (sfidat e testit të ADN-së)</b> .....                     | 36 |
| Prof. Dr. Arta Mandro  |    |
| <b>Projeksione rreth natyrës, bimëve dhe identitetit psikokulturor të shoqërisë</b> .....                          | 44 |
| Prof. Dr. Liri Dinga, M.Sc.Klarida Dushi, M.Sc.Kamela Mjeshtri   |    |
| <b>Projeksione dilema &amp; paradokse që shoqërojnë proceset e edukimit</b> .....                                  | 53 |
| Prof. As. Dr. Marjana Sinani   |    |
| <b>Sfidat e punësimit të rinjve në axhendën e zhvillimit të qëndrueshëm</b> .....                                  | 56 |
| Prof. As. Dr. Merita (Vaso) Xhumari  |    |
| <b>Thesare me monedha antike të gjetura në Shqipëri (shek. V-I p.e.sonë)</b> .....                                 | 64 |
| Prof. Dr. Shpresa Gjongecaj – Vangjeli   |    |
| <b>“Fjalor termash në Edukim” - Risi në fushën e Terminologjisë</b> .....  | 68 |
| Prof.dr. Mimoza Gjokutaj, Dr. Irida Hoti, Dr. Drita Kadriu   |    |



Zhulieta Harasani  
Koordinatorë

## Mirësevini në Forumin tonë! “Rrjeti Shqiptar i Grave në Shkencë” Qendra Rajonale për Zhvillim të Qendrueshëm

**P**rofili i rrjetit...

“Rrjeti Shqiptar i Grave në Shkencë”

Në kuadrin e Qendrës Rajonale për Zhvillim të Qendrueshëm, “Rrjeti Shqiptar i Grave në Shkencë”, përfaqëson një forum të pavarur në përbërje të të cilit janë gra me profile të spikatuara në fusha të ndryshme të kërkimit, studimit, krijimit, analizës, mësimdhënies, shërbimit publik etj. Ky grupim i pavarur, me vullnet të lirë dhe krejt autonom, gjëndet sëbashku për të ndarë mes tyre:

- Arritjet individuale,
- Problematikat në fushat ku ushtrojnë profesionet e tyre si Edukim/shkencat e edukimit, kërkimi i mirëfilltë, fusha e Jurispudencës, Kultura, Trashëgimia, Turizmi, Mass-Media, Mjekësia dhe Kujdesi për Shëndetin.
- Projeksionet personale për zhvillimet retrospektive dhe aktuale,
- Përthyerjen e problematikave të mirëfillta kërkimore në të përditshmen sociale,
- Identifikimin e pikëtakimeve mes fushave ku zhvillojnë kërkimin dhe veprimtaritë e hulumtimit,
- Sfidat personale përtej pozicioneve profesionale ku ushtrohen në të përditshmen e tyre.

### **Forumi në historinë e tij pesë vjeçare...**

Forumi “Rrjeti Shqiptar i Grave në Shkencë” fikson për datë të themelimit të tij, 10 Nëntor 2012, në Ditën Botërore të Shkencës, shpallur nga UNESCO. Përgjatë këtij pesë vjeçari, Rrjeti ka

organizuar disa takime tematike të qëllimta, dhe ka funksionuar në përmbushje të disa objektivave e fushave të shpallura nga UNESCO. Ndërkohë, anëtarët e këtij forumit kanë ri-konfirmuar nevojën për të qënë së bashku dhe për të vazhduar qëllimshëm takime me fokuse të ndryshme që vijnë si propozime të anëtarësisë së forumit. Kështu, në bashkëpunim me Projektin e Delegacionit European në 2014 “Rrjeti” ndërmori një analizë të të gjithë komponentëve zhvillimorë në “Strategjinë e Europës Juglindore 2020” dhe prezantoi sfidat që shtrohen përpara Shqipërisë sipas fushave të ndryshme të kompetencës së anëtareve të Rrjetit. Në 2015 në bashkëpunim me Ambasadën e Shteteve të Bashkuara në Tiranë, Rrjeti ka organizuar takimin me Astronauten Amerikane me qëllim promovimin e rolit të grave si krejt të afta edhe në profesione “të pamundura” për to, sipas paragjykimit tonë social. Në 20 dhjetor 2016, në kuadrin e përpjekjeve për arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qendrueshëm 2030, Rrjeti organizoi konferencën kombëtare me temë “Gratë në Shkencë përballë Sfidave të Zhvillimit të Qendrueshëm”, ku u referuan një sërë temash që varionin nga edukimi, punësimi, mbrojtja sociale dhe reforma në drejtësi. Kjo e fundit perceptohet si reforma më e rëndësishme e cila nëse zbatohet me korrektësi do të “çbllokojë” dhe një sërë ngërcesh në fusha të tjera me rëndësi ekonomike dhe sociale.

Në 28 shkurt 2017, Rrjeti zhvilloi takimin e radhës në qytetin e Pogradecit. Në këtë takim ku ishin të ftuar edhe përfaqësues të UNESCO-s, u bë një bilanc i punës së Rrjetit dhe u diskutua mbi drejtimit kryesore të punës në të ardhmen. Në kuadrin e promovimit të arritjeve të anëtareve të Rrjetit, në

---

ditën e dytë të takimit u promovua Fjalori “Termet në Edukim”, me autore anëtare të Rrjetit tonë nga Univeritetet e Tiranës, Shkodrës dhe Universiteti i Prishtinës.

Në vijim të vendimeve të ndërmarra në këtë takim lidhur me angazhimin konkret të anëtareve të Rrjetit në ndihmë të mësuesve të shkencave ekzakte, së fundmi në 10 Nëntor 2017, në bashkëpunim me projektin e EU “Ark of Inquiry” zbatuar nga UNESCO dhe NGO Greqi, 10 anëtare të Rrjetit morën pjesë dhe kontribuan në trajnimin e mësuesve të shkencave ekzakte nga Tirana, Durrësi, Elbasani, Shkodra, Lezha, Korca etj. si dhe kremtuan së bashku Ditën e Shkencës 2017. Kjo nismë do do thellohet më tej në vijimësi.

### **Forumi po krijon traditën e vet...**

Tashmë Rrjeti e ka bërë traditë që në të gjitha takimet e tij të evidentojë dhe të gjejë forma falenderimi dhe promovimi për anëtarët e tij dhe jo vetëm. Gratë, anëtare të rrjetit, të shkencës dhe kërkimit, përmes modelit të tyre kanë përçuar mesazhe pozitive. Gruaja shqiptare ka mundur t’ia dalë me sukses për një karrierë të spikatur në veprimtarinë shkencore, përmes punës së parreshtur për emancipimin e saj dhe të familjes së saj, duke përgënjeshtuar dhe sfiduar pengesa fizike, por edhe mentalitete negative. Emissionet televizive të cilat kanë vënë në qendër gratë e Rrjetit tonë kanë mundësuar përçimin e këtyre mesazheve dhe modeleve tek një audiencë edhe më e gjerë burrash e grash, vajzash e djemsh. Udhëtimi ynë vazhdon...

### **Forumi tashmë me një botim...**

Botimi që keni në dorë, fokusohet mbi dhe rreth çështjeve që kanë të bëjnë me zhvillimin e qëndrueshëm, por jo vetëm. Ky botim vjen në formatin dhe profilin e një Reviste, e cila shënon

numrin e parë të këtij lloji dhe të këtij rrjeti.

Botimi i Revistës, mundësohet përmes mbështetjes të Fondacionit “Friedrich Ebert”. Revista rrok një numër artikujsh të hartuar dhe përgatitur nga anëtarët e Rrjetit tonë, gra të përfshira në kërkime dhe veprimtari hulumtuese dhe shkencore, gra me profile të spikatura qytetare, dhe nëna të shqetësuara që të përditshmen e tyre e kalojnë mbi libra, në auditore, në institucionet e edukimit dhe shkollimit, në komunitete, aty ku jetohet e tashmja dhe projektohet e ardhmja jonë e përbashkët me sfidat e saj dhe pritshmëritë tona!



## Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm

# Analizë e kurrikulës së arsimit të mesëm e të lartë në Shqipëri

**A**rsimi i mesëm i lartë në Shqipëri ofrohet si *arsim i mesëm i përgjithshëm* (gjimnaz), *arsim profesional* dhe *arsim i orientuar*. Arsimi i mesëm i përgjithshëm (Gjimnazi) zgjat tri vite shkollimi. Arsimi i orientuar përfshin shkollat e gjuhëve të huaja dhe zgjat 3 vjet, ndërsa arsimi i mesëm për fushat e artit dhe sportit zgjat tre ose katër vjet.

Rerefuar statistikave të MAS (2015), Arsimi i mesëm i përgjithshëm (gjimnazi) ofrohet nga 497 institucione arsimore, nga të cilat 381 institucione janë publike, dhe 116 janë private. Afërsisht rreth 80% e nxënësve të këtij niveli shkollimi ndjekin gjimnazin. Në institucionet e arsimit të mesëm të lartë punojnë rreth 8670 mësues, numër që përfshin arsimin publik dhe privat. Arsimi i mesëm i lartë mbështetet në *Ligjin për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, Nr.69/2012, i amenduar Ligji Nr.56/2015*, Për disa ndryshime në Ligjin Nr.69/2012, dhe në përmbushje të *Strategjisë së zhvillimit të arsimit parauniversitar 2014-2020*.

Prej nëntorit të vitit 2013 e deri më sot, MAS ka ndërmarrë reformimin e kurrikulës së arsimit parashkollor, të arsimit bazë dhe të arsimit të mesëm të lartë. Reforma kurrikulare e gjimnazit ka nisur të implementohet në Shtator të vitit 2016 duke filluar me zbatimin e kurrikulës së re në klasat e 10-ta.

Në kuadrin e kësaj reforme, **Zhvillimi i qëndrueshëm përbën një nga drejtimit kryesore të ndryshimeve kurrikulare**. Në kurrikulën e re të reformuar, **Zhvillimi i qëndrueshëm dhe Mjedisi konsiderohen si tema kroskurrikulare**.<sup>1</sup>

<sup>1</sup>Temat ndërkurrikulare janë tema madhore me të cilat përballet shoqëria tani dhe në të ardhmen. Trajtimi i tyre synon përvetësimin e njohurive specifike, kultivimin e aftësive, vlerave e qëndrimeve të caktuara te nxënësit. Të tilla tema janë: identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave, mjedisi, zhvillimi i qëndrueshëm, zgjidhja e konflikteve, ndërvarësia, teknologjia dhe media. Temat ndërkurrikulare integrojnë fushat kurrikulare të të nxënësit, ndihmojnë nxënësit të interpretojnë botën dhe të rritin lidhjen

### Konteksti lokal i Edukimit për zhvillim të qëndrueshëm

Në sistemin tonë arsimor parauniversitar, Edukimi për Zhvillimin e Qëndrueshëm është paraprirë nga lëvizja për Edukim mjedisor. Lëvizjet e para drejt edukimit mjedisor u provokuan në vitet 2000 në mjediset shkollore nga vetë të rinjtë dhe shkollarët. Dy ndërhyrjet kapitale të realizuara deri më tani në fushën e edukimit mjedisor janë ndërmarrë në vitet 2000 - 2008 përmes “Paketës së Gjelbër”, dhe në vitet 2009 - 2013 përmes Programit “CLEEN” me filozofinë “Fëmija për fëmijën”. *Të dyja ndërhyrjet janë fokusuar kryesisht në arsimin bazë, ndërkohë që në arsimin e mesëm të lartë nuk ka patur deri më tani zhvillime të kësaj natyre.*

*Ligji për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, Nr.69/2012, i amenduar Ligji Nr.56/2015*, Për disa ndryshime në Ligjin Nr.69/2012, potencon Edukimin për Zhvillimin e Qëndrueshëm. Arsimi parauniversitar synon të zhvillojë te nxënësit përgjegjësinë ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit (Neni 3, pika 2/c “Qëllimet e arsimit parauniversitar”. *Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2014-2020 (MAS)* përcakton si vizion të saj një sistem arsimor me në qendër nxënësin, i cili mbështet zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe i shërben konsolidimit të shoqërisë demokratike.

Kjo analizë tenton t’i japë përgjigje pyetjeve kapilare, si:

- A frymëzohet kurrikula aktuale nga ky dimension edukimi?
- A shfaqet kjo përmasë edukimi në mesazhe filozofike?
- A vjen si parim kurrikular? A inspiron metodologji integruese?

e arsimit me jetën dhe me interesat e saj.

- A potencon kurrikula ekzistuese metodologji që orientojnë zhvilluesit e kurrikulës, {mësuesit} dhe përfituesit e kurrikulës, {nxënësit} të identifikojnë të “paparashikueshmen” dhe të menaxhojnë atë?

### Fokus i analizës janë bërë:

Dokumentet themelore strategjikë dhe kurrikulare me të cilat punon arsimi i mesëm i lartë në Republikën e Shqipërisë.

- Ligji për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, Nr.69/2012, i amenduar Ligji Nr.56/2015,
- Strategjia për Arsimin Parauniversitar 2014-2020,
- Korniza kurrikulare e Arsimit parauniversitar (2014),
- Kurrikula bërthamë për arsimin e mesëm të lartë (2015),
- Programet mësimore të lëndëve për klasat 10, 11 dhe 12.

Referuar qëllimit të kërkimit, analiza ka ndjekur tri pista kërkimi: “faktet” për çdo fushë të nxëni, krahasimi, dhe identifikimi i “gjetjeve”.

Analiza ka ndjekur linjën në rrafshin horizontal, {që do të thotë analiza ka zhvilluar kërkimin duke ndjekur disiplinat kurrikulare në një vit akademik}. Analiza ka ndjekur linjën në rrafshin vertikal {që do të thotë, ka ndjekur kërkimin duke ndjekur të njëjtat disiplinat shkollore, por, vertikalisht, për të check-uar rrimarrjen e koncepteteve}.

Kërkimi është fokusuar për të identifikuar, frekuencën, me të cilën janë të pranishme, nëse janë “anemike” dhe “periferike”, apo mungojnë tërësia e listkoncepteve dhe termave që përbëjnë dhe që përcjellin në kurrikul “Edukimin për zhvillim të qëndrueshëm”.

Referuar qëllimit të analizës, metodologjia e aplikuar është fokusuar respektivisht në *fushat e të nxënit* që vijojnë:

- **Shkencat natyrore** (Fizikë, Kimi, Biologji).
- **Shkencat shoqërore** (Qytetari, Histori, Gjeografi, Ekonomi)

- **Gjuhët dhe komunikimi** (Gjuha shqipe dhe Letërsia, gjuha e huaj)
- **Teknologji** (Teknologji, TIK)
- **Edukim fizik dhe sporte**
- **Matematikë**

Grupi i ekspertëve ka identifikuar tri rubrika themelore mbi të cilat është e organizuar kurrikula aktuale: a. Rubrika të përgjithshme (Hyrja, Metodologjia e zbatimit të programit, Vlerësimi i nxënësve); b. Objektivat e përgjithshëm c. Objektivat specifike.

Instrumentet matës janë kodifikuar respektivisht tre:

- **Qëllimshëm - Kodi “Q”**
- **Spontanisht - Kodi “S”**
- **Aspak - Kodi “A”**

“Gjuha” e kërkimit përgjatë analizës: është operuar me gjuhë narrative, dhe gjuha grafike njëkohësisht. Në respekt të të interesuarve dhe të përdoruesve të analizës, si gjuha narrative dhe ajo grafike mundësojnë lexim profesional, dhe individual, nga të interesuarit.

Analizë ka ndjekur dhe aplikuar, ligjësitë e analizës sasiore, çka do të thotë se analiza ka prekur të gjitha kurrikulat {disiplinat shkollore} që zhvillohen në arsimin e mesëm të lartë {gjithsesj 13 disiplina në tri vite shkollimi}. Analiza ka ndjekur ligjësitë e analizës cilësore çka do të thotë se është identifikuar frekuenca {shpeshtësia} dhe shfaqja e listës së koncepteve që përcjellin EZHQ. Gjatë kërkimit grupi i ekspertëve ka bërë kujdes dhe ka operuar me logjikën e ftohtë, duke regjistruar vetëm “faktet” e konstatuara. Është bërë përpjekje të evitohen komentet subjektive, dhe janë regjistruar “fotografime” të faktit. Në përfundim të procesit grupi ka mbërritur në disa përfundime të cilat shoqërohen dhe me rekomandime respektive.

Gjatë analizës grupi i ekspertëve ka përmbushur kërkimin duke iu referuar Objektivate globale të zhvillimit të qëndrueshëm, në përbërje të të cilit janë identifikuar (17) koncepte që respektivisht vijojnë: Secili koncept ka të përfshira brenda tij, nënkoncepte, të cilat janë check-uar në disiplinat shkollore respektive.

## Instrumenti i kërkimit:

Për kryerjen e kësaj analize është përdorur skema, sipas së cilës, për çdo disiplinë shkollore në arsimin e mesëm të lartë, janë kërkuar me “lupë” list-konceptet e OKB, të listuara më lart, që përbëjnë substancën e EZHQ.

## Përfituesit e analizës:

Pas çdo kërkimi<sup>2</sup> që fokusohet me “lupë” mbi kurrikulën zyrtare, qëndrojnë faktorë dhe aktorë, të interesuar në: nivele politike arsimore, procedurale, metodologjike.

- Drejtpërsëdrejti të interesuar në këtë analizë specifike, konsiderojmë grupet e ekspertëve që merren me projeksione të zhvillimit të kurrikulave, parimeve dhe filozofitë mbi të cilat ndërtohen kurrikulat.
- Specifikisht të interesuar pritet të jenë, ekspertë që udhëheqin proceset e hartimit të kurrikulave disiplinore, disiplina në të cilat, termat që përbëjnë EZHQ janë më të ekspozuara. Çështje, si ekosistemet dhe mirëmenaxhimi i tyre, varfëria dhe reduktimi i saj, “e mirë e përbashkët” dhe mirëqeverisja e të mirës së përbashkët, pabarazia dhe burimet natyrore, riciklimi dhe ngrohja globale, pasuria nënujore dhe mirëmenaxhimi i saj.
- Fakti që substanca e konceptit EZHQ është aty ku pikëpriten të gjitha fushat e të nxënës, bën të interesuar dhe ekspertët e programeve të kroskurrikulave dhe ekspertët e programeve të ekstrakurrikulave.
- Të interesuar nga gjetjet e kësaj analize, mbeten industria dhe biznesi, si dhe inisiativate ekonomike referuar ZHQ. Kjo, bëhet më e evidente idomos në sistemin e arsimit profesional.
- Përfitues nga rezultatet e kësaj analize mbeten të gjithë ata që përthyejnë dhe zhvillojnë kurrikulën në klasë, mësuesit e të gjitha disiplinave dhe hartuesit e programeve kombëtare të trajnimit të mësuesve.

<sup>2</sup> Grupi i eksperteve ka parapëlqyer të operojë njëkohësisht me termin “kërkim” dhe “analizë” përgjatë materialit. “Kërkimi” synon identifikimin e EZHQ në kurrikul, “analiza” synon ballafaqimin e rasteve të identifikuar të EZHQ me detyrimin që ka kurrikula për ta përcjelle EZHQ në nivel parimi, metode, objektivash kurrikulare të qëllimita.

## Etika e kërkimit:

*Analiza i referohet parimit të konfidencialitetit, paanëshmërisë dhe parimit në funksion të së mirës së përbashkët*, që është e mira publike, në rastin tonë {identifikimi i gjetjeve fokusuar në EZHQ në kurrikul}. Etika e përdorur përgjatë analizës, gjen shprehje në gjuhën e përdorur nga ekspertët që kanë kryer analizën: gjuha narrative dhe gjuha grafike. *Konfidencialiteti i analizës*. Ekspertët kanë përdorur gjuhën e analizës duke tejkuluar emra konkretë, njësi administrative që projektojnë kurrikulën, institucione që janë hartues të kurrikulave, si dhe duke shmangur gjuhën pezhorative dhe etiketime përgjatë analizës. Analiza është udhehequr nga qëllimi i vetëm, t’i japë përgjigje pyetjeve që janë identifikuar në fillim të kërkimit, duke i shmangur parapëlqimet si edhe paragjykimet. Kësisoj analiza, i ka shpëtuar mjaftueshmërisht, vlerësimeve subjektive, çka është dhe parim etik përgjatë një analize të një natyre të tillë.

## 2. Analizë e kurrikulës sipas fushave të të nxënës dhe lëndëve

### 2.1. fusha e të nxënës: Gjuhët dhe komunikimi

Fusha “Gjuhët dhe komunikimi” i aftëson nxënësit që ta përdorin gjuhën për të komunikuar, për të plotësuar interesat e tyre personale, për kënaqësi estetike, për të marrë informacion, si dhe për të përmbushur kërkesat e shoqërisë dhe të vendit të punës.

### Lënda: Gjuhë shqipe

Në përmbledhje të analizës së programeve të lëndës Gjuhë shqipe dhe letërsi për të tri vitet e gjimnazit, mbështetur në gjykimet e mësimpërme dhe specifikat për të gjitha vitet e shkollimit, rezulton se:

- Programet e kësaj lënde kontribuojnë në edukimin e nxënësve për të marrë pjesë në mënyrë të ndërgjegjshme, duke dëgjuar njëri-tjetrin dhe duke marrë në konsideratë opinionet e njëri-tjetrit, duke shprehur njëkohësisht mendimet e tyre pa iu imponuar të tjerëve por duke negociuar, si një ndër parimet e edukimit për zhvillim të qëndrueshëm. Lënda është më shumë e orientuar në zhvillimin e aftësive

të nxënësve për zgjidhjen e problemeve, diskutimin, debatin, dialogun etj., si pjesë e aftësive për jetën.

- Programet e lëndës në të tri vitet e *gjimnazit nuk sugjerojnë tema konkrete* të zhvillimeve shoqërore ose jetës së përditshme për të cilat nxënësit të nxiten të diskutojnë. Në këtë kuptim ato nuk orientojnë në mënyrë të qartë dhe konkrete çështje dhe njohuri që përbushin në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të qëllimshme objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm. Trajtimi i këtyre çështjeve do t'i jepte njëkohësisht mundësi lëndës për zhvillimin e kompetencave kyçe si dhe të kompetencave të saj specifike.

## 2.2. Fusha e të nxënit: Shkencat e natyrës

Fusha e shkencave të natyrës në gjimnaz integron njohuri, shkathtësi, qëndrime e vlera nëpërmjet lëndëve: Kimi, Fizikë, Biologji. Përgjatë tri viteve të gjimnazit, mësimi i shkencave natyrore iu ofron nxënësve mundësi për të zhvilluar të kuptuarit e koncepteve dhe të proceseve shkencore, të praktikave më të përdorura për zhvillimin e njohurive shkencore, të kontributit të shkencës në shoqëri dhe të zbatimeve të saj në jetën e përditshme.

Në programet mësimore të kësaj fushe të nxëni, **qëllimet e fushës së shkencave të natyrës** janë përcaktuar në funksion të të nxënit gjatë gjithë jetës, që do të thotë se kjo fushë të nxëni synon të përgatisë nxënësin në mënyrë të tillë që të mund të vetëzhvillohet dhe të vetëfunksionojë, aftësi këto vetëmenaxhuese mjaft të rëndësishme në pikëpamje të zhvillimit të qëndrueshëm.

Fusha e shkencave të natyrës, dhe për vetë objektin e saj të studimit ndihmon në zhvillimin e kompetencave të cilat u shërbejnë nxënësve në aspektin personal, social, ekonomik dhe që lidhen me çështje lokale, kombëtare dhe globale. **Të tri kompetencat** që synon kjo fushë, zhvillojnë arsyetimin shkencor, zgjidhjen e problemeve dhe u mundësojnë nxënësve të vlerësojnë ndikimin pozitiv dhe negativ të shkencës dhe teknologjisë në mjedis dhe shoqëri, duke *ndihmuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në edukimin për zhvillim të qëndrueshëm*.

**Tematikat e përbashkëta të fushës** janë elemente të rëndësishëm të programit të fushës së shkencave natyrore, sipas të cilave strukturohet përmbajtja lëndore dhe sigurohet integrimi i lëndëve brenda fushës, në funksion të zhvillimit të kompetencave. Tematikat e përbashkëta, si **diversiteti, ciklet, sistemet, ndërveprimet, energjia, modelet**, janë çështje komplekse integruese që ngërthejnë koncepte, perspektiva dhe trajtime që mundësojnë këndvështrimin nga perspektiva të ndryshme të një çështje apo dukurie jo vetëm nga lëndët brenda fushës, porë ngushtësisht në lidhjet e saj me jetën e përditshme. Kjo gjerësi këndvështrimi jep mundësi të trajtimit të koncepteve të tilla, si biodiversiteti, burimet e energjisë, përdorimet e teknologjisë, shëndeti, etj., dhe nga perspektiva e zhvillimit të qëndrueshëm.

## Lënda: Kimi

Në përmbledhje të analizës së programeve të kimisë për të tri vitet e gjimnazit, mbështetur në gjykimet e mësimpërme dhe specifikat për të gjitha vitet e shkollimit, rezultojnë se:


- Programi i kimisë në gjimnaz përfshin elementë (njohuri, aftësi qëndrime) që orientojnë lëndën drejt edukimit për zhvillim të qëndrueshëm. Në më të shumtën e rasteve objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm nuk vijnë qëllimshëm (75%) dhe vijnë me frekuencë të vogël. Vetëm në 18% të rasteve ato vijnë qëllimshëm përgjatë të tri viteve të gjimnazit. Ndërkohë që në objektivat e përgjithshëm dhe në qëllimet e lëndës shprehet mjaft dukshëm dhe qëllimshëm roli i kimisë për zhvillimin e qëndrueshëm, përgjatë tematikave/linjave dhe objektivave specifike të programit vëmendja e nxënësit dhe mësuesit drejt zhvillimit të qëndrueshëm orientohet jo mjaftueshëm. Kryesisht, lënda synon objektivat e ZHQ që kanë të bëjnë me shëndetin dhe mirëqënien (objektivi 3 i ZHQ), menaxhimin e ujërave dhe monitorimin e cilësisë së ujit (objektivi 6 i ZHQ), sjelljen e përgjegjshme si konsumator (objektivi 12 i ZHQ), ndryshimet klimatike (objektivi 13 i ZHQ), (objektivin 14



të ZHQ) në lidhje me ndotjen e botës nënujore si dhe kontributin e shkencës së kimisë për zhvillimin e qëndrueshëm.

- Programet e kësaj lënde zhvillojnë aftësi të

ato të bashkëpunimit me të tjerët. Në programe mungojnë shembuj të formave të vlerësimit të çështjeve për zhvillimin të qëndrueshëm ashtu sikurse dhe modele instrumentesh vlerësues.



tilla si zgjidhja e problemeve, pjesëmarrja, vendimmarrja, sikurse dhe qëndrime duke i aftësuar nxënësit të bëjnë zgjedhje për një stil jetese të qëndrueshëm.

- Kurrikula e kimisë nxit nxënësit të jenë aktivë dhe të marrin përsipër përgjegjësi për të mësuarit e tyre, të përdorin strategji dhe teknika mësimore që nxitin ndërveprimin, pjesëmarrjen mësimore dhe mbështetin kërkimin kimik të nxënësve, duke mundësuar zhvillimin e kompetencave të kërkimit shkencor. Pa dyshim këto instrumente mundësojnë edukimin për zhvillim të qëndrueshëm, por nuk e orientojnë mësuesin në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe specifike për mënyrën si ai/ajo t'i zhvillojë të nxënësit kompetencat për çështje dhe koncepte të caktuara të zhvillimit të qëndrueshëm. Rubrika e vlerësimit të nxënësit nxit përdorimin e një shumëllojshmërie formash dhe teknikash vlerësimi.
- Objekt i vlerësimit nuk janë vetëm njohuritë dhe aftësitë por dhe qëndrimet e nxënësve, duke vënë theksin në qëndrimet etiko-sociale dhe

### Lënda: Fizikë

Lënda e fizikës në gjimnaz si një ndër lëndët e shkencave të natyrës shpjegon natyrën, formulon ligjet duke theksuar karakterin universal të tyre dhe i paraqet ata në formën e modeleve matematike.

Në pikëpamje të edukimit për zhvillim të qëndrueshëm, programet mësimore të kësaj lënde për të tri vitet e gjimnazit kanë për mision të kontribuojnë në përgatitjen e nxënësve për të nxënë gjatë gjithë jetës dhe për ta përdorur fizikën në vendimmarrje që ndihmojnë në zhvillimin e tyre si individë dhe të komunitetit në nivel lokal, kombëtar e ndërkombëtar. Me fokus formimin e aftësive të nxënësve për jetën programet zhvillojnë dhe nxitin zgjidhjen në mënyrë krijuese të problemeve, të eksperimentuarit, të punuarit në grup, përdorimin efektiv të teknologjisë. Programet e kësaj lënde adresojnë çështje të zhvillimit të qëndrueshëm sikurse janë energjia dhe shfrytëzimi i saj, ndotja dhe shëndeti.

Në përmbledhje të analizës së programeve të fizikës për të tri vitet e gjimnazit, mbështetur në gjykimet e mësimperme dhe specifikat për të gjitha vitet e shkollimit, rezulton se:


- Programi i fizikës në gjimnaz përfshin elementë

(njohuri, aftësi qëndrime) që orientojnë lëndën drejt edukimit për zhvillim të qëndrueshëm. Në 6% të rasteve objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm vijnë qëllimshëm.

- Në programet e kësaj lënde, në ndryshim nga programet e lëndës së kimisë, në objektivat

- Objekt i vlerësimit nuk janë vetëm njohuritë dhe aftësitë por dhe qëndrimet e nxënësve, duke vënë theksin në qëndrimet etiko-sociale dhe ato të bashkëpunimit me të tjerët. Në programe mungojnë shembuj të formave të vlerësimit të çështjeve për zhvillimin të qëndrueshëm ashtu sikurse dhe modele instrumentesh vlerësues.

### Objektivat e ZHQ në programet e Fizikës, Kl.10-12



specifikë të lëndës shprehet më dukshëm dhe qëllimshëm roli i fizikës për zhvillimin e qëndrueshëm krahasuar me objektivat e përgjithshëm.

- Kryesisht, lënda synon objektivat e ZHQ që kanë të bëjnë me shëndetin dhe mirëqënien (objektivi 3 i ZHQ), energjinë dhe menaxhimin e qëndrueshëm të saj (objektivi 7), ndotjen e mjedisit dhe kujdesin për të në funksion të komuniteteve të qëndrueshëm (objektivi 11) si dhe zhvillimin e teknologjisë (objektivi 9).
- Udhëzimet metodologjike për zbatimin e programit sugjerojnë përdorimin e metodave ndërvepruese të cilat nxitin nxënësit të jenë aktivë, të hetojnë në lidhje me dukuritë fizike, të debatojnë dhe zhvillojnë punën në grup. Programi nuk ofron shembuj të strategjive për trajtimin e koncepteve dhe zhvillimin e aftësive në përmbushje të objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm.
- Rubrika e vlerësimit të nxënësit nxit përdorimin e një shumëllojshmërie formash dhe teknikash vlerësimi.

### Lënda: Biologji

Në pikëpamje të edukimit për zhvillim të qëndrueshëm, programet mësimore të kësaj lënde për të tri vitet e gjimnazit kanë për mision të nxitin të menduarin shkencor të nxënësve, përqipen të ngjallin interesin për shkencën e jetës dhe inkurajojnë nxënësit të sillen në mënyrë të përgjegjshme ndaj mjedisit, të përfshihen në veprime për mbrojtjen e vlerave të tij. Me fokus formimin e aftësive të nxënësve për jetën programet zhvillojnë dhe nxitin zgjidhjen në mënyrë krijuese të problemeve, të eksperimentuarit, të punuarit në grup, përdorimin efektiv të teknologjisë. *Programet e kësaj lënde adresojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë objektiva të edukimit për zhvillim të qëndrueshëm në funksion të sigurimit të një jete të shëndetshme, respektimit dhe ruajtjes së biodiversitetit etj.*

Në përmbledhje të analizës së programeve të biologjisë për të tri vitet e gjimnazit, mbështetur në gjykimet e mësimperme dhe specifikat për të gjitha vitet e shkollimit, rezulton se:


- Programet i biologjisë në gjimnaz përfshijnë elementë (njohuri, aftësi qëndrime) që

orientojnë lëndën drejt edukimit për zhvillim të qëndrueshëm. Objektivat e programeve në masën 20 % synojnë qëllimshëm objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm. Në programet e kësaj lënde, krahasuar me programet e dy lëndëve të tjera të shkencave të natyrës, si në objektivat e përgjithshëm ashtu dhe në ato specifike shprehet dukshëm dhe qartë synimi për të orientuar të nxënësit e drejt çështjeve të zhvillimit të qëndrueshëm dhe zbatimeve të lëndës në jetën e përditshme. Kryesisht, lënda e biologjisë në gjimnaz synon objektivat e ZHQ që kanë të bëjnë me shëndetin dhe mirëqënien (objektivi 3 i ZHQ), ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të ekosisteme tokësore si deh biodiversitetin (objektivi 15), menaxhimin e ujërave (objektivi 14), edukimin e konsumatorit të kujdeshëm dhe të përgjegjshëm (objektivi 12) dhe në mënyrë më spontane nxitjen e veprimit për zhvillimin e qëndrueshëm në nivel global (objektivi 16). Tipar dallues jo vetëm i programeve të biologjisë, por dhe i programeve të fizikës e kimisë, është fakti që në kurrikulën bërthamë këto lëndë janë më të fokusuara qëllimshëm në përmbushjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm dhe në nxitjen e nxënësve për të zhvilluar njohuri, aftësi e qëndrime për të, ndërkohë që në programet me zgjedhje të këtyre lëndëve, lënda fokusohet më

ngushtë në përgatitjen e nxënësve për aspektin shkencor dhe më zbehtë në edukimin për zhvillimin e qëndrueshëm.

- Udhëzimet metodologjike për zbatimin e programit sugjerojnë përdorimin e metodave ndërvepruese të cilat nxitin nxënësit të jenë aktivë, të hetojnë në lidhje me dukuritë fizike, të debatojnë dhe zhvillojnë punën në grup. Një ndër elementët e rëndësishëm që programet synojnë të zhvillojnë janë dhe qëndrimet intelektuale të nxënësve, si ndjenja e iniciativës, interesi për prezantimin e ideve të ndryshme, ndjenja e përgjegjësisë për zgjidhje origjinale, ndjenja e bashkëpunimit gjatë punës në grup. Megjithatë, programet nuk janë specifike dhe konkretë për ofrimin e shembujve të strategjive për trajtimin e koncepteve dhe zhvillimin e aftësive në përmbushje të objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm.
- Rubrika e vlerësimit të nxënësit nxit përdorimin e një shumëllojshmërie formash dhe teknikash vlerësimi. Objekt i vlerësimit nuk janë vetëm njohuritë dhe aftësitë por dhe qëndrimet e nxënësve, duke vënë theksin në qëndrimet etiko-sociale dhe ato të bashkëpunimit me të tjerët. Në programe mungojnë shembuj të formave të vlerësimit të çështjeve për zhvillimin të qëndrueshëm ashtu sikurse dhe modele instrumentesh vlerësues.

### Objektivat e ZHQ në programet e Biologjisë, Kl.10-12



## Moduli: Njeriu dhe ndryshimet klimatike

Moduli “Njeriu dhe ndryshimet klimatike” ofrohet si lëndë e kurrikulës me zgjedhje të lirë si pjesë e fushës së shkencave natyrore në klasën e dhjetë të gjimnazit. Ky modul fokusohet në kompleksitetin e ndryshimeve klimatike duke i dhënë nxënësve mjetet dhe backgroundin e nevojshëm për të kuptuar këto ndryshime dhe ndikimin e tyre në mjedisin e shoqërisë.

Programi i modulit “Njeriu dhe ndryshimet klimatike” është qëllimshëm i konceptuar me fokus OZHQ-të. **Objektivat e programit në masën 100 % synojnë qëllimshëm objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm.** Këto objektiva përbushin objektivat e ZHQ që kanë të bëjnë me bujqësinë e qëndrueshme (objektivi 2), shëndetin dhe mirëqënien (objektivi 3 i ZHQ), menaxhimin e ujit (objektivi 6), energjinë (objektivi 7), angazhimin qytetar për komunitete të qëndrueshëm (objektivi 11), konsumatorin e përgjegjshëm (objektivi 12), klimën dhe ndryshimet klimatike (objektivi 13), ekosistemet nënujorë (objektivi 14), ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të ekosistemeve tokësore si dhe biodiversitetin (objektivi 15), si dhe partneritetin botëror për zhvillim të qëndrueshëm (objektivi 17).

### 2.3. Fusha e të nxënësve: Shoqëria dhe mjedisi

Fusha e të nxënësve mundësitë të zhvillojnë kompetencat e nevojshme për të përbushur rolin e tyre si anëtarë të një shoqërie shumëkulturore dhe demokratike në një botë gjithnjë e më të ndërvarur.

Fusha “Shoqëria dhe mjedisi” integron njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera nëpërmjet lëndëve të tilla, si: *Histori, Gjeografi, Qytetari, Sociologji, Filozofi, dhe Ekonomi etj.*

### Lënda: Gjeografi

Nga grafiku i mësipërm identifikohet lehtë se nga kurrikula e gjeografisë në arsimin e mesëm të lartë, lënda e gjeografisë me zgjedhje që zhvillohet në klasën e 2-të është lënda që krijon hapësirat më të mëdha për të trajtuar koncepte që lidhen me OZHQ. Kjo do të thotë se në kuadër të zhvillimit


të kësaj lëndë ka mundësi të zhvillohen një sërë veprimtarish mësimore, në klasë dhe jashtë saj, që aftësojnë nxënësit për t'i parë dhe vlerësuar konceptet në kuadër të qëndrueshmërisë. Pa dyshim që sasia, shpeshtësia, dhe efektiviteti i përdorimit të çështjeve dhe koncepteve që lidhen me zhvillimin e qëndrueshëm varet nga shkalla e ndërgjegjësimit të mësuesit në këtë drejtim, lidhur me aftësitë e tij për t'i njohur dhe trajtuar si duhet këto koncepte.

Në përmbledhje të analizës së programeve të Gjeografisë për të tri vitet e gjimnazit, mbështetur në gjykimet e mësimperme dhe specifikat për të gjitha vitet e shkollimit, rezultoi se:

- Përbajtja e lëndës së gjeografisë në arsimin e mesëm të lartë krijon mundësi dhe hapësirë të bollshme për të përcjellë përmes përbajtjes kurrikulare dhe trajtuar çështje që lidhen me OZHQ.
- Kurrikula në pak raste sjell qëllimshëm çështjet që lidhen me OZHQ.
- Në kurrikulën e gjeografisë ndeshen më së shumti objektiva si ato që kanë të bëjnë kryesisht me: menaxhimin e qëndrueshëm të ujit, nxitja e rritjes ekonomike të qëndrueshme, zvogëlimi i pabarazisë mes qyteteve, mbrojtja ndaj ndryshimeve klimatike, mbrojtja dhe përdorimi i qëndrueshëm i ekosistemeve tokësore, nxitja e shoqërive paqësore, etj.
- Më i shprehur koncepti i zhvillimit të qëndrueshëm është në pjesën hyrëse të prezantimit të lëndës ku shpesh vjen qëllimshëm prirja për të parë dukuritë dhe trajtuar ato në kuadër të zhvillimit të qëndrueshëm.
- Si pjesë e kurrikulës së avancuar apo thelluar është “Gjeografia e problemeve globale” e cila është nga lëndët e vetme në këtë cikël shkollimi e fokusuar ndjeshëm dhe qëllimshëm në çështjet që lidhen me zhvillimin e qëndrueshëm. Kjo lëndë përfaqëson rastin më të mirë në këtë drejtim por duhet nënvizuar se kjo lëndë është me zgjedhje ka do të thotë që nuk janë të gjithë nxënësit në këtë cikël shkollimi që ndjekin dhe zhvillojnë këtë kurrikulë.



## Objektivat e ZHQ në programet e Gjeografisë Kl.10-12



### Lënda: Qytetari

Lënda e Qytetarisë në klasën e 11-të trajton një sërë konceptesh dhe njohurish të rëndësishme dhe lidhen me OZHQ-të. Në shtjellimin e përmbajtjes së kësaj lënde theksohet: "...në misionin e qytetarisë është edhe edukimi dhe konsolidimi i përkushtimit ndaj vlerave të njohura e të pranuara si universale në shoqëri, si: *Përkushtimi ndaj parimit të zhvillimit njerëzor të qëndrueshëm, që mban parasysh ekuilibrin ndërmjet zhvillimit ekonomik, shoqëror dhe mjedisor*".

### Lënda: Ekonomi

Paraqitja e OZHQ në lëndën e ekonomisë është shumë e vogël, megjithëse bëhet fjalë për një lëndë e cila prek probleme shumë të rëndësishme që lidhen me zhvillimin e qëndrueshëm.

Në përmbledhje të analizës së programeve të lëndëve Qytetari dhe Ekonomi për të tri vitet e gjimnazit, mbështetur në gjykimet e mësimperme dhe specifikat për të gjitha vitet e shkollimit, rezultoi se:

- Përmbajtja e kurrikulës së këtyre lëndëve ka hapësirë dhe shtrat të bollshëm për të integruar koncepte dhe çështje që lidhen me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm.
- Aktualisht, në kurrikulën e rikonceptuar, e cila po zbatohet vetëm në klasën e 10-të deri në këtë moment, ka më shumë angazhim të hartuesve të kurrikulës në përfshirjen qëllimshëm të

çështjeve të rëndësishme që lidhen me OZHQ.

- Më së shumti ndeshen çështje të tilla, si: ekonomia e qëndrueshme, punësimi, industrializimi i qëndrueshëm, nxitja e inovacionit, zvogëlimi i pabarazisë mes vendeve, qytete dhe vendbanime gjithëpërfshirës e të qëndrueshëm, shoqëritë paqësore për zhvillim të qëndrueshëm, angazhim qytetar, ushqyerja, kujdes shëndetësor etj.
- Në përmbajtjen e kurrikulës së lëndës ekonomi nuk gjen një sërë çështjesh që mund të ishin pjesë e saj si: problemet e punësimit sor, skllavëria moderne, puna e fëmijëve, mundësitë e punësimit etj, të cilat janë çështje që më së miri mund të trajtoheshin nën perspektivën e zhvillimit të qëndrueshëm në këtë lëndë.

### Lënda: Histori

Nga të dhënat e mësimperme identifikohet se në përgjithësi kurrikula e historisë ka krijuar një hapësirë fare të vogël në trajtimin e koncepteve që lidhen me OZHQ. Autorët në shumë raste sjellin spontanisht çështje që lidhen me zhvillimin e qëndrueshëm. Nga kjo situatë mund të mendohet se në klasë ndodhin pak ose aspak veprimtari që në fokus kanë çështjen e qëndrueshmërisë.

Në përmbledhje të analizës së programeve të Historisë për të tri vitet e gjimnazit, mbështetur në gjykimet e mësimperme dhe specifikat për të gjitha vitet e shkollimit, rezultoi se:

- Kurrikula e historisë e vlerësuar në këtë rast, mund të thuhet, se paraqitet e varfër në kujdesin për të përcjellë objektiva apo rezultate mësimore

mos tregojnë kujdesin e duhur për të përcjellë këto koncepte në materialet e prodhuara për mësimin dhe nxënësit.



që prekin çështjet e sotme globale që lidhen me zhvillimin e qëndrueshëm.

- Konceptet dhe çështjet e identifikuar ndeshen më së shumti në pjesët hyrëse dhe të përgjithshme të dokumenteve kurrikularë. Në këto pjesë të kurrikulës çështjet që lidhen me OZHQ vijnë në terma të përgjithshëm dhe duke integruar disa nga OZHQ njëherësh.
- Përgjatë parashtrimit të përmbajtjes së kurrikulës së historisë në klasat 10-12-të gjen pak çështje që lidhen me OZHQ, të tilla si: të drejtat e grave dhe roli i tyre në histori, mbrojtja e kulturës dhe respektimi i diversitetit të saj, të drejtat e njeriut, konfliktet, dhuna etj.
- Prania e koncepteve që lidhen me zhvillimin e qëndrueshëm në kurrikulën e historisë vjen shpesh spontanisht në përmbajtjen e dokumenteve kurrikularë. Kjo krijon një lloj pasigurie mbi faktin nëse ato mbërrijnë tek nxënësit në klasë përmes veprimtarive mësimore. Mund të ndodhë që autorët e burimeve të të nxënësit, si tekstet shkollore, të

#### 2.4. Fusha e të nxënësit: Edukim fizik, sporti dhe shëndeti


Në përmbledhje të analizës së programeve të edukimit fizik, sportit dhe shëndetit për të tri vitet e gjimnazit, mbështetur në gjykimet e mësim-përme dhe specifikat për të gjitha vitet e shkollimit, rezulton se:

- Programet e edukimit fizik në gjimnaz përfshijnë elementë (njohuri, aftësi qëndrime) që orientojnë lëndën drejt edukimit për zhvillim të qëndrueshëm. Objektivat e programeve në masën 14 % synojnë qëllimshëm objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm. Në programet e kësaj lënde, si në objektivat e përgjithshëm ashtu dhe në ato specifike shprehet dukshëm dhe qartë synimi për të orientuar të nxënësit drejt çështjeve të zhvillimit të qëndrueshëm dhe zbatimeve të lëndës në jetën e përditshme. Edukimi fizik është parë si një mjet ideal për promovimin e aktivitetit të rregullt fizik dhe edukimin e një stili jetese aktiv. Të përshtatësh një stil jetese aktiv dhe të shëndetshëm do të thotë të krijosh mundësitë për të jetuar një

jete, e cila karakterizohet nga një mirëqenie e përgjithshme fizike, mendore dhe emocionale, në të cilën një individ gëzon aftësi për të ekzekutuar çdo ditë detyra energjikisht dhe aktivisht, kryen me kënaqësi veprimtaritë e kohës së lirë dhe realizon lehtësisht kërkesat e ditës. Kjo kompetencë zhvillohet me edukimin e zakoneve të shëndetshme, angazhimin në forma të ndryshme të veprimtarisë fizike e sportive, të ushqyerit në mënyrën e duhur, mosekspozimin ndaj substancave që krijojnë varësi, duke krijuar një model jetese e cila do të sillte efekte të

dhe duhet të edukojë dhe aftësojë nxënësit për përdorimin e teknologjisë në funksion të zhvillimit dhe qëndrueshmërisë. Megjithë mundësitë dhe hapësirën për fokus në objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm, lënda ofron shumë pak, për të mos thënë aspak objektiva që adresojnë çështje që lidhen me përdorimin e teknologjisë në funksion të zhvillimeve të ekonomisë, shoqërisë dhe mjedisit.

Megjithë mundësitë dhe hapësirën për fokus në objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm, lënda ofron shumë pak, për të mos thënë aspak objektiva që adresojnë çështje që lidhen me përdorimin



pëlqyeshme afatshkurtra, afatmesme e afatgjata.

- Në këto programe janë përfshirë përvoja lëvizore e sportive, si dhe njohuri në fushën e shëndetit, të cilat u japin mundësi nxënësve të aftësohen e të jenë të përgatitur për jetën më pas. Kryesisht, lënda synon objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm që kanë të bëjnë me shëndetin dhe mirëqënien (objektivi 3 i ZHQ), ushqyerjen dhe përmirësimin e saj (objektivi 2), dhe me fokus më të zbehtë krijimin e komuniteteve të qëndrueshëm (objektivi 11).

## 2.5. Fusha e të nxënit: Teknologji dhe TIK

### Lënda: Teknologji e informacionit dhe komunikimit

Të nxënit për zhvillim të qëndrueshëm është i lidhur me të sotmen dhe i orientuar drejt së ardhmes. Në këtë kuptim lënda e TIK-ut mund

e teknologjisë në funksion të zhvillimeve të ekonomisë, shoqërisë dhe mjedisit.

## 2.6. Fusha e të nxënit: Matematikë

- Kurrikula e matematikës ka krijuar një hapësirë fare të vogël në trajtimin e koncepteve që lidhen me OZHQ. Autorët në pak raste sjellin spontanisht çështje që lidhen me zhvillimin e qëndrueshëm. Nga kjo situatë mund të mendohet se në klasë ndodhin pak ose aspak veprimtari që në fokus kanë çështjen e qëndrueshmërisë.
- Konceptet dhe çështjet e identifikuar ndeshen më së shumti në pjesët hyrëse dhe të përgjithshme të dokumenteve kurrikularë. Në këto pjesë të kurrikulës çështjet që lidhen me OZHQ vijnë në terma të përgjithshëm.
- Përgjatë parashtrimit të përmbajtjes së

kurrikulës së matematikës në klasat 10-12-të gjen pak çështje që lidhen me OZHQ, të tilla si: edukimi si konsumator i përgjegjshëm, sigurimi i modeleve të qëndrueshme të konsumit dhe prodhimit.

## 2.7. Gjetje...

Nga analiza e kurrikulës së gjimnazit, për të gjitha fushat e të nxëniet dhe lëndët e kurrikulës bërthamë dhe asaj me zgjedhje rezultojnë se:

- Kurrikula e arsimit të mesëm të lartë *privet intuitivisht* drejt Edukimit për Zhvillim të Qëndrueshëm. Në mënyrë të veçantë kurrikula e reformuar është ndërtuar bazuar në *konceptin e kompetencave për të nxëniet gjatë gjithë jetës*, të cilat mundësojnë përgatitjen e individëve për pjesëmarrje cilësore e aktive në shoqëri. *Kompetencat kyçe* që kjo kurrikul zhvillon, synojnë që nxënësit të funksionojnë në shoqërinë e së sotmes dhe të së ardhmes. Me fokus të veçantë *kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin dhe kompetenca qytetare* kultivojnë te nxënësit orientimin drejt së ardhmes, sipërmarrjen, aftësitë për t'u ballafaquar me ekonominë konkurruese globale, në mënyrë që nxënësit të jenë në gjendje të veprojnë si qytetarë të përgjegjshëm, duke marrë parasysh kontekstin e ngushtë dhe të gjerë.
- *Temat kroskurrikulare* me fokus të veçantë Zhvillimi i qëndrueshëm dhe Mjedisi, orientojnë kurrikulën për trajtimin e tyre dhe çështjeve që lidhen me to nga të gjitha fushat e të nxëniet dhe lëndët që i përbëjnë ato.
- *Zhvillimi i qëndrueshëm dhe Mjedisi* përcaktohen si dy tema kroskurrikulare, secila më vete, ndërkohë që Mjedisi është pjesë e konceptit të Zhvillimit qëndrueshëm. Kjo gjë tregon qartë që hartuesit e kurrikulës nuk janë mjaftueshëm të orientuar për konceptin e zhvillimit të qëndrueshëm.
- Megjithëse shpallen si pjesë e politikës kurrikulare dhe janë pjesë e detyrimit për të gjitha lëndët që t'i trajtonë si çështje kros, në

pikëpamje teknike përfshirja e tyre në programe nuk mbështetet me instrumente proceduralë. Këto tema shpallen si të tilla në programet mësimore të lëndëve, por mësuesit dhe autorët e teksteve nuk orientohen në lidhje me rrugën e përfshirjes dhe trajtimit të tyre.

- EZHQ nuk rezultojnë si parim udhëheqës i ndërtimit të programeve mësimore. Programet mësimore të lëndëve ( Kurrikula bërthamë dhe me zgjedhje) përmbajnë objektiva që adresojnë çështje të zhvillimit të qëndrueshëm, por objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm nuk udhëheqin filozofinë e ndërtimit dhe përmbajtjes së programeve. Çështje të zhvillimit të qëndrueshëm i gjen të shprehura në mënyrë kaotike herë në objektivat e përgjithshëm, herë në objektivat specifike. Mungon koherenca dhe konsistenca në trajtimin e këtyre çështjeve brenda vetë lëndës, nga njëri vit shkollimi në tjetrin sikurse dhe midis lëndëve e fushave të të nxëniet.
- Prania ose jo e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm, gjerësia dhe niveli i trajtimit të tyre i lidhen ndjeshmërisë së autorëve të programit. Në programet mësimore, megjithëse adresohen çështje të tilla, si shëndeti, biodiversiteti, energjia, punësimi etj., jo gjithmonë këto çështje shihen nën perspektivën e zhvillimit të qëndrueshëm. Në shumë raste trajtimi i tyre është i lidhur ngushtësisht me objektin shkencor të studimit të lëndës.
- Programet mësimore të kurrikulës bërthamë krahasuar me ato të kurrikulës me zgjedhje, për të gjitha lëndët në përgjithësi, janë më të fokusuar qëllimshëm në përmbushjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm dhe në nxitjen e nxënësve për të zhvilluar njohuri, aftësi e qëndrime për të. Lëndët me zgjedhje fokusohen më ngushtë në përgatitjen e nxënësve për aspektin shkencor dhe më zbehtë në edukimin për zhvillimin e qëndrueshëm.
- Kurrikula e shkencave shoqërore më së shumti,

dhe më pas ajo e shkencave natyrore, krahasuar me fushat e tjera të të nxënit, janë më të orientuara drejt zhvillimit të qëndrueshëm përsa i takon dijeve dhe aftësive që zhvillojnë.

- Ndër programet mësimorë të lëndëve, dy prej tyre në mënyrë të veçantë “Njeriu dhe ndryshimet klimatike” (Kurrikula me zgjedhje të lirë, kl.10) si dhe “Gjeografi e problemeve globale” (Kurrikul me zgjedhje të detyruar, kl.12) janë konceptuar me fokus të drejtpërdrejtë Edukimin për zhvillim të qëndrueshëm. Përmbajtja e tyre përmbush pjesën më të madhe të OZHQ-ve. Në mënyrë të veçantë moduli “Njeriu dhe ndryshimet klimatike” përmbush qëllimshëm 13 OZHQ.
- Udhëzimet metodologjike për zbatimin e programeve sugjerojnë përdorimin e metodave ndërvepruese të cilat nxitin nxënësit të jenë aktivë, të hetojnë në lidhje me dukuritë e ndryshme, të debatojnë dhe zhvillojnë punën në grup. Megjithatë, programet nuk janë specifike dhe konkrete për ofrimin e shembujve të strategjive për trajtimin e koncepteve dhe zhvillimin e aftësive në përmbushje të objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm.
- Rubrika e vlerësimit të nxënësit nxit përdorimin e një shumëllojshmërie formash dhe teknikash vlerësimi. Objekt i vlerësimit nuk janë vetëm njohuritë dhe aftësitë por dhe qëndrimet e nxënësve, duke vënë theksin në qëndrimet etiko-sociale dhe ato të bashkëpunimit me të tjerët. Por në programe mungojnë shembuj të formave të vlerësimit të çështjeve për zhvillimin të qëndrueshëm ashtu sikurse dhe modele instrumentesh vlerësues.

## 2.8. Përfundime dhe rekomandime

**1.1 EZHQ** nuk rezulton të jetë frymë dhe parim që udhëheq qëllimshëm ndërtimin e kurrikulës së arsimit të mesëm të lartë. Programet mësimorë të lëndëve (Kurrikula bërthamë dhe me zgjedhje) përmbajnë {spontanisht} objektiva që adresojnë çështje të zhvillimit të qëndrueshëm,

por, objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm {as të përgjithshëm, as specifike} nuk theksojnë filozofinë e EZHQ në përmbajtjen e programeve. Çështje të zhvillimit të qëndrueshëm nuk i gjen të shprehura mjaftueshmërisht, madje në raste të caktuara, vinë në mënyrë kaotike, herë në objektivat e përgjithshëm, herë në objektivat specifike. Mungon koherenca dhe konsistenca në trajtimin e këtyre çështjeve brenda vetë lëndës në hapësirën e një viti akademik, dhe aq më shumë nga viti në vit akademik, duke humbur parimin e linearitetit të kurrikulës fokusuar në EZHQ. Dija kurrikulare nuk mund të jetë dije e mbyllur, por dije që rimerret në dimensione të reja. Ky përfundim vlen si për programet lëndore, po ashtu dhe për fushat e të nxënit.

*Nga ky përfundim, derivojnë rekomandime që çojnë tek cilësia e ekspertizës së grupeve të ekspertëve që institucionalisht projektojnë kurrikulat. Kjo ekspertizë shfaqet relativisht anemike. Rekomandojmë trajnime të qëllimta dhe fokus-grupe ku grupet e ekspertëve të të gjitha disiplinave shkollore, të thellohen me tej në “substancën” e EZHQ dhe në nevojën imediate për të thelluar dijen rreth saj dhe metodologjinë e përthyerjes së këtij koncepti shumëdimensional në kurrikul.*

**1.2 EZHQ** është një koncept “substancë” që ngërthen brenda saj një tërësi konceptesh të cilat pikëpër pikë mes tyre. Pikëprerjet e shumta të disiplinave humane me ato natyrore dhe shkencore të mirëfillta me shkencat aplikative si dhe dijen teknologjike e bëjnë EZHQ, thellësisht kompleks për tu kuptuar dhe aq më kompleks për tu përthyer në objektiva kurrikulare në nivel horizontal dhe vertikal dhe për tu përthyer brenda disiplinës shkollore.

*Nga ky përfundim, derivojnë rekomandime që çojnë tek nevoja për politika të reja dhe të qarta në lidhje me identifikimin e hapësirave, gjerësisë, thellësisë dhe metodologjitë e përfshirjes në kurrikul. E gjithë përmbajtja kurrikulare lipset të ndërtohet duke i dhënë përgjigje nevojës për zhvillim të qëndrueshëm. Konfirmimi i*



*dokumenteve politiko- arsimore, sikurse janë standardet për EZHQ, të cilët të orientojnë dhe udhëheqin kurrikulën për Edukim për zhvillim të qëndrueshëm. Këto standarde do të mund të orientojnë specialistët e arsimit, hartuesit e kurrikulës, mësuesit dhe drejtuesit e institucioneve arsimore për t'i dhënë frymën e EZHQ jo vetëm sistemit të disiplinave në shkollë, por jetës shoqërore brenda dhe jashtë saj.*

**1.3** Referuar përfundimit që dolën nga gjetjet përgjatë analizës, mbërrimë në përfundimin se “mosdija” e thelluar e hartuesve të kurrikulës në çështjet e EZHQ, na çon të pranojmë se ka një “dije anemike” dhe sa i përket metodologjive mësimore të cilat e pritet ta përthyejnë në klasë substancën e konceptit EZHQ.

*Nga ky përfundim, derivojnë rekomandime që cojnë tek nevoja për politika të reja dhe të qarta kombëtare në fushën e trajnimit të mësuesve për ta parë disiplinën shkollërore që ata zhvillojnë në fokusin e EZHQ. Përgatitja e instrumenteve metodologjike për zbatimin e qasjeve të tilla, si paketa didaktike për çështje të EZHQ*

**1.4** Referuar përfundimit që konceptit EZHQ potencon dhe thekson çështje që janë prioritare për kushtet lokale dhe rajonale, që e bën kurrikulën të funksionojë në kushte të vetëzhvillimit lokal, rekomandojmë që:

*Stafet lokale të zbatimit të kurrikulës në nivel shkollë dhe rajoni të trajnohen në metodologjitë për të përthyer objektivat e kurrikulës në përshtatje me specifikat lokale.*

**1.5.** EZHQ, është konfirmuar si zhvillim arterial në nivel global dhe lokal, pranimi dhe zbatimi i të cilit është i gjithëpranuar, në kushtet socio-ekonomike dhe natyrore shpesh të paparashikueshme, në të cilën shoqëria po përmbush veteveten.

*Nga ky përfundim, derivojnë rekomandime që cojnë tek nevoja për ta brendësuar deri në nivelet e ndërgjegjes profesionale metodologjinë e përmbushjes se Edukimit me frymën e EZHQ, si nevojë në emër të ruajtjes se species tone: njeriut.*

*Ky proces kërkon të mediatizohet si çështje që u përket të gjithëve përtej disiplinës shkollërore ku zhvillojnë mësimdhënje.*

**1.6** Referuar analizës së rubrikës “Udhëzime metodologjike për zbatimin e programeve” rezulton se sygjerohen metodologji ndërvepruese që stimulojnë nxënësit të hetojnë aty ku pikëpritën dukuritë sociale dhe natyrore, por, sygjerimet janë sipërfaqësore shpesh anemike, nëse i referohemi kompleksitetit që ka EZHQ si koncept shumëdimensional.

*Nga ky përfundim, derivojnë rekomandime që cojnë tek nevoja për metodologji specifike, që mundësojnë përtpypjen e një koncepti kaq dimensional që është EZHQ. Por mungesa e metodologjive specifike është e justifikuar në rastet kur mungon qëllimshëm prania e frymës dhe objektivave të EZHQ.*

**Rekomandime në nivel: politik- procedural – mediatik – teknik**

Nga procesi i kërkimit me “lupë” të listë koncepteve EZHQ në kurrikulën e arsimit të mesëm të lartë në Republikën e Shqipërisë sygjerojmë që të inicohen disa veprime deri në nivele strategjike kombëtare:

- Portal online për EZHQ në arsimin e mesëm të lartë. Ofrohen materiale burimore, modele veprimtarish mësimore.
- Mediatizim i EZHQ: fushatë sensibilizimi me shkollat, vetëdije komunitare, riorientim i arsimit me fokus EZHQ.
- Fakultetet e mësuesisë: Reformulim i Kurrikulës së formimit fillestar të mësuesve me fokus EZHQ.
- Strategji kombëtare: Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Ekonomisë, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Mjedisit.

Prof. Dr. Anila Paparisto,  
Universiteti i Tiranës  
Fakulteti i Shkencave të Natyrës

## Zhvillimi i Qëndrueshëm & ...

### Ligji 80/2015 i Arsimit të Lartë për Kërkimin Shkencor në IAL

**Z**hvillimi i qëndrueshëm është një model i zhvillimit që përcaktohet nga interesat publike duke marrë parasysh aspektet e përgjithshme të një bote të globalizuar. Ai përfaqëson një proces kompleks që përmbush nevojat e së tashmes, pa ndikuar dhe kompromentuar mundësinë e brezave të ardhshëm për të plotësuar nevojat e tyre.

Zhvillimi i qëndrueshëm tenton të balancojë nevojat me limitet me të cilat përballlet sot shoqëria. Ai përfaqëson një betejë pa kufij për të gjetur rrugë të reja, më të mira, krijuese, të cilat ndikojnë të tashmen, por respektojnë edhe të ardhmen.

Por, cila është rruga strategjike me ndikimin më të lartë, përmes së cilës koncepti i “zhvillimit të qëndrueshëm”, mund të gjejë shtratin e tij të zhvillimit, përfshirjen funksionale si pjesë e të menduarit dhe të vepruarit, dritën e realizimit të ndryshimit për një të ardhme të qëndrueshme?

Mbase për shumë prej nesh përgjigja nuk do të ishte e vështirë; mbase për shumë të tjerë do të ishte abstrakte dhe jo e thjeshtë për t’u artikuluar.

Për të lehtësuar vizionimin shoqëror të një të ardhme të qëndrueshme, për të përgatitur një shoqëri ku “zhvillimi i qëndrueshëm” shndërrohet në një koncept dhe mënyrë sjellje, që bëhet pjesë përbërëse e të menduarit dhe të vepruarit, në radhë të parë duhet të përcaktohen rrugët strategjike, të cilat do të mundësojnë përfshirjen e këtij koncepti në skemën e formimit të secilit.

Po ku mund të ndërhyjmë më mirë për ta përmirësuar edukimin brenda një kohë të shkurtër dhe me një ndikim të lartë?

Përgjigja duket se vjen logjike, e ku më mirë se në procesin e shkollimit dhe formimit profesional dhe për të kuptuar më mirë këtë, mjafton të përmendim fjalët e Nelson Mandelës, i cili me të drejtë thotë

se “Edukimi është arma më e fuqishme që kemi në dorë për të ndryshuar botën!”.

Po fillimisht le të biem të gjithë dakord mbi atë që përfaqëson koncepti i Edukimit, pasi jo të gjithë ne e përdorim këtë koncept të rëndësishëm duke vizionar të njëjtin kuptim. Pavarësisht nga përkufizimet e shumta që mund të gjejmë për termin “Edukim” ndaj me ju kuptimin e tij të gjerë, i cili e kalon atë çfarë shumica prej nesh kuptojnë me këtë term të rëndësishëm. Edukimi është një proces i gjatë, ai nuk është i kufizuar vetëm në një periudhë të caktuar kohore të jetës njerëzore, ai vazhdon përgjatë saj pasi “Edukimi nuk është thjesht një përgatitje për jetën, edukimi në vetvete është vetë jeta”.

Edukimi, përfaqëson çdo gjë që gjithsecili prej nesh mund të kujtojë, përdorë, e zhvillojë pandërprere pasi ka dalë nga bankat e shkollës. Si i tillë, procesi i edukimit përmes shkollimit duhet të ndikojë në mënyrë aktive dhe të drejtuar drejt një të mësuarit që karakterizohet nga një menduar i thelluar dhe kritik, ku të nxitet jo vetëm zhvillimi i inteligjencës, por edhe i sjelljes. Ai duhet të nxisë dhe ndërtojë aftësinë për të mësuar gjatë gjithë jetës dhe për të akomoduar vetveten në mënyrë funksionale, të suksesshme dhe të përshtatshme me një shoqëri e realitet gjithmonë në ndryshim.

Nisur nga ky vizion, në Strategjinë e Edukimit të UNESCO-s 2014–2021, shprehet qartësisht se për një të ardhme të qëndrueshme sistemi i edukimit, politikat zhvillimore dhe reformat në sistemin e edukimit në mbarë botën duhet të zhvillohen duke synuar rritjen e cilësisë së mësimdhënies, mësimnxënies dhe rezultateve të nxënies, të drejtën e paanshme të aksesit në arsimin e lartë dhe në të mësuarin gjatë gjithë jetës, krijimin e aftësive dhe kompetencave që përgatisin gjithsecilin për tregun e punës, përmirësimin dhe zgjerimin e

mundësive të shkollimit përmes përdorimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit; fuqizimin e nxënësve për të qenë qytetarë krijues dhe të përgjegjshëm; forcimin e edukimit për zhvillimin e qëndrueshëm dhe përfshirjen e tij në kurrikulat e formimit në të gjitha nivelet e ciklet e shkollimit; promovimin e shëndetit përmes edukimit; formësimin e vizionuar në të ardhmen e agjendës të arsimit; largpamësi në hulumtim dhe kërkim; monitorimin e zhvillimit global të arsimit, duke përfshirë këtu ndërtimin dhe përdorimin e instrumenteve normative si dhe ndërtimin e partneriteteve efektive për zhvillimin e arsimit.

Nisur nga këto kërkesa logjike të kohës, reformimi dhe modernizimi i sistemit të Arsimit të Lartë, sot, përfaqëson një nga prioritetet kyçe të strategjive të zhvillimit dhe edukimit në Evropë e më gjerë.

Politikëbërësit dhe reformatorët në të gjithë botën sot kanë arritur në përfundimin se për një shoqëri, e cila duhet t'i përgjigjet në mënyrë aktive ndryshimeve dhe trendeve të kohës një nga kërkesat parësore është që Arsimi i Lartë dhe institucionet e tij duhet t'i përgjigjen, përshtaten dhe paraprijnë ndryshimeve në tregun e punës, zhvillimin e teknologjisë dhe inovacionit si dhe zhvillimeve sociale dhe atyre shoqërore përmes zhvillimit të kërkimit dhe mësimdhënies cilësore.

Sot vëmendja e zhvilluesve dhe planifikuesve në nivel Evropian e më gjerë po përqendrohet në fusha të zhvillimit të arsimit dhe edukimit me ndikim të drejtë për drejtë në zhvillimin e qëndrueshëm si: rritja e numrit të diplomuarve në të gjitha nivelet; rritja e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies; zhvillimi i kapitalit njerëzor; krijimi i mekanizmave funksionalë të qeverisjes dhe financimit të IAL; mbështetje të ekselencës; forcimi i kontributit bashkëpunues për zhvillimin e AL përmes ndërtimit të ciklit njohuri, kërkim dhe tregut të punës; ndërkombëtarizimi i Arsimit të Lartë; lëvizshmëria ndërkombëtare e studentëve, kërkuesve dhe personelit; etj..

Në realitet që të arrihet zhvillimi në këto drejtime e fusha pune, që ato të shndërrohen në pjesë aktive e agjendave të zhvillimit në rradhë të parë duhet parashikuar përfshirja e tyre brenda kornizave

ligjore, ligjeve e akteve nënligjore, të cilat krijojnë mundësinë reale për të kaluar nga një realitet i dëshiruar drejt një realiteti të realizuar, që siguron zhvillim e qëndrueshmëri.

Edhe në Shqipëri në kuadër të këtyre tendencave vizionare Evropiane dhe Botërore, në tre vitet e fundit në kuadër të strategjisë kombëtare të zhvillimit dhe integritet 2020, reformimi dhe modernizimi i sistemit të Arsimit të Lartë është përcaktuar si një ndër prioritet kombëtare, që do të ndikojë në mënyrë aktive në zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.

Në kuadër të këtij procesi pas një analize të thelluar profesionale dhe konsultimesh publike me grupet e interesit u formulua Ligji nr. 80/2016 për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor (AL dhe KSH) në Institucionet e Arsimit të Lartë.

Ky ligj ka si qëllim thelbësor trajtimin e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë si shërbim dhe e mirë publike që kontribuon në rritjen ekonomike, zhvillimin e vendit dhe më gjerë.

Përmes tij synohet që duke përdorur mekanizmat ligjorë të maksimizohet kontributi i Institucioneve të Arsimit të Lartë publike dhe private në zhvillimin dhe rritjen e qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse në vend. Ky ligj synon që të sigurojë zhvillimin e edukimit në Arsimin e Lartë përmes mekanizmave që nuk ia lënë zhvillimin rastësisë, por e sigurojnë atë përmes rregullave e standardeve të përcaktuara në transparencë e frymë bashkëkohore.

Procesi përmes së cilit kaloi formulimi dhe diskutimi i Ligjit të ri të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor në Institucioneve të Arsimit të Lartë (IAL) u përshkua nga filozofia se situata ekzistuese dhe problematikat e zhvillimit në këtë fushë mund të ndryshohen vetëm atëherë kur të hiqet dorë nga justifikimet dhe të punohet për të përmirësuar gjendjen.

Ky ligj ka krijuar premisat për zhvillimin e një Arsimit të Lartë cilësor që u përgjigjet nevojave të tregut të punës dhe drejtimeve të zhvillimit strategjik të vendit. Ai ka krijuar bazat për zhvillimin e një Arsimit të Lartë konkurrues në nivel rajonal, evropian dhe më gjerë

Ligji 80/2015, i Arsimit të Lartë dhe Kërkimit



shkencor në Arsimin e Lartë, është ndërtuar mbi bazën e parimeve themelore për rritjen e përgjegjshmërisë të Arsimit të Lartë dhe institucioneve që e përfaqësojnë atë ndaj shoqërisë dhe interesit publik. Ai mbështetet fuqishëm mbi parimin se cilësia është mjete funksional përmes së cilës mund të sigurohet formimi i brezave të profesionistëve dhe ideatorëve të ndryshimeve të qëndrueshme dhe zhvillimit shoqëror.

Rritja e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor sipas standardeve të Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë (HEAL) dhe Kërkimit Shkencor (KSH) përbën thelbin e përmbajtjes së këtij ligji.

Krijimi i mundësive të barabarta, pa diskriminim dhe mbështetja për shtresat në nevojë është një nga arritjet e tjera që ligji vë në dispozicion të politikave zhvillimore të Arsimit të Lartë dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Ligji parashikon që në grantin e mësimdhënies në mbështetje të Institucioneve publike të Arsimit të Lartë të parashikohet edhe një fond i veçantë për shtresat sociale në nevojë, i cili shpërndahet në formën e bursave. Këto bursa studimi u shpërndahen studentëve që janë shpallur fitues në institucionet publike të arsimit të lartë dhe plotësojnë kriteret për t'u konsideruar si studentë në nevojë.

Ky ligj parashikon gjithashtu edhe shpërndarjen e bursave të studimit për studentët e shkëlqyer në rang vendi, pavarësisht programit të studimit dhe institucionit, në të cilin ata kanë zgjedhur të ndjekin studimet. Ai thekson se studenti vazhdon të përfitojë nga ky fond nëse rezultatet e tij/saj, gjatë gjithë viteve të studimit, vazhdojnë të jenë të shkëlqyera.

Kjo ndërhyrje elegante e ligjit bazohet në parimin e qëndrueshmërisë të dijës dhe kontributit. Ajo shërben si motivues për të promovuar përgatitjen e profesionistëve të talentuar me kontribute të ekselencës që në bankat e shkollës.

Por, kontributi i Ligjit për mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm strategjik nuk mbaron këtu pasi ai parashikon edhe bursa studimi për studentët që kanë zgjedhur të ndjekin programet e studimit në institucione publike të Arsimit të Lartë, që përbëjnë prioritet kombëtar. Bazuar në këtë zgjedhje jo

rastësore Ligji 80/2015 i AL dhe KSH synon të ndikojë aktivisht dhe në mënyrë të planifikuar në mbështetjen e shkollimit në drejtime strategjike që mbështesin zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërisë.

Inovacioni, prosperiteti dhe zhvillimi janë produkte të konkurrimit të lirë të ideve në tregun e punës. Konkurrenca e lirë përbën një nga aspektet e tjera të rëndësishme që mundëson zhvillimin e formimit profesional të brezave, të cilin Ligji 80/2015 AL dhe KSH e mundëson përmes parimeve që prezanton e sjell thjeshtë e në mënyrë të kuptueshme.

Parimet bazë të financimit të institucioneve të arsimit të lartë nga Buxheti i Shtetit janë konkurrenca e lirë midis institucioneve që gëzojnë të njëjtin status; mundësitë e barabarta për institucionet e arsimit të lartë, në varësi të statusit që ato kanë; mbështetja e interesave prioritarë e strategjikë të vendit; shpërndarja e fondeve, bazuar mbi treguesit e cilësisë së institucioneve për mësimdhënien, kërkimin shkencor, veprimtaritë krijuese dhe inovacionin e zhvillimin.

Ligji i AL synon të vendosë veprimtarinë kërkimore në institucionet e arsimit të lartë mbi baza të mirëfillta shkencore, bazuar në fushat prioritare dhe drejtimet strategjike të zhvillimit të vendit si dhe në programet e ofruara nga vetë institucionet e AL. Ai e projekton aksesin mbi fondet dhe financimin e kërkimit në institucionet e AL mbi bazën e meritës dhe cilësisë së performancës duke mundësuar financimin e më të mirëve, të atyre që kontribuojnë në zhvillim dhe në ndryshimin e qëndrueshëm.

Institucionet e arsimit të lartë kanë të drejtë të ofrojnë nëpërmjet veprimtarive kërkimore-shkencore, të zhvillimit dhe atyre krijuese, shërbime për të tretë duke e shdëruar këtë lloj veprimtarie jo vetëm në një burim të rëndësishëm të ardhurash, por edhe në një mundësi për të përmirësuar e përshtatur vizionet zhvilluese në përshtatje me kërkesat e tregut të punës.

Qëllim tjetër i rëndësishëm i Ligjit të AL mbetet përmirësimi i cilësisë së arsimit të lartë në dy drejtimet kryesore: mësimdhënie dhe punë kërkimore-shkencore.

Në strategjinë që ligji propozon për të nxitur e

mbështetur zhvillimin e qendrueshëm të kërkimit shkencor përfshihet edhe vlerësimi i vazhdueshëm i cilësisë së kërkimit përmes procedurave të miratuara për këtë qëllim dhe pasqyrimi i rezultateve të përfituara prej këtij procesi si në renditjen e institucioneve të AL po ashtu edhe në përcaktimin e masës së financimit të tyre çdo pesë vjet.

Kontrolli i cilësisë shtrihet në mënyrë të logjikshme dhe të pashmangshme edhe në vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies. Ai përfaqëson një nga parimet bazë të zhvillimit të IAL.

Kontrollin dhe sigurimin e cilësisë ligji i AL e prezanton dhe e siguron përmes krijimit të bazës ligjore përkatëse, e cila mundëson krijimin e mekanizmave të qendrueshëm të kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë të procesin mësimor.

Ligji i AL vendos si detyrim ligjor krijimin e njëjësive të brendshme të sigurimit të cilësisë si dhe përcaktimin e standardeve kombëtare të cilësisë. Procesi i sigurimit dhe kontrollit të cilësisë sipas ligjit duhet të bazohet në një sistem standardesh shtetëror të cilësisë, të cilat duhet të përputhen me standardet e hapsirës Evropiane të Arsimit të Lartë.

Ligji kërkon si detyrim ligjor që në procesin e sigurimit të cilësisë të përfshihen të gjithë aktorët. Mes tyre duhet të veçohet edhe përfshirja e studentëve, si një nga grupet më të interesuar në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, kusht primar ky për zhvillimin e qendrueshëm të programeve të formimit universitar në përputhje me ndryshimet teknologjike dhe kërkesat e tregut të punës.

Në kuadrin e ndryshimeve me qëllim sigurimin e zhvillimit të qendrueshëm Ligji 80/2015 i AL, për herë të parë sjell konceptin e studimeve të Doktoraturës si pjesë e formimit universitar të ciklit të tretë të studimeve si programe me kohë të plotë. Doktorantët nuk do jenë më të përfshirë me kohë të pjesshme në studimet e tyre të doktoraturës, ata do jenë tashmë pjesë integrale e Departamenteve ku do të zhvillojnë kërkimin shkencor, por edhe ku do të kenë mundësi të përfshihen në procesin e mëmëdhënies.

Ky ndryshim pritet të ketë ndikim të menjëhershëm dhe të drejtëpërdrejtë në përmirësimin e kërkimit shkencor, pasi shfrytëzimi i kohës në përbërje të njëjësive bazë jo vetëm që do t'u mundësojë doktorantëve ritjen e cilësisë së kërkimit të tyre shkencor, por do iu japi mundësi të konfrontojnë e ballafaqojnë idetë mes tyre, të përmirësojnë në mënyrë aktive skemat e kërkimit dhe hulumtimit shkencor dhe në të njëjtën kohë të mund të ndajnë arritjet e tyre me kolegët dhe studentët.

Ky ndryshim do të ndikojë edhe në mobilizimin e IAL për të siguruar fonde për zhvillimin e studimeve të doktoraturës pasi vetëm përmes fondeve do të sigurohej rritja e numrit të doktorantëve dhe zgjerimi i kërkimit shkencor në IAL.

Një tjetër pikë e rëndësishme ku Ligji i AL synon të ndikojë në promovimin e zhvillimit të qendrueshëm është edhe kodifikimi i programeve universitare. Deri më sot në Shqipëri secila prej IAL ka ideuar programet e veta universitare, të cilat kanë gëzuar të njëjtin emërtim (titull) pa asnjë bazë krahasuese mes tyre. Pavarësisht emërtimit të njëjtë të diplomës universitare, asnjë rregullim ligjor i deritanishëm nuk ka siguruar publikun e gjerë dhe tregun e punës se përmbajtja e këtyre diplomave me emërtime të njejta në fushën e kompetancave dhe rezultateve të nxënies të jetë e ngjashme dhe e krahasueshme.

Ligji merr përsipër ta zgjidhë këtë çështje të rëndësishme përmes procesit të kodifikimit. Programet universitare të të njejtit cikël dhe fushë studimi, të cilët do të kenë të njejtin kod duhet të ndërtohen në mënyrë të tillë që të sigurojnë arritjen e një grupi rezultatesh të mësuarit që janë të njejta pavarësisht nga IAL që e ofron atë. Kjo ngjashmëri në nivel programi duhet të jetë deri në masën 70% për të gjithë programet dhe për programet e formimit të mësuesve deri në masën 80%.

Përmirësimi i shërbimeve të ofruara, është një nga sfidat e tjera që Ligji i Arsimit të lartë sjell si kërkesë imediate. Ky proces duhet të çojë hap pas hapi drejt përmbushjes së kërkesave të kohës. Sipas këtij parimi ligji vë përballë IAL jo vetëm kërkesën për të nxjerë profesionistë të mirë, por edhe kompetentë në fushën e tyre të ekspertizës, qytetarë aktivë dhe të ndërgjegjshëm, njerëz të cilët

të dinë të gjejnë rrugën e përshtatjes me ndryshimet shpesh të tregut të punës.

Ligji i ri i AL e delegon vendimmarrjen dhe menaxhimin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor në njësinë bazë (departamentin). Njësia bazë është përgjegjëse tashmë për ngritjen e fondeve përmes projekteve, ofrimin e shërbimeve për të tretët, ngritjen e qendrave kërkimore, përcaktimin e numrit të programeve dhe përmbajtjen e tyre, numrin e studentëve për program, tarifat e shkollimit si dhe përcaktimin e kriterëve për punësimin e stafit të ri bazuar në nevojat dhe planet strategjike të zhvillimit.

Kjo lëvizje strategjike do të ndikojë drejtpërdrejt në afrimin e produktit si në fushën e mësimdhënies dhe në atë të kërkimit shkencor me krijuesit e tij. Sa më afër të jetë vendimmarrja me ata që e ideojnë atë aq më e madhe është mundësia për përmirësimin e cilësisë së produktit të krijuar. Ky proces do kalojë mes llogjikës “check and balance”, ku kërkesat apo ambicjet e Departamenteve do kontrollohen e mbahen në cilësi duke u krahasuar gjithmonë me standardet kombëtare të AL.

Fleksibiliteti i programeve të studimit, lidhja e tyre me tregun e punës, përfshirja e zhvillimeve teknologjike në mësimdhënie dhe mësimnxënie, por edhe shkurtimi i burokracive dhe kohës për kryerjen e procedurave përbëjnë një tjetër kontribut të rëndësishëm të kërkesave që ky ligj shtron për t’u plotësuar nga IAL.

Zhvillim, qëndrueshmëri në zhvillimin e arritur, koncepte, të cilat nuk mund të jenë të prekshme, të arritshme, të matshme dhe të qarta pa krijuar një mekanizëm real dhe funksional të transparencës në drejtim dhe vendimmarrje.

Transparenca në drejtim dhe vendimmarrje, vendimmarrja me pjesmarrje janë kërkesat llogjike që ligji paraqet si shtylla shumë të rëndësishme për përmirësimin e cilësisë dhe shërbimit të ofruar nga IAL.

Ligji i Arsimit të Lartë ka kryefjalë të tij Autonominë universitare. Autonomia universitare në ligjin e AL paraqitet njëkohësisht edhe si balance mes lirisë universitare dhe përgjegjësisë ndaj publikut.

Kjo kërkesë bashkëkohore vjen përmes procesit të modernizimit të qeverisjes së brendshme dhe krijimit të autoritetit administrues.

Institucionet e arsimit të lartë si pjesë e strategjisë për zhvillimin e qëndrueshëm të tyre gëzojnë me ligj liri akademike, autonomi financiare dhe organizative mes së cilës dhe autonominë e përzgjedhjes së personelit të tyre.

Sipas ligjit të AL liria akademike garantohej nëpërmjet së drejtës për të organizuar veprimtaritë e mësimdhënies, ato kërkimore-shkencore, të inovacionit, si dhe veprimtaritë krijuese; për të hartuar dhe zhvilluar programet e studimit dhe për të përcaktuar fushat e veprimtarisë kërkimore-shkencore si dhe për të organizuar procesin e promovimit të personelit akademik.

Ndërkohë që autonomia financiare garantohej nëpërmjet së drejtës për të krijuar të ardhura të ligjshme nga veprimtaritë e mësimdhënies, nga veprimtaritë kërkimore-shkencore, nga të drejtat intelektuale, nga markat dhe patentat, nga shërbimet, nga veprimtaritë artistike e sportive, si dhe nga veprimtari të tjera ekonomike, të cilat përdoren në përputhje me legjislacionin në fuqi; për të përfituar fonde nga shteti dhe organizma të tjerë; për të caktuar rregullat e brendshme të financimit, të shpërndarjes dhe përdorimit të të ardhurave, sipas veprimtarisë dhe nevojave të institucionit; për të përcaktuar tarifat e studimit, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi si dhe për të administruar pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme që institucionet zotërojnë ligjërisht, në përputhje me misionin e tyre.

Autonomia organizative dhe e përzgjedhjes së personelit garantohej nëpërmjet së drejtës të IAL për t’u vetëqeverisur, për të zgjedhur organizmat drejtues, për të organizuar strukturat dhe rregulluar mënyrat e ushtrimit të veprimtarisë së tyre nëpërmjet akteve të tyre të brendshme, të hartuara në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi; për të caktuar kriteret për pranimin e studentëve në programet e studimit, për të lidhur marrëveshje me persona juridikë, publikë dhe privatë, vendas ose të huaj, për zhvillimin e veprimtarive mësimdhënëse, kërkimore-shkencore, kualifikuese, inovative, si edhe veprimtari të tjera

---

të ligjshme; për të caktuar në mënyrë të pavarur numrin e personelit, kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së tij, si dhe për të përcaktuar pagat e personelit, në përputhje me formën e institucionit.

Pavarsisht nga fryma bashkëkohore që përfaqëson, prezanton e mbështet, filozofia e zhvillimit të qëndrueshëm mbi të cilën është ndërtuar Ligji 80/2015, realiteti me të cilin sistemi i Arsimit të Lartë në Shqipëri është përballur nga tetori 2015 e deri më tash ka treguar se edhe prania e një ligji modern, bashkëkohor e me shumë hapsira e vizion të projektuar drejt mbi zhvillimin e qëndrueshëm nuk është i mjaftueshëm për të bërë ndryshim.

Ka kaluar më shumë se një vit dhe Ligji nuk e ka gjetur akoma rrugën që të thotë me zë të lartë atë që mund të bëjë dhe se si mund ta ndihmojë zhvillimin vizionar të Arsimit të Lartë në Shqipëri.

Mungesa e zgjatur e akteve nënligjore, e krijimit të institucioneve shtetërore që do të mundësonin funksionimin e sistemit dhe apatia universitare e kanë lënë ligjin në sirtar!

Ligji sjell frymemarje, liri, mundësi për vendimmarrje me pjesëmarrje aktive të të gjithë aktorëve, por ajo që shoqëria dhe grupet e interesit kanë para e ndjerë deri më tash është se nuk i kanë ndjerë akoma këto mundësi.

Llogjikshëm vjen pyejtja PSE?

A duhet të presim që një ligj të vijë në realitet duke na kujtuar dikush se si mund ta shfrytëzojmë e çfare mund të bëjmë me të?

A duhet të vazhdojmë të bëjmë atë që kemi berë pa u ndalur për të kuptuar çfarë mund të bëjmë më shumë e më mirë?

A duhet të rrimë e të presim që dikush të na njoftojë se ajo që po bëjmë bie në kundërshtim me atë që ligji thotë e kërkon?

A duhet të mendojmë se sa mirë do ishte sikur të bënim ca programe të reja më afër tregut, por sa keq që askush nuk po na i kërkon akoma?

A do ishte e rrugës të thoshim se nuk mundemi, pa e provuar nëse kjo është e vërtetë?

Dhe pyejtjet mund të jenë pa fund.

Që të shkojmë drejt një të ardhme ku zhvillimi të pasqyrojë jo vetëm një ndryshim afatshkurtër që plotëson nevojat e momentit, por një ndryshim që i përgjigjet të ardhmes dhe respektimit të saj, secili prej nesh duhet të dijë të luajë rolin e vet.

Nuk duhet haruar se edhe ndryshimet e vogla të ndërmara në mënyrë kolektive mund të luajnë një rol të madh në ndërtimin e një të ardhme të qëndrueshme!

Për të siguruar zhvillimin e qëndrueshëm, qeveria duhet të pozicionohet në drejtim, por edhe të gjithë ne duhet të mbështesim dhe bëjmë të mundur që ky realitet të bëhet i vërtetë përmes një sërë veprimtarish e veprimesh ndërtuese, të cilat do të mundësonin zhvillimin e kapaciteteve që do bënin të mundur një të ardhme më të mirë, e cila mund të sigurohet me një cilësi të lartë e siguri vetëm përmes zhvillimit të edukimit dhe sistemit arsimor.

## Zhvillimi i qëndrueshëm nga këndvështrimi i shkencave të natyrës Sa është shkenca në bazën e zhvillimit të qëndrueshëm të njerëzimit?

**S**a është shkenca në bazën e zhvillimit të qëndrueshëm të njerëzimit?

Kujtdo që i lind një pyetje e tillë, ndërmendja e parë është vala e herëpashershme e debateve mbi ndryshimet klimaterike në planetin tonë. A ndodhin nga efekti serë që krijojnë mbetjet e prodhimit industrial? Apo janë thjesht cikle të natyrës, të vendosura nga rendi i trupave dhe lëvizjeve në Sistemin Diellor e përtej. A mos shkaktohen nga gazrat e hedhura pa limit prej mjeteve tona motorike të qarkullimit? Çfarë roli ka zhveshja e Tokës nga mbulesa e saj e gjelbër, bimësia dhe pyjet? Ç'po ndodh me shtresën e ozonit? Si mund të mbrohet jeta nga agresioni i grimcave kozmike, nëse kjo shtresë shkatërrohet pa kthim? Si i menaxhojmë mbetjet tona? Sa e ndikojnë ato mjedisin ku duam që të jetojnë dhe pasardhësit tanë? Si po përdoren burimet energjetike që natyra na i fal bujarisht? A po e shpërdorojmë planetin tonë, nëse më tepër i marrim sesa i japim?

Dhe kushdo e di se këto pyetje gjejnë përgjigje të sakta vetëm nga kërkimet e fizikanëve, kimistëve apo biologëve, të mbështetur sigurisht nga matematikanët dhe informaticienët. Në bazën e përgjigjeve qëndron mendimi shkencor, tek i cili njerëzit besojnë. Porse politikat shumë herë nuk e përfillin e as e respektojnë.

Shkenca e shekullit tonë është krejt e aftë dhe profesionale për t'i dhënë me kompetencë përgjigje pyetjeve rreth zhvillimit të qëndrueshëm të shoqërive tona. Ose së paku për të orientuar se ku duhet kërkuar përgjigja.

Janë kërkuesit shkencorë që i kanë ngritur me zë të lartë pyetjet dhe kanë treguar qartë se pse çënimi i zhvillimit të qëndrueshëm është kritik

për fatet e planetit. Alarmi ka kohë që ushëton!

Kush përveçse fizikanët mund të tregonte se në shtresat e sipërme të atmosferës, në stratosferë, ekziston një shtresë e përqëndruar ozoni? E kanë zbuluar para 100 vitesh dhe kanë provuar me kompetencë se kjo shtresë krijohet nga rrezatimi i rrezikshëm ultravjollcë diellor. Dhe që kjo shtresë e pengon rrezatimin e rrezikshëm të depërtojë fuqimisht shtresat e mëposhtme të atmosferës.

Kush përveçse astrofizikanët mund të tregonte se rrezatimi ultravjollcë vjen nga Dielli? Që si yll i zakonshëm i Universitetit çliron këtë rrezatim përmes proceseve të veta termobërthamore.

Kush përveçse biologët mund të tregonte se rrezatimi ultravjollcë shkatërron ADN e qelizave të gjalla? Pra që çënimi i shtresës së ozonit prish ekuilibrat bazë të mundësisë dhe zhvillimit të jetës. Dhe e kthen planetin Tokë në një shtëpi të pabanueshme.

Kush përveçse kimistët mund të tregonte se janë molekulat me përbërje klori ato substanca kimike që shkatërrojnë shtresën e sipërme të ozonit? Në veçanti, kloroflorokarburet CFC, të sintetizuara që në vitet 30 për interesa të zhvillimit industrial, e kanë pesëfishuar përqëndrimin e substancave gëlltitëse të ozonit në shtresat e larta të atmosferës, duke këputur zinxhirin e ekuilibrit dinamik. Duke krijuar vrima të mëdha të pranisë së ozonit.

Kush përveçse të gjithë shkencëtarët bashkërisht dhanë alarmin dhe detyruan politikën të reagojë? Për këto arsye, raportet e fundit tregojnë që shtresa e rrezikuar e ozonit po stabilizohet.

Shkenca ka zbuluar mundësitë e burimeve të reja të energjisë dhe ka orientuar teknologjitë më inteligjente për t'i shfrytëzuar ato.



---

Energjia e erës, energjia e baticave dhe zbaticave në oqeanë, energjia e rrymave të forta oqeanike apo energjia direkte diellore janë propozimet që fizika i ka ofruar krahas energjisë së ujit apo asaj bërthamore, e krahas energjisë së karbureve sigurisht.

Edhe biomasa mund të shfrytëzohet, thonë biologët, të shfrytëzohet me kritere të forta që ruajnë ekuilibrat në dobi të vazhdimësisë së jetës.

Të gjitha këto burime janë fjala e ditës në debatet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe zbatimi më interesant në vendet e zhvilluara europiane.

Zhvillimi i shkencës jep zgjidhje për qarkullim motorrik më miqësor me mjedisin: makina me teknologji të avancuara, që shpenzojnë më pak lëndë djegëse dhe që hedhin më pak gazra të dëmshme në atmosferë, dalin përditë në konkurrencë me njëra-tjetrën. Makinat elektrike e makinat me hidrogjen po zëvendësojnë gradualisht makinat e vjetra ndotëse. Për to, shkenca dhe teknologjia janë fokusuar tek idetë më novatore.

Përmes planifikimit shkencor telematik, qarkullimi rrugor është shumë më eficient, kursen kohë dhe shmang lëvizjet e tepërta e të panevojshme, duke ulur shpenzimin e energjisë dhe ndotjen e mjedisit. Dobinë e komunikimit GPS e njohin të gjithë, dhe të gjithë e dinë se pas tij qëndron fizika me valët elektromagnetike të komunikimit dhe informatika me programet e saj inteligjente organizuese.

Bioteknologjia, përpos progresit në diagnostikim dhe terapi, po ndjehet gjithnjë e më e pranishme në zinxhirin e proceseve të komanduara nga njeriu përmes mikroorganizmave, si bakteriet dhe këpurdhat. Të cilat në dijen e përgjithshme njihen si të dëmshme për organizmin, dhe vërtet ka plot të tilla që paraqesin rrezik për shëndetin publik. Por disa prej tyre janë të nevojshme dhe pjesë e rëndësishme e proceseve në trupin tonë. Biologjia dhe mjekësia kanë treguar se rreth njëmijë lloje bakteresh bashkëjetojnë me ne, na ndihmojnë të tresim ushqimin, punojnë për të prodhuar vitaminat që na mbajnë në shëndet

të mirë apo ruajnë imunitetin tonë kundër sëmundjeve. Të njejtën gjë bëjnë dhe për të mbajtur një cikël dinamik ekuilibri të jetës në natyrë, madje duke shpërbërë edhe substancat kimike toksike.

Prandaj shkenca po i përdor në cilësinë e tyre dobiprurëse të pastrimit të mjedisit e të ujrave, të shpërbërjes së mbetjeve të prodhimeve tona apo të ruajtjes së ushqimeve nga prishja. Sa më pak prodhime të shkatërruara, aq më pak energji e kotë e marrë nga natyra e aq më pak mbetje që çenojnë zhvillimin e qëndrueshëm.

Të gjitha këto probleme dhe zgjidhje dëgjohen shpesh në terminologjinë e ambientalistëve dhe janë shndërruar në tema familiare për njerëzit. Për këtë arsye, në politikat e vendeve të zhvilluara po ndodh progresivisht përfshirja e komunitetit shkencor në vendimmarrje.

Kërkimi shkencor është aktualisht i orientuar për të kuptuar rrjedhimet që veprimet tona i kushtojnë natyrës dhe për të zbutur e shmangur ato pasoja të akteve që janë agresivitet i rrezikshëm për ekuilibrat qindramiliona vjeçarë të jetës në Tokë.

Këto çështje janë jetike për të sotmen e për të ardhmen e njerëzimit. Ato kanë angazhuar një pjesë të konsiderueshme të potencialit shkencor, atë pjesë që më së shumti quhet aplikative, zbatuese.

Unë dua në veçanti të theksoj rolin e shkencës fundamentale, që zhvillohet në struktura të tilla gjigande si CERN, NASA apo ESA. E para, CERN, Qendra Europiane e Kërkimit Bërthamor, i dedikohet mikrobotës. Dy të tjerat, NASA dhe ESA, Agjencitë Hapësinore Amerikane apo Europiane, shpenzojnë miliarda për të studiuar Universin, që nga Sistemi i afërt Diellor, te Galaksia jonë, grupet e galaksive, trupat miliarda vite-dritë larg e deri tek origjina e lindjes së Universit. Duket sikur fokusi i tyre është larg problemeve të jetës së përditshme dhe shpesh në kërkuesit që merremi me to ndjehemi sikur fluturojmë mbi planetin tonë dhe nuk ulemi mbi të.

Por është e kundërta.

Sa herë shtrohet kjo çështje, studiuesit e mikrobotës në CERN e kanë gati një përgjigje të thjeshtë dhe bindëse: ëëë, mënyra e komunikimit botëror sot përmes Eorld Eide Eeb, ka lindur atje, në CERN. Ky institucion mitik i studimit të strukturave më të thella të lëndës dhe grimcës, e ka zbatuar për herë të parë rrjetin ëëë për nevojat e veta. Dhe ky produkt i tij dytësor, sot ka pushtuar botën.

Po sigurisht kjo është pak, tepër pak për të argumentuar rëndësinë e CERN. Është vetëm një argument gjatë minutave të një kafeje pirë me ata njerëz që nuk janë shumë miqësorë me shkencat fundamentale. Por zbulimet e CERN prekin bashkëveprimet më bazike në natyrë, pa të cilat asnjë shkencë nuk mund të bëjë hapa para. Se zbulimet në mikrobotë i zgjerojnë limitet tona të njohjes dhe janë bazë për çdo shkencë tjetër aplikative.

E njejta dhe për shkencat e Universit të largët, që janë fundamentale në epokën e sotme. Tek to dua të ndalem në veçanti.

Që në agimin e njerëzimit, astronomia ka qenë faktor i rëndësishëm zhvillimi. Bukuria e qiellit ka tërhequr vëmendjen, rregullsia e lëvizjes së trupave qiellorë ka nxitur imagjinatën dhe kuriozitetin. Lëvizjet e Diellit dhe të yjeve filluan të njiheshin e të parashikoheshin, dhe si të tilla u kthyen në faktor themelor të lindjes së aktiviteteve të rëndësishme si bujqësia dhe lundrimi. Kërkimi për të njohur dhe shpjeguar lëvizjen e planeve në qiell çoi në ligjet më universale të fizikës.

Astronomia vazhdon të luajë rol thelbësor edhe në shoqërinë moderne, sepse është kombinim unik i shkencës, teknologjisë dhe kulturës.

Sot Universi gjigand, me sinjalet që dërgon, është laborator më perfekt dhe më i çmuar, ku ne testojmë ligjet tona të fizikës, kimisë apo biologjisë si dhe skenaret teorike të formimit të botës dhe ato të jetës.

Ciklet e evolucionit të yjeve, që na shfaqen në teleskopë në të gjitha fazat, na tregojnë se si

janë formuar elementet kimike, ato elemente që përbëjnë çdo qelizë të trupit tonë dhe çdo gram të planetit tonë.

Astrofizika sot ka modele shumë të konfirmuara të lindjes dhe evolucionit të Universit. Retë ndëryjore i japin informacion të bollshëm astrokimisë dhe astrobiologjisë për të konfirmuar modelet mbi formimin e substancave kimike e deri të molekulave organike, blloqe bazë të ndërtimit të qenieve të gjalla.

Në shtator 2015, fizikanët për herë të parë në historinë e njerëzimit, kapën valët gravitacionale. Ishte një përpjekje e gjatë disadekadëshe, me eksperimente shumë të holla, bazuar në Teorinë e ngritur nga gjenia e Einstein-it. Ngjarjet astrofizike që i lindin këto valë janë ekstremisht energjike, përplasje trupash gjigandë shumë të dendur, të cilat shoqërohen me procese fizike të aprovuara në kushte tokësore.

Vala e fundit, e kapur me 17 Gusht 2017, vinte nga përplasja e dy yjeve neutronike, mbi 100 milionë vite më parë. Ajo provoi një tërësi modelesh fizike të ngritura prej dekadash, por që nuk provoheshin në kushte tokësore.

A e dinit se ari i unazës që mbani në gisht është krijuar në një proces të tillë kaq të dhunshëm sa përplasja e dy yjeve neutronike? Që duhet të ketë ndodhur mbi pesë miliardë vite më parë në zonën jo larg yjeve që na rrethojnë.

Ky ishte vetëm një shembull krahas dhjetra e dhjetra të tjerëve, që tregojnë sesi Astrofizika dhe të gjitha Shkencat e Universit zgjerojnë kufijtë e njohjes sonë fundamentale. Pa to, do ishte e pamundur të kemi fotocelula të mira që përdorin energjinë diellore, reaktorë bashkëkohorë të prodhimit të energjisë bërthamore, përpjekje për të prodhuar energji sa më të pastra e më pak të dëmshme për planetin.

Po t'i kthehemi historisë së largët e të afërt të zhvillimit të astronomisë, gjemë se ajo ka qenë shtysë për zhvillimin e teknologjive të avancuara. Nevoja e saj për të marrë të gjithë informacionin e mundshëm nga Universi, çoi në fabrikimin e teleskopëve më të përsosur optikë

---

apo infrakuq, të antenave më moderne radio dhe të detektorëve më të ndjeshëm në gjatësitë e shkurtëra të valës.

Arritje që arti inxhinierik apo elektronika e sofistikuar i përdorin edhe në sfera të tjera. Sot teleskopët dhe detektorët po adoptojnë teknika tepër të holla optike. S'mund të ndodhë ndryshe, nëse guxohet që të ndërtohet teleskopi me pasqyrë gati 40m. Gjithë inteligjenca shkencore dhe inxhinierike derdhet në paisje të tilla mahnitëse për nga finesa dhe guximi shkencor.

Astronomia kontribon në veçanti në kulturën moderne. Astronomi është historiani më i saktë dhe që heton më larg se kushdo tjetër. Sinjalet që vijë nga miliona e miliarda vite më parë, janë burimi më i saktë i historisë së shkuar. Teleskopët janë makina kohe. Ato na kthejnë shumë pas, jo me mijra, por me miliona e miliarda vite më parë. Zbulimi i historisë së Universit ka qenë arritja më madhore e shkencës së dekadave të fundit, ajo kurorëzoi të gjitha gjetjet më fundamentale të shkencave të natyrës.

Një nga funksionet më të rëndësishme, që astronomia e arrin si askush tjetër, është edukimi, arsimimi. Duke qenë shkencë shumë e afrueshme dhe mahnitëse për rininë, ajo është kthyer në një mjet të shkëlqyer për të ilustruar progresin e shkencës dhe teknologjisë. Bukuria e objekteve kozmike, pafundësia e Universit, janë frymëzuese. Ato hapin perspektivë sociale që nxit bashkëpunimin, internacionalizmin dhe tolerancën. Tërheqja nga astronomia i ka nxitur shumë të rinj t'i futen shkencës dhe teknologjisë, duke u kthyer në vlera për shoqërinë, për progresin dhe për zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm.

Shkencat fundamentale ndodhen në ballë të kërkimit shkencor, teknologjisë dhe inovacionit. Ato kërkojnë infrastrukturë të fuqishme, por të japin dije të reja, teknologji unike, inovacion të hollë dhe bashkësi njerëzish ekselentë, të cilët janë vlerë e madhe e njerëzimit.

Po në vendet e vogla si Shqipëria, a ka rëndësi kërkimi shkencor? A ka vend për shkencë fundamentale dhe zbatuese?

Është shumë e rëndësishme të kuptohet nga shoqëria shqiptare se bashkësia e kërkuesve shkencorë përbën një shtresë të pazëvendësueshme referimi e zhvillimi.

Kërkuesit shqiptarë mund dhe duhet të jenë pjesë e ekipeve ndërkombëtare. Tashmë shkencë nuk ka kufij, komunikimi kryhet në çast, informacioni është pasuri e përbashkët. Jetojmë në të njejtin planet, ndajmë të njejtin fat, shkëmbejmë me të njejtën gjuhë universale: gjuhën e shkencës.

Shkencë zhvillon ekselencën, individuale apo kolektive. Ekselencë është e paçmuar në vendet e vogla. Sfidat intelektuale janë pjesë e garës, që frymëzohet veçanërisht nga kërkimi shkencor.

Çdo vend ka nevojë për kërkimin shkencor. Ai është baza e zhvillimit të qëndrueshëm.



Prof. Dr. Aurela Anastasi  
Universiteti i Tiranës,  
Fakulteti i Drejtësisë

## Çështje të reformës në drejtësi & ...

### Projeksione rreth dhe për zhvillimin e qëndrueshëm...

**D**imensioni më i rëndësishëm i Reformës në Drejtësi, është ai i pavarësisht të pushtetit gjyqësor dhe aftësimin e tij për të luftuar korrupsionin. Ky dimension zë vend të rëndësishëm edhe në amendamentin kushtetues që u miratua në këtë kuadër. Pikërisht, në këtë kumtesë, kam analizuar disa aspekte lidhur me këtë çështje, parë rëndësinë e saj dhe përkushtimin e opinionit publik për ndryshimet kushtetuese që synojnë parandalimin e korrupsionit në sistemin e drejtësisë dhe gjatë.

Nevoja për ndryshime kushtetuese u evidentua qartë nga analiza e kryer mbi gjendjen aktuale të sistemit të drejtësisë në Shqipëri. Pas një faze paraprake diskutimesh, të gjitha grupet e punës të krijuara pranë Komisionit të Posaçëm Parlamentar të Reformës në Drejtësi, kurorëzuan gjetjet e tyre në një dokument analitik<sup>3</sup>. Në disa nga çështjet e tij parashtrorë nevoja për marrjen e masave me qëllim parandalimin dhe ndalimin e korrupsionit në organet e drejtësisë, pavarësimin e tyre nga ndikimet politike, si dhe rritjen e efektivitetit dhe të profesionalizmit të sistemit të drejtësisë.

Puna për hartimin e amendamenteve kushtetuese, kaloi nëpër disa faza të rëndësishme<sup>4</sup>: hartimi i projektit të amendamenteve nga ekspertët, diskutimi i tyre me publikun dhe grupet e interesit, diskutimi me ekspertë të partive politike, si dhe marrja e reflektimit të opinionëve nga Komisioni i Venecias<sup>5</sup>. Projekti i përmirësuar i projektamendamenteve mbi bazën e sugjerimeve dhe komenteve të përfuara nga ky proces, u diskutua dhe u miratua me sugjerimet përkatëse nga Komisioni i Posaçëm

Parlamentar për Reformën në Drejtësi projekt i cili u paraqit Seancës Plenare të Kuvendit më 21 Korrik 2016 dhe u miratua prej saj njëzëri<sup>6</sup>. Deri në ditën e miratimit të këtij akti kushtetues u shtruan një sërë dilemash që kishin të bënin me përmbajtjen e tij. Por, aktualisht, këto dilema përqendrohen në zbatimin e këtij akti. Për këtë, në radhë të parë është e rëndësishme që teksti i ri i amendamenteve të kuptohet mirë, me qëllim zbatimin e tij efikas, si drejtpërdrejt, ashtu edhe përmes ligjeve përkatëse.

Historikisht, e gjithë ngrehina Kushtetuese në botën moderne lindi si një instrument kundër korrupsionit të rendit feudal të kohës dhe sidomos kundër korrupsionit mbretëror. Sot, të gjitha kushtetutat demokratike sanksionojnë instrumentet klasike kundër korrupsionit si, parimin e ndarjes së pushteteve, pavarësinë dhe paanshmërinë e gjykatave, mbrojtjen e statusit të gjyqtarit sa kohë që ky i fundit mban një qëndrim korrekt, papajtueshmëritë e detyrës së gjyqtarit me veprimtari të tjera shtetërore apo private, përgjegjshmërinë e gjyqtarit, etj.

Pyetja legjitime që lind këtu është: përderisa këto institute ekzistojnë aktualisht në Kushtetutën tonë, cilat janë garancitë e reja që ofron ky ndryshim? Duhet theksuar se, amendamenti ka synuar rritjen e eficiencës së këtyre garancive, duke korrigjuar dhe përmirësuar instrumentet e parashikuara në Kushtetutë, si dhe duke sanksionuar struktura të reja që luftojnë korrupsionin. Në vijim po analizojmë disa nga masat të parashikuara prej tij kundër korrupsionit, të cilat mund t'i klasifikojmë në masa të përhershme (në kuptimin e vazhdimësisë të tyre, sa kohë amendamenti do të jetë në fuqi) dhe në masa të përkohshme, të cilat lidhen me vlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve.

<sup>3</sup>Analizë e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri", Komisioni i posaçëm parlamentar për reformën në sistemin e drejtësisë, Tiranë, 2015.

<sup>4</sup>Për njohjen e procesit shih: <http://ëëë.reformanedrejtësi.al/>

<sup>5</sup>Shih: Venice Commission, On the revised draft constitutional amendments on the judiciary (of 15 January 2016) of Albania, [http://ëëë.venice.coe.int/ëëëforms/documents/?pdf=CDL-AD\(2016\)009-e](http://ëëë.venice.coe.int/ëëëforms/documents/?pdf=CDL-AD(2016)009-e)

<sup>6</sup>Ligj nr. 8417, dt. 21.10.1998, "Kushtetuta e RSH", ndryshuar me ligjin nr. 76/2016, dt. 22.7.2016.

## 1. Imuniteti i gjyqtarit.

Konkretisht, ndryshime të rëndësishme kanë pësuar dispozitat që sanksionojnë imunitetin e gjyqtarëve. Pas ndryshimeve kushtetuese të vitit 2012, gjyqtarët gëzonin një imunitet të kufizuar nga procesi penal<sup>7</sup>. Ndryshimet e reja e heqin atë tërësisht. Kjo, u hap rrugë të lirë të gjitha hetimeve dhe kontrolleve ndaj gjyqtarit, si dhe masës së arrestit pa pasur nevojë për ndonjë autorizim paraprak të organeve kompetente. Ndërkohë, Kushtetuta garanton imunitet në kryerjen e funksionit, kur sanksionon se, gjyqtari “gëzon imunitet për mendimet e shprehura dhe vendimet e marra në ushtrim të funksioneve të tij...” (neni 137 i Kushtetutës). Megjithatë, sipas amendamentit të ri, gjyqtari është përgjegjës në rastet e dhënies qëllimisht, të një vendimi si pasojë e një interesi vetjak ose keqbesimi. Rastet kur vendimi i gjyqtarit është dhënë qëllimisht si pasojë e një interesi vetjak ose keqbesimi, do të tregohen nga praktika. Paraprakisht, mund të themi se këto raste përfshijnë ato në të cilat vendimi është dhënë me keqdashje nga pikëpamja subjektive.

Gjyqtari mund të procedohet penalisht kur vendimi i paligjshëm është dhënë si rezultat i kryerjes së një krimi të parashikuar nga Kodi ynë Penal (p.sh., korrupsioni pasiv), ose për interesa personale, p.sh., duke shkelur parimin e paanshmërisë që lidhet gjithashtu, me rastet e veprave penale të shpërdorimit të detyrës, etj.

Ky sanksionim i ri është një ndryshim thelbësor krahasuar me formulimin ekzistues dhe madje, do t'i japë fund praktikës së vendosur nga Gjykata Kushtetuese, e cila ka shfuqizuar si antikushtetues nenin 315 të Kodit Penal “Dhënia e një vendimi të padrejtë”, duke mos lejuar procedimin penal të gjyqtarëve kur japin vendime përfundimtare të padrejta në mënyrë të qëllimshme<sup>8</sup>.

## 2. Papajtueshmëria e detyrës së gjyqtarit me veprimtari të tjera.

Përcaktime më të detajuara bëhen për papajtueshmërinë e detyrës së gjyqtarit dhe të prokurorit, me veprimtari të tjera. Në ndryshim nga formulimi ekzistues.

Amendamenti sanksionon se “*Qenia gjyqtar nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër politike ose shtetërore, si dhe veprimtari profesionale që ushtrohet kundrejt pagesës, me përjashtim të aktivitetit mësimdhënës, akademik, shkencor, si dhe delegimit pranë institucioneve të sistemit të drejtësisë, sipas ligjit*” (neni 143). Kjo dispozitë ka sjellë ndryshime në raport me dispozitën e mëparshme ekzistuese, e cila nuk parashikonte ndonjë mundësi për të ushtruar veprimtari të tjera, megjithatë ishte interpretuar si një dispozitë që nuk ndalonte veprimtarinë mësimdhënëse e shkencore të gjyqtarëve. Kështu, gjyqtarët rëndom kryenin veprimtari mësimdhënëse në universitete publike private. Jo vetëm kaq, por në mjaft raste ata janë ngarkuar nga këto institucione edhe si titullarë të departamenteve, titullarë të lëndëve mësimore, ose kryetarë në komisione të ndryshme për ndarjen e fondeve, bursave të studimit, apo për marrjen në punë të punonjësve universitarë.

Dispozita e re në Kushtetutë është më e detajuar dhe duhet kuptuar si një mundësi për gjyqtarët për të ushtruar jashtë veprimtarisë së përditshme, vetëm aktivitet mësimdhënës dhe kërkimor shkencor për zhvillimin e doktrinës dhe jo çdo veprimtari me karakter administrativ që ka nëpër institucionet mësimdhënëse e shkencore.

Ligjet përkatëse nuk autorizojnë papajtueshmëri të tjera, veç atyre të parashikuara në Kushtetutë. Ato bëjnë një rregullim më të hollësishëm vetëm brenda kuadrit të këtyre veprimtarive.

Kur amendamenti thekson “*...si dhe delegimit pranë institucioneve të sistemit të drejtësisë, sipas ligjit*”, krijon mundësinë që veprimtaria e gjyqtarëve për nevoja të zhvillimeve të projekteve, të hartimit të projektligjeve ose veprimtarive të tjera në kuadër të institucioneve të drejtësisë, të jetë jo vetëm e dobishme, por edhe e nevojshme.

Amendamenti angazhohet gjithashtu, edhe në parashikimin shprehimisht të papajtueshmërisë së detyrës së gjyqtarit me veprimtaritë politike. Ai vendos pamundësinë e kandidimit për të qenë gjyqtar për personin që ka mbajtur funksione politike në administratën publike, ose pozicione

<sup>7</sup> Ligj nr. 88/2012, dt. 18.09.2012

<sup>8</sup> Shih: Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 11, dt. 02.04.2008

drejtuese në parti politike, gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit (neni 136/4).

### 3. Përgjegjësia e gjyqtarit.

Disa artikuj u janë dedikuar *çështjeve për krijimin e një mekanizmi më efikas për përgjegjësinë e gjyqtarëve*. Në këtë kuadër janë përcaktuar më qartë rastet e shkarkimit të anëtarëve të Gjykatës së Lartë (neni 140), si dhe të deklarimit të mbarimit të mandatit (neni 139), duke reflektuar debatet dhe interpretimet e ndryshme që ishin zhvilluar për këto çështje.

Procedurat e tjera të procesit disiplinor u referohen ligjeve përkatëse. Sidoqoftë, në Kushtetutë është vendosur një mekanizëm më efikas për procedimin disiplinor të gjyqtarëve në rastin e shkeljeve të rënda profesionale dhe etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e tij. Për herë të parë.

Projekti sjell një ndarje të funksionit kushtetues të hetimit dhe të procedimit disiplinor, nga gjykimi dhe vendosja e masave disiplinore. Krijohet Inspektori i Lartë i Drejtësisë, i cili ka detyrë të verifikojë të gjitha ankesat ndaj gjyqtarëve dhe funksionarëve të tjerë, me përjashtim të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese (nenet 147/d-147/ë).

Deri më sot, kjo çështje rregullohej me ligj përmes dy inspektorateve, njëri në varësi të Ministrit të Drejtësisë dhe tjetri në varësi të vetë Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD). Në bazë të Kushtetutës, ky i fundit ishte organi që *“vendos... për përgjegjësinë disiplinore sipas ligjit”* për gjyqtarët. Kurse, prokurorët i nënshtroheshin një regjimi tjetër të procedimit disiplinor të parashikuar me ligj.

Fakti që edhe hetimet e procedimet, edhe vendimet përfundimtare për masat disiplinore merren nga vetë ky këshill, nuk ka garantuar një ndarje të mirë të përgjegjësisë për këto procese. Një premisë për arbitraritet krijonte edhe e drejta ekskluzive e Ministrit të Drejtësisë për të filluar procedurën disiplinore kundër gjyqtarëve. Nga ana tjetër, të dëmshme ishin rastet kur Ministri ka marrë një përgjigje jologjore nga anëtarët e KLD-së, duke keqpërdorur mospërgjegjësinë që kanë organet kolegjiale për vendimmarrjet e tyre.

Krijimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë si një organ

kushtetues i pavarur do të krijojë mundësinë për të formësuar dhe specializuar më mirë hetimin dhe procedimin disiplinor të gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë, si dhe inspektimin e gjykatave dhe zyrave të Prokurorisë. Ai do të evitojë dualizmin e dy inspektorateve, përplasjen dhe transferimin e përgjegjësisë.

Shkeljet disiplinore për gjyqtarët e të gjitha niveleve do të gjykohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, kurse Këshilli i Lartë i Prokurorisë do të gjykojë prokurorët. Ndërkohë, anëtarët e këtyre këshillave, Prokurori i Përgjithshëm dhe vetë Inspektori i Lartë i Drejtësisë, nuk mbeten jashtë përgjegjësisë disiplinore. Nëse ndaj tyre ka pretendime për shkelje disiplinore, ata gjykohen nga Gjykata Kushtetuese. Rasti i gjykimit të përgjegjësisë disiplinore të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese bën ndryshim nga të gjitha institucionet e tjera të drejtësisë, pasi ata procedohen dhe gjykohen nga vetë Gjykata Kushtetuese.

### 4. Struktura e posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Në amendamentin e ri parashikohet krijimi i një kompleksi organesh të specializuara për hetimin, procedimin penal dhe gjykimin e veprave penale që lidhen me korrupsionin. Krijohen gjykatat e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit, krimit të organizuar, si dhe të akuzave penale kundër funksionarëve të lartë. Krijohet prokuroria e posaçme për ndjekjen penale të këtyre veprave dhe njësi posaçme për hetimin e tyre. Këto struktura krijohen dhe funksionojnë në mënyrë të pavarur nga gjykatat e tjera dhe prokuroria.

Sanksionime të reja ka në lidhje me hetimin dhe gjykimin e funksionarëve të lartë.

Në zbatim të Kushtetutës (neni 141), juridiksioni për veprat penale që përfshijnë këta zyrtarë i përkiste Gjykatës së Lartë. Amendamenti eliminon tërësisht juridiksionin fillestar të Gjykatës së Lartë. Pra, me fjalë të tjera, Gjykata e Lartë nuk do të jetë më kompetente për të gjykuar në shkallë të parë akuzat penale kundër funksionarëve të lartë të institucioneve kushtetuese si, Presidenti i

Republikës, Kryeministri dhe ministrat, deputetët, gjyqtarët e Gjykatës së Lartë dhe gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese. Miratimi i këtyre ndryshimeve në Kushtetutë, do të sjellë efikasitet në hetimin dhe procedimin e zyrtarëve të lartë.

Pyetja që shtrohet lidhet me faktin se, përse këto struktura përmenden në Kushtetutë, ndërkohë që mund të krijoheshin me ligj, ashtu sikurse mund të krijohen gjykata të tjera për çështje të veçanta. Struktura të tilla janë krijuar me ligj edhe në shtete të tjera si, Bullgaria, Rumania, etj. Parashikimi në mënyrë të veçantë i tyre në Kushtetutën e Shqipërisë, nuk lidhet thjesht me përparësitë që ka ky amendament për luftën kundër korrupsionit.

Parashikimi nga Kushtetuta garanton krijimin dhe vazhdimësinë e punës së tyre, pavarësisht nga ndryshimet e shpeshta të ligjit të posaçëm. Për më tepër, vetëm Kushtetuta mund të lejojë regjimin e veçantë të cilit duhet t'u nënshtrohen të gjithë punonjësit e tyre. Gjyqtarët dhe prokurorët, si dhe punonjësit e administratës së këtyre strukturave, përfshirë edhe familjarët e tyre të afërt u nënshtrohen hetimit të pasurisë dhe të figurës, kontrolleve periodike të llogarive bankare, transaksioneve financiare dhe telekomunikimeve personale, sipas procedurave të përcaktuara me ligj (art.135/4). Një cenim i tillë i jetës së tyre private është parë nga hartuesit si proporcional, nga kushtet dhe rrethanat që dikton realiteti shqiptar, si dhe nga nevoja për të luftuar korrupsionin. Megjithatë, garanci reale për këtë proces parashikohen në ligjet e posaçme, referuar kjo edhe opinionit të Komisionit të Venecias për këtë aspekt. Sipas këtij Opinioni:

Komisioni i Venecias e kupton se *“shkalla e problemit të korrupsionit në Drejtësi kërkon masa të posaçme... megjithatë, Kushtetuta nuk mund të japë një “kartë të bardhë” ndaj shërbimeve të sigurisë për të përgjuar të gjitha komunikimet e gjyqtarit/prokurorit të specializuar e në veçanti të familjarëve të tyre. Kjo “mbikëqyrje e telekomunikimit” duhet të shoqërohet me garanci procedurale të përshtatshme dhe efektive, duke i mbrojtur këta persona nga abuzimet...”*<sup>9</sup>.

<sup>9</sup> Shih: Venice Commission, On the revised draft constitutional amendments on the judiciary (of 15 January 2016) of Albania, vep. Cit., fq. 12/paragrafi 51.

## 5. Rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve dhe i prokurorëve.

Amendamenti Kushtetues është pajisur me një aneks i cili vendos masat e përkohshme për rivlerësimin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve. Vendosija e këtij procesi në Kushtetutë garanton mbrojtjen e gjyqtarëve që janë të përshtatshëm për ushtrimin e detyrës së tyre, sikurse ka kërkuar edhe Komisioni i Venecias në opinionin e tij. *“Sa i përket masave të jashtëzakonshme për të vlerësuar gjyqtarët dhe prokurorët, Komisioni i Venecias i mbetet opinionit se këto masa janë jo vetëm të justifikuar, por edhe të nevojshme për Shqipërinë, për ta mbrojtur atë nga prekja e korrupsionit, i cili nëse nuk adresohet, mund të shkatërrojë tërësisht sistemin e saj gjyqësor”*<sup>10</sup>. Për kryerjen e këtij rivlerësimi ngarkohen organe gjyqësore administrative të posaçme që ndërtohen jashtë organeve të sistemit gjyqësor aktual, me një funksionim të përkohshëm të ndarë prej tyre. Konkretisht, procesi zhvillohet përpara Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, vendimi i të cilit mund të ankimohej në Kolegjin e Posaçëm të Apelit që ngrihet dhe funksionon pranë Gjykatës Kushtetuese të RSH. Dy komisionerë publikë përfaqësojnë interesin publik dhe mund të paraqesin ankim kundër vendimit të Komisionit. Parashikimi i Misionit Ndërkombëtar të Monitorimit, si organ që e monitoron këtë proces, përbën gjithashtu, një garanci kushtetuese për mirorganizimin dhe mirëfunksionimin e këtyre komisioneve.

Ky rivlerësim do të kryhet në tri aspekte kryesore, në lidhje me kontrollin e pasurive të gjyqtarëve, të prokurorëve, etj., me figurën e tyre dhe zbulimin e lidhjeve të tyre me krimin e organizuar, si dhe me vlerësimin e aftësive të tyre profesionale. Amendamenti parashikon dispozita që lejojnë përmbysjen e barrës së provës në këtë proces. Si rregull, detyrimi për të provuar akuzat i përket organit që procedon, por në këtë rast, barra e provës i kalon personit. P.sh., kur gjyqtarit ose prokurorit u identifikohen pasuri në vlerë më të madhe se sa pasuria e ligjshme, subjekti i vlerësimit ngarkohet me barrën e provës për të vërtetuar të kundërtën. Kjo ndodh vetëm për procesin e rivlerësimit që ka natyrë administrative e disiplinore, por jo për

<sup>10</sup> Po aty, fq.12, paragrafi 52




---

procesin e mundshëm penal, në të cilin barra e provës i mbetet Shtetit.

## 6. Konkluzione

*Në përfundim*, mund të themi se Amendamenti Kushtetues për Reformën në Drejtësi sjell garanci, procedura dhe institucione të reja për të eliminuar korrupsionin në radhët e drejtësisë dhe në të gjitha veprimtaritë e tjera në shtet. Nga zbatimi i këtij Amendamenti krijohen mundësi të reja për të rritur pavarësinë e organeve të drejtësisë nga presionet politike, nga ndërhyrjet e ekzekutivit, si dhe nga presionet e të tretëve për korrupsionin e tij. Ai do të sjellë një forcim të institucioneve për të garantuar rritjen e efektivitetit të të gjithë sistemit të drejtësisë, por vetëm nëse do të ketë një kuptim të ri dhe një zbatim të ndershëm i dispozitave të tij. Për këtë është e rëndësishme që të kuptohen qartë ndarjet e funksioneve institucionale që sjell ky akt, si dhe marrëdhëniet e bashkëpunimit dhe të kontrollit midis tyre. Gjithashtu, duhet të rekrutohen anëtarë të pakorruptuar e profesionistë në përbërje të këtyre organeve. Asnjë prej dispozitave të vlerësimit të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në këtë amendament, nuk mund të kuptohet si amnisti ndaj tyre, për aktet e paligjshme që kanë kryer gjatë ushtrimit të funksionit.



Prof. Dr. Arta Mandro (Balili)  
Shkolla e Magjistraturës,  
Eksperte në fushën  
e të drejtës familjare  
dhe të fëmijëve.

## Prindërit Biologjikë

### Aty ku ligji mbështetet në shkencë... Sfidat e testit të ADN-së

**C** është në fokus  
E vërteta biologjike lidhur me prindërit, afatet ligjore dhe mbrojtja e veçantë e interesit të fëmijës; e drejta e fëmijës së birësuar për të njohur prindërit biologjikë; e drejta për të njohur prindin e vdekur. Rastet ekstreme: kimerizmi - kur ADN-ja e nënës biologjike nuk përputhet me atë të fëmijëve të saj; “Prindi” i fëmijës sipas kuptimit të nenit 7 të KDF-së; Shqipëria ka ratifikuar pa rezerva Konventën e OKB-së “Për të drejtat e fëmijës” (KDF). Në të, një vend të veçantë zëfamilja dhe jeta familjare si thelbësore sa bazike për mirëqenien dhe mirërritjen e fëmijës. Kuptimi i gjerë që i jepet familjes reflekton shumëllojshmërinë e lidhjeve që krijohen në të. Rëndësia e familjes nënvizohet qysh në preambulën e KDF-së “si njësi bazë e shoqërisë dhe mjedis natyror për rritjen dhe mirëqenien e të gjithë anëtarëve të saj dhe veçanërisht të fëmijëve dhe si e tillë duhet të ketë mbrojtjen dhe përkrahjen e nevojshme që të mund të marrë përsipër plotësisht rolin e saj në bashkësi”. Është e drejtë e fëmijës që të rritet në një mjedis familjar. Kjo e drejtë nuk duhet kuptuar si një privilegj për ta.

Dispozitat e Kodit të Familjes<sup>11</sup> të përqasura me KDF-në e nënvizojnë këtë të drejtë natyrore, duke e përcjellë përmes nenit 5: “Çdo fëmijë, për një zhvillim të plotë dhe harmonik të personalitetit, ka të drejtë të rritet në një mjedis familjar; në një atmosferë gëzimi, dashurie dhe mirëkuptimi”. Përmbajtja e këtij neni është marrëdhënësish nga preambula e KDF-së pa asnjë ndryshim.

Në lidhjet e krijuara në familje, lidhja prind-fëmijë mbetet ajo që ka më shumë rëndësi. Ajo është mësuesi, më e veçanta. Është një lidhje unike.

Për t’i dhënë kësaj lidhjeje vendin dhe rëndësinë e duhur, në nenin 7 paragrafi 1 i KDF-së parashikohet se: “Fëmija regjistrohet menjëherë sapo lind dhe qysh atëherë ka të drejtën ..., **brenda mundësive, ... për të njohur prindërit...**”. Kujdesi i bërë nga KDF-japër të mbajtur dhe kultivuar lidhjen prind-fëmijë nuk përfundon me këtë nen. Ka shumë të tjerë që parashikojnë garantimin e marrëdhënieve prind-fëmijë në situata të ndryshme duke vendosur detyrime konkrete për shtetet<sup>12</sup>.

Po cili është prindi për të cilin bën fjalë neni 7 i KDF-së? A duhet parë ky nen i lidhur menjë kontekst kohor të caktuar? I referohet ky nen prindërve biologjikë apo prindit që ligjërisht njihet si i tillë? A është nënë biologjike ajo që e ka lindur fëmijën apo nëna që ka dhuruar gametat? Çfarë vështirësish hasen lidhur me vërtetimin e atësisë? Cili është roli i provës së ADN-së? Si mundet që shkenca dhe zhvillimet e saj të vijnë në ndihmë në fushën e të drejtës familjare dhe garantimit të të drejtave të fëmijëve?

Për këtë kompleksitet të kuptimit të prindit biologjik do të parashikojmë vijim disa trajtesa që mund të jenë me rëndësi si ndërthurje mes së drejtës së fëmijës për të njohur prindërit, kuadrin ligjor në fuqi në Republikën e Shqipërisë dhe parimeve etike e morale që gjenden në të kundërt zhvillimeve të shkencës në drejtim të “zbulimit” të identitetit të prindit/ve biologjikë. Analiza nuk është aspak shteruese. Qëllimi është që të nisë një debat shkencor në kuadrin e një reviste me natyrë të tillë.

#### 1. “Prindi” i fëmijës sipas kuptimit të nenit 7 të KDF-së

Neni 7 i KDF-së, paragrafi 1, flet për disa të drejta të fëmijës dhe i shikon këto të lidhura me njëra-tjetrën, të ndërruar dhe njëherazi të rëndësishme për t’u

<sup>11</sup> Kodi i Familjes miratuar me ligjin nr. 9062, datë 08.05.2003, i ndryshuar.  
<sup>12</sup> Për shembull neni 9 i KDF-së parashikon që “fëmija të mos ndahet nga prindërit kundër dëshirës së tij, përveç rastit kur kjo ndarje është e domosdoshme, në interesin më të lartë të fëmijës”; neni 10 i KDF-së etj.

garantuar për nga konteksti kohor “menjëherësapo fëmija lind”. Të drejtat sipas këtij neni janë: e drejta e fëmijës për t’u regjistruar menjëherë sapo lind; e drejta të ketë një emër menjëherë sapo lind; e drejta për të fituar një shtetësi menjëherë sapo lind; e drejta e fëmijës që sipas *mundësive* të njohë prindërit e tij dhe për të pasur kujdesin e tyre<sup>13</sup>.

Përpara se të kuptojmë se çfarë kuptimi ka e drejta e fëmijëve që “*brenda mundësive*” “*të njohin prindërit*”, siç parashikon paragrafi 1 i nenit 7 të KDF-së, do të ndalemi në kuptimin e “prindit/ve”. Një analizë mbi kuptimin ekëtij neni dhe të gjithë përmbajtjes së KDF-së e gjejmë në botimin “*Implementation Handbook for the Convention on the Rights of the Child*”. Këtu me të drejtë thuhet se ndërsa disa dekada më parë përkufizimi i prindit ka qenë më i drejtpërdrejtë, ky nuk rezulton po kaq në ditët e sotme<sup>14</sup>.

Nisur nga rëndësia dhe vështirësitë në zbatim të nenit 7 të KDF-së, shtete të ndryshme që e kanë ratifikuar Konventën kanë paraqitur rezervat e tyre kundrejt kuptimit dhe shtrirjes së efekteve të përmbajtjes së tij. Kështu për shembull, Mbretëria e Bashkuar në instrumentin e ratifikimit ka shprehur rezervën se referimi në Konventë për sa i përket kuptimit të “prindit” shtrihet vetëm mbi ata persona që trajtohen si të tillë nga ligji kombëtar. Kjo përfshin edhe rastet kur, sipas ligjit, fëmija i përket një prindi të vetëm, për shembull, kur një fëmijë është birësuar nga një personi i vetëm dhe rasteve kur fëmija është i konceptuar nga nëna që e lindi dhe ajo trajtohet si prindi i vetëm<sup>15</sup>. Sa më sipër nuk rezulton të ketë

<sup>13</sup> Neni 7, paragrafi 1 i KDF-së: “Fëmija regjistrohet menjëherë sapo lind dhe qysh atëherë ka të drejtën të ketë një emër, të drejtën për të fituar një shtetësi dhe, brenda mundësive, të drejtën për të njohur prindërit e tij dhe për të pasur kujdesin e tyre”. Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (1966) në nenin 24/2 nënvizon se: “Çdo fëmijë regjistrohet menjëherë pas lindjes dhe duhet të ketë një emër” dhe në paragrafin e tretë të po këtij neni parashikohet e drejta e fëmijës për të fituar shtetësi.

<sup>14</sup> *Implementation Handbook for the Convention on the Rights of the Child* Fully revised edition prepared for UNICEF by Rachel Hodgkin and Peter Neëll. © United Nations Children’s Fund 2002, f. 116.

<sup>15</sup> Kështu për shembull, Luksemburgu pranon se neni 7 i Konventës nuk paraqet pengesë për proceset ligjore që kanë të bëjnë me lindjet anonime, çka konsiderohet se është në interes të fëmijës, siç parashikohet në nenin 3 të Konventës. Në lidhje me nenin 7 të Konventës, Polonia ka përcaktuar se e drejta e një fëmije të birësuar për të njohur prindërit e tij natyrorë do t’i nënshtrohet kufizimeve të vendosura nga rregullat detyruese të cilat u mundësojnë prindërve birësues të ruajnë fshehtësinë e origjinës së fëmijës. Republika Çeke interpreton dispozitën e nenit 7, paragrafi 1 të Konventës në këtë mënyrë: “Në rastet e birësimeve të parevokueshme, të cilat bazohen në parimin e anonimitetit, dhe në rastet e fekondimit artificial, ku mjeku i ngarkuar është e nevojshme të sigurojë që burri dhe gruaja, nga njëra anë, dhe donatori, nga ana tjetër të mbeten të panjohur për njëri-tjetrin, komunikimi i emrit të prindit natyror ose emrit të prindërve natyrorë të fëmija nuk është në kundërshtim me këtë dispozitë.” Për më shumë lidhur me rezervat e shteteve në lidhje me nenin 7 shih: Reservations, declarations and objections relating to the Convention of the Rights of the Child në <http://ëëë.refworld.org/pdfid/3ae6ada4.pdf>

rezerva sa i përket Shqipërisë lidhur me këtë nen dhe njëherazi edhe për nenet e tjera të KDF-së. Ndaj kuptimi i “prindit” do të merret në përputhje me kuptimin që vetë Konventa ka dhënë pa injoruar legjislacionin e brendshëm.

E drejta e fëmijës për të njohur prindërit e vet, është mëse e arsyeshme që sipas Konventës, së pari, lidhet me prindërit gjenetikë/biologjikë të fëmijës. Ndër arsyet e tjera, me shumë rëndësi, si për prindin biologjik ashtu edhe për fëmijën, janë ato që lidhen me historinë shëndetësore të familjes. Por, njohja e atit biologjik për shembull, përtej aspekteve financiare dhe emocionale me rëndësi në jetën e fëmijës, ka rëndësi edhe për imazhin social të nënës së fëmijës dhe tërësinë e të drejtave dhe detyrimeve që kundrejt fëmijës janë të ndërthurura mes nënës biologjike dhe babait biologjik të fëmijës në fjalë.

Cilët janë prindërit biologjikë? A është në çdo rast prind i fëmijës nëna që e ka lindur fëmijën dhe babai qëka pasur marrëdhënie me nënën në momentin e konceptimit/ngjizjes?

Amësia dhe atësia e fëmijës, si institute të së drejtës familjare, kanë si qëllim të vërtetën biologjike dhe e synojnë këtësi një të drejtë të fëmijës dhe të prindit. Për të “zbuluar” këtë, instituti i amësisë dhe atësisë përfshijnë një sërë rregullash duke u bazuar në faktin nëse fëmija ka lindur nga prindër të martuar, nga prindër jo të martuar ose nga prindër anonimë, të panjohur. Për çdo situatë, normat nevojitet të jenë të tilla që në asnjë rast të mos shkohet në cenimin e parimit të interesit më të lartë të fëmijës<sup>16</sup> dhe të parimeve që kanë të bëjnë me mbrojtjen ndaj diskriminimit<sup>17</sup>.

Referuar institutit të atësisë, për të shkuar tek ati biologjik i fëmijës, legjislatori përdor rregulla të cilat mund t’i klasifikojmë në tri drejtime. *Së pari*, rregullat përmes së cilave disiplinohet instituti i prezumimit të atësisë, ku përfshihen rastet e atësisë së fëmijëve të lindur nga prindër të lidhur në martesë,<sup>18</sup> *së dyti*, rregullat që kanë të bëjnë me njohjen vullnetare të atit në rastin kur prindërit nuk

<sup>16</sup> Përkthimi zyrtar i KDF-së i referohet si “interesi më i lartë i fëmijës” shprehjes së përdorur nga konventa “best interest of the child”, që njihet si një parim me rëndësi në nenin 3 të saj dhe që citohet edhe në nene të tjera të KDF-së.

<sup>17</sup> Shih nenin 2 të KDF-së dhe nenin 4 të KF-së sipas të cilit: “Fëmijët e lindur jashtë martese kanë të njëjtat të drejta dhe detyra si fëmijët e lindur nga martesa”.

<sup>18</sup> Shih nenin 180 të KF-së dhe tri situatat eventuale të prezumimit të atësisë.

janë të lidhur me martesë dhe kjo kërkesë e atit pranohet nga nëna<sup>19</sup> dhe, *së treti*, rregullat përmes së cilave atësia kërkohet përmes njohjes gjyqësore. Të tria këto situata mund të kundërshtohen gjyqësisht.

Në rastin e institutit të amësisë duket se parimi romak sipas të cilit “*mater semper certa est*”<sup>20</sup>, pra “nëna është gjithnjë e sigurt” në ditët e sotme ka “pasiguritë” e sfidat e veta. Këto kanë nisur që në vitin 1978 kur u konceptua fëmija i parëpërmes teknikave të fekondimit *in vitro*<sup>21</sup>. Në këtë rast nëna gjenetike dhe nëna që e lindfëmijën janë dy persona të ndryshëm. Pra, termi “prind biologjik” rezultoi të ketë një kuptim më kompleks. Për shembull, në rastin e dhurimit të vezëve, “prindi” mund të jetë ose nëna që ka dhuruar vezët ose nëna që e ka lindur fëmijën. Si për t’i dhënë zgjidhje këtyre situatave neni 175 i KF-sëparashikon se: “*Amësia e fëmijës vërtetohet me aktin e lindjes*”. Kjo vlen si për fëmijët e lindur nga martesa ashtu edhe për fëmijët e lindur jashtë martese.

Në realitet ndodhin edhe pasiguri të tjera. Ndodh që nëna që e lind fëmijën nuk është ajo që regjistrohet si e tillë në aktin e lindjes. Për shembull, neni 168 i KF-së trajton rastet e ngatërrimit ose zëvendësimit të fëmijës, edhe kur kjo bëhet në mënyrë të pavullnetshme. Në këtë nen parashikohet mundësia që kjo situatë të zgjidhet gjyqësisht dhe të kërkohet sipas rastit me padi njohjeje ose kundërshtimi një identiteti i ndryshëm i fëmijës, duke u bazuar në atë nëse konstatimi është bërë përpara ose pas marrjes së aktit të lindjes. Praktika ka evidentuar edhe raste të tjera më ekstreme. Nëna biologjike që e lind fëmijën jep për identitet të saj in atë të një gruaje tjetër të martuar, e cila nuk lind fëmijë. Ky akt i saj synon ta mbrojë që të fshihet nga paragjykimet e diskriminimi ose frika e kërcënimit e bëra nga familjarët meqë po sjell në jetë një fëmijë jashtë martese, ati i të cilit ka qenë një person që ka pasur lidhje intime, i cili është larguar me ta marrë vesh

<sup>19</sup> Përkatësisht neni 181, 182 dhe 183 të KF-së.

<sup>20</sup> Praesumptio iuris et de iure, me këtë kuptojmë se nuk mund të ketë asnjë ligj dhe asnjë provë kundër këtij parimi.

<sup>21</sup> Kjo detyroi që në Kodin Civil gjerman u përfshi paragrafi 1571 mbi amësinë sipas të cilit “nëna e fëmijës është gruaja që e lind atë”. Shih rregullimet në fushën e shëndetit riprodhues sipas normave të ligjit nr. 8876, datë 04.04.2002 “Për shëndetin riprodhues”.

këtë<sup>22</sup>. Këto raste dhe shumë të tjera, mjaftojnë që të kuptojmë se “prindi biologjik”, qoftë nëna ose ati i fëmijës, jo nëçdo rast mund të njihen lehtësisht.

Jeta tregon se jo në çdo rast ka një përputhje simetrike, të plotë midis prindit/ve biologjik të fëmijës dhe prindit në kuptimin juridik. Pra, jo në çdo rast prindërit biologjikë janë ata që njej ligji si prindërit e fëmijës. Si shembull marrim institutin e birësimit. Përmes birësimit kjo mospërputhje mund të jetë për të dy prindërit ose për njërin prej tyre. Për shembull, nëse njëçift bashkëshortësh ka birësuar një fëmijë, ose një individ i vetëm<sup>23</sup> birëson një fëmijë, atëherë këta janë prindërit juridikë të fëmijës por jo natyrorë të tij. Mund të ndodhë që njëri bashkëshort birëson fëmijën që është fëmija natyror i tjetrit. Në këtë rast përputhja e prindit natyror dhe juridik qëndron vetëm për njërin prind dhe jo për tjetrin.

Në rastet e konflikteve të tilla për të shkuar tek e vërteta biologjike dhe njëherazi për të realizuar të drejtën e fëmijës për të njohur prindërit brenda mundësive, kërkohen prova shkencore.

## 2. E vërteta biologjike lidhur me prindërit, afatet ligjore dhe mbrojtja e veçantë e interesit të fëmijës

Në çdo epokë, në raportin mes kornizës ligjore dhe zhvillimit të shkencës janë bërë përpjekje për të gjetur një ekuilibër të artë. Në këtë analizë, në raportin mes tyre ajo që vlen dhe mbizotëron janë liritë dhe të drejtat themelore të njeriut, të drejtat e fëmijëve si konsiderata parësore.

GjEDNj-së në një sërë vendimesh i është dashur të mbajë qëndrim lidhur me peshën që ka e vërteta biologjike dhe për rrjedhojë vendin që kanë provat shkencore si të tilla që të çojnë te kjo e vërtetë, siç janë ato që vijnë nga laboratorët biologjikë,

<sup>22</sup> Vendimi nr. 2301/21.11.2012 i GjRrGj-së Fier është prova se si mentaliteti, diskriminimi dhe poshtërimi që i bëhet gruas si nënë çon deri në manipulime të tilla që sjellin mohimin e së drejtës së gruas që e lind fëmijën, ta regjistrojë atë si të vetin dhe duke e detyruar këtë që të japë një emër nënë e ati të rremë. Shih, Arta Mandro (Ballili), *Maternity and paternity of the child in the new challenges of gender – discrimination*. Botuar në “In margine al Sinodo 2014. Riflessioni in punto di diritto su matrimonio e famiglia”. © 2014 Cacucci Editore, Bari, f. 79-86.

<sup>23</sup> Shih vendimi nr. 8704/03.12.2007 të GjRrGj-së Tiranë, fëmija birësohet vetëm nga bashkëshorti dhe për këtë jep pëlqimin edhe bashkëshortja e tij; vendimi nr. 288/24.01.2007 të GjRrGj-së Tiranë kërkuesja është shtetase e huaj dhe ajo e ka birësuar fëmijën e vetme.



kundrejt afateve proceduralekufizuese në lidhje me përcaktimin ligjor të amësisë dhe atësisë së fëmijës<sup>24</sup>. Është veçori e institutit të amësisë dhe atësisë caktimi i afateveprocedurale brenda të cilave duhet shkuar tek e vërteta biologjike. Kjo realizohet përmes padisë së njohjes ose kundërshtimit. Këto kufizime të kërkimit të së vërtetës biologjike, përfshi afatet ligjore të parashkrimit të së drejtës së padisë, kanë rëndësi në lidhje me rëndësinë parësore që ka siguria juridike dhëkrijimi i stabilitetit në lidhjet familjare. Këto nuk duhet të kuptohen si injorim i rolit të shkencës<sup>25</sup>. Kështu, mund të disiplinohet që “përpyjekjet për këtë të vërtetë nga ana e prindërve” të bëhen brenda një kohe optimale që legjislatori e ka vendosur nisur nga interesi më i lartë i fëmijës dhe të drejtës së tij për t’u rritur në një mjedis familjar pa injoruar mundësinë e prindërve për të kërkuar të vërtetën biologjike.

Duke i dhënë rëndësi stabilitetit e sigurisë së marrëdhënieve juridike që burojnë nga institutet e amësisë dhe atësisë dhe parimit të interesit më të lartë të fëmijës, vihet re se ka një limit kohor brenda të cilit këto përpjekje mund të bëhen. P.sh., nëna e fëmijës *qoftë edhe e mitur* (neni 183 i KF-së) ka të drejtë të paraqesë një padi njohjeje atësie përpara gjykatës kompetente, kur kjo njohje nuk është bërë vullnetarisht, e cilaparashkruhet me kalimin e 3 vjetëve nga lindja e fëmijës. Po kështu, sipas Kodit të Familjes, e drejta e padisë së burrit të prezumuar si ati i fëmijës, *parashkruhet me kalimin e një viti*, nga data që burri ka marrë *dijenipër* lindjen e fëmijës. Në asnjë rast e drejta nuk parashkruhet për fëmijën madhor. Pra, ka gjithnjë kohë për shkencën dhe provat shkencore, por këto janë vendosur në një kontekst të tillëqë të mos cenohet interesi i fëmijës<sup>26</sup>.

Nëse veprohet në kohë, të provuarit e amësisë dhe atësisë së fëmijës është pjesë e punës së ekspertit gjenetist.

Në dispozitat e Kodit të Procedurë Civile (KPC)

<sup>24</sup> Shih Arta Mandro (Balili), “Përcaktimi i atësisë së fëmijës në fokusin e jurisprudencës së GjEDNj-së dhe të legjislationit e praktikës gjyqësore vendase”, revista “Jeta Juridike”, botim i Shkollës së Magjistraturës, Tiranë, nr. 4, dhjetor 2012

<sup>25</sup> Solenn Briand, Claire Delarbre, Anne-Cecile Krygiel, ‘Filiation, genetics and the judge. Conciliation of family stability and the right of biological truth’. Themis competition 2016. [http://www.ejtn.eu/PageFiles/14775/Written%20paper\\_France.pdf](http://www.ejtn.eu/PageFiles/14775/Written%20paper_France.pdf)

<sup>26</sup> GjEDNj çështja Mikulić kundër Kroacisë aplikimi nr. 53176/99, ECHR 2002-I. Është një prej rasteve ku autoritetet nuk kishin marrë masat adekuate për të siguruar të drejtat e aplikuesit për të njohur atësinë mbi fëmijën dhe ku GjEDNj-ja konkludoi se ishte shkelur neni 8 i KEDNj-së.

karregullim të veçantë mbi rolin e “shkencëtarit/ ekspertit”. Në nenin 224/a të KPC-së parashikohet se “Kur për konstatimin ose sqarimin e fakteve, që kanë lidhje me mosmarrëveshjen në gjykim kërkohen njohuri të posaçme në fushat e shkencës, ..., gjykata mund të thërrasë një ose më shumë ekspertë”. Në nenin 158/a, pika 2, germa “b” parashikohet se ndër vendimet e gjyqtarit gjatë veprimeve paraprake pa caktuar seancë përgatitore<sup>27</sup>, është caktimi i provave që do të merren në shqyrtim në seancë gjyqësore dhe caktimi i ekspertit në fushën përkatëse të ekspertizës, të cilin ua njofton palëve; në nenin 158/b të KPC-së trajtohet seanca përgatitore<sup>28</sup>, në të cilin parashikohet se gjyqtari cakton detyrimisht seancën e veprimeve përgatitore në rastet kur merr në shqyrtim ndër të tjera edhe caktimin e ekspertit; në nenin 158/c të KPC-së nënvizohet se urdhri për caktimin e seancës gjyqësore<sup>29</sup>, i cili përmban ndër të tjera ekspertin ose grupin e ekspertëve të caktuar nga gjyqtari. Sipas nenit 224/b eksperti e jep mendimin e tij me shkrim, por mund të dëgjohet në seancë gjyqësore dhe të pyetet nga gjykata dhe nga palët. Ndër risitë e KPC-së pas ndryshimeve të bëra në vitin 2017, është neni 224/d që ka të bëjë me regjistrin elektronik të ekspertëve (shtuar me ligjin nr. 38/2017, datë 30.03.2017) që krijohet prej Ministrisë së Drejtësisë dhe të drejtën e gjyqtarit të caktojë një ekspert jashtë regjistrit elektronik, vetëm kur, për nevoja të procesit, eksperti nevojitet nga fusha të veçanta ekspertize, për të cilat ligji nuk parashikon licencimin e tyre. Rregullime më të detajuara mbi rolin e ekspertit parashikohen nëkreun VI me titull “*Eksperti dhe ekspertimi*” përkatësisht nenet 225-230 të KPC-së.

**A është mendimi i ekspertit i detyrueshëm për gjykatën?** Sipas KPC-së parashikohet se mendimi nuk është i detyrueshëm dhe, kur gjykata ka mendim të kundërt me ekspertin, duhet të arsyetojë me hollësi këtë mendim në vendimin përfundimtar ose në një vendim që jep gjatë gjykimit. Nuk është në misionin e ekspertit të japë një mendim juridik. Ashtu sikurse gjyqtari nuk është aty që të japë një mendim shkencor por të japë drejtësi, të njëjtën mund të themi për

<sup>27</sup>Kodi i Procedurës Civile, ndryshuar me ligjet nr. 8812, datë 17.05.2001; nr. 10 052, datë 29.12.2008; nr. 122/2013, datë 18.04.2013 dhe nr. 38/2017, datë 30.03.2017.

<sup>28</sup>Kodi i Procedurës Civile, ky nen është shtuar me ligjin nr. 8812, datë 17.05.2001 dhe ndryshuar me ligjin nr. 38/2017, datë 30.03.2017.

<sup>29</sup>Ky nen i KPC-së është shtuar me ligjin nr. 38/2017, datë 30.03.2017.

ekspertin i cili nuk e ka në misionin e vet të japë një mendim juridik, por thjesht shkencor. Secili më vete dhe të dy sëbashku realizojnë dhënien e drejtësisë si të tërë<sup>30</sup>. Por si qendron çështja në rastin e provës së ADN?

Neni 229 i KPC-së parashikon mundësinë e përsëritjes së ekspertimit në rastet kur shihet se ekspertimi është i metë ose i paqartë, si dhe kur ka ndryshim mendimesh midis ekspertëve. Në këtë rast gjykata, kryesisht ose me kërkesën e ndonjërës prej palëve, mund të kërkojë sqarime plotësuese ose të urdhërojë kryerjen e një ekspertimi të ri, duke thirrur ekspertë të tjerë. Kështu, në çështjen *Kalacheva kundër Ruisisë*<sup>31</sup>, GjEDNJ-janëvizon se në ditët e sotme, testi i ADN-së është e vetmja metodë shkencore në përcaktimin siç duhet të atësisë së fëmijës. Vlera e këtij testi qëndron mbi vlerën e provave të tjera të paraqitura nga palët për të provuar apo kundërshtuar faktin e një marrëdhënieje intime. Në këtë çështje, gjykata vendase urdhëroi bërjen e testit të ADN-së në një institucion publik të specializuar. Rezultati ishte që zoti A ishte ati i fëmijës në 99.9% . Por, i padituri bëri ankim dhe nuk e pranoi rezultatin e testit, duke hedhur dyshime lidhur me shënimet në zarf dhe mostrat e marra të gjakut. Gjykatat vendase e quajti testin të papranueshëm dhe hodhi poshtë pretendimet e aplikueses pa urdhëruar një test të ri. Sipas GjEDNJ-së, përcaktimi i atësisë së vajzës së aplikueses është një çështje që ka të bëjë me jetën private të aplikueses, e cila ka përgjegjësi të plotë për jetën e fëmijës së saj të mitur. Duket se autoritetet vendase, në këtë rast hasën në një konflikt apo konkurrencë të themi midis interesave të nënës së fëmijës së lindur jashtë martese nga njëra anë me ato të atit të supozuar prej saj. Nuk është detyrë e GjEDNJ-së të zëvendësojë autoritetet e një shteti për të përcaktuar mënyrën më të mirë për njohjen e atësisë, por është e rëndësishme që nga ana e saj të analizohet nëse autoritetet e vendit kanë zbatuar kërkesat dhe qëllimin e nenit 8 të KEDNJ-së. Gjykata mbajti shënim mbi gjetjet e gjykatës vendase dhe të argumenteve të qeverisë se aplikuesja kishte dështuar se nuk kishte siguruar prova të mjaftueshme mbi marrëdhëniet e saj me A-në dhe atësinë e fëmijës.

Gjykata konstatoi se gjatë procedimit, gjykata vendase urdhëroi testin e ADN-së dhe ky test tregoi një probabilitet 99.99% në favor të pretendimeve të aplikueses se A ishte ati i fëmijës. Sipas nenit 8 të KEDNJ-së në çështjet e atësisë së fëmijës, gjykatat duhet të mbajnë në vëmendje interesin më të lartë të fëmijës. Në rastin konkret, interesi më i lartë i fëmijës kërkonte një përgjigje të qartë nëse A-ja ishte ose jo babai i saj. Duket se kjo përgjigje nuk mund të trajtohej siç duhej pa një test të ADN-së. Bërja e një testi të dytë ishte i nevojshëm përderisa testi i parë ishte i papranueshëm për arsye formale personale. Edhe pse aplikuesja nuk e kërkoi një gjë të tillë, ishte në diskrecion të gjykatës vendase të urdhëronte një ekspertim të ri meqenëse eksperti dhe ekspertimi i kryer prej tij u vlerësuan të dyshimtë. Kjo provë është me rëndësi të veçantë në këtë rast aq më tepër që shkelja e rregullit erdhi si pasojë e byrosë së ekzaminimeve të mjekësisë ligjore që ishte institucion shtetëror. Kështu gjykata vendase, ndërsa deklaroi të papranueshme testin e ADN-së, duke mos urdhëruar ribërjen e tij, shkeli edhe dispozitat e Kodit të Procedurës vendase ashtu edhe parimet e nenit 8 të KEDNJ-së. Duke konkluduar, GjEDNJ-ja konsideroi se autoritetet vendase në trajtimin e këtij rasti nuk realizuan detyrimet pozitive të shtetit për të mbajtur një balancë të drejtë midis interesave të palëve në procedim dhe interesit më të lartë të fëmijës duke shkelur kështu nenin 8 të Konventës.

***A është analiza e ADN-së e detyrueshme?*** Asnjë nuk mund të detyrohet për testin e ADN-së me qëllim që të vendoset atësia/amësia në rrugë gjyqësore. Ky është qëndrimi i legjislacionit shqiptar në të cilin nuk ka një dispozitë urdhëruese. Në këtë mënyrë, vendi ynë renditet në sistemet që mbajnë një pozicion të baraspeshuar midis të drejtës nga njëra anë për të refuzuar bërjen e testit të ADN-së dhe nga ana tjetër të së drejtës së gjykatës, e cila e jep vendimin e vet duke e mbajtur në konsideratë këtë dhe mbështetur vendimmarrjen në prova të tjera.

Këtë qëndrim mban edhe GjEDNJ-ja. Por, si mund të vlerësohet dhe garantohet interesi i individit që kërkon njohjen e atësisë/amësisë, por has në një pengesë të tillë? Sipas çmuarjes së GjEDNJ-së kjo e drejtë dhe ky interes duhet të garantohet në një

<sup>30</sup>Ligji nr. 8116/29.03.1996 Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

<sup>31</sup>Shih GjEDNJ:Kalacheva kundër Ruisisë, 7 maj 2009 (3451/05).

mënyrë tjetër<sup>32</sup>. Një nga konkluzionet që nxirret nga GjEDNj-ja në rasti *Mikulić kundër Kroacisë* dhe që duhet të mbahet në vëmendje nga autoritetet gjyqësore shqiptare në rastet lidhur me atësinë është vlerësimi [ose mbivlerësimi] i provës së ADN-së dhe kundrejt interesit të individit që realizohet vetëm përmes njohjes gjyqësive të atësisë. E ndërsa në këtë kontekst, gjykata kroate, është e lirë, të mbërrijë në konkluzione duke marrë në konsideratë faktin se pala në proces ka penguar marrjen e disa fakteve/provave siç është ADN-ja, por kjo nuk mund të vendosë barriera të pakapërcyeshme për interesin mbizotërues<sup>33</sup>.

Në bazë të nenit 224 e vijues të KPC-së gjykata, në raste të tilla, vendos thirrjen e një eksperti gjenetist. Mendimi i ekspertit është provë vendimtare në proces. Në mungesë të saj [kur një individ nuk pranon] duhet të trajtohen në harmoni të gjitha provat e tjera. Sipas nenit 189 të KF-së lidhur me atësinë e fëmijës së lindur jashtë martesë, është e rëndësishme që gjatë gjykimit të provohet se në kohën e zënies së fëmijës i ati bashkëjetonte me nënën e fëmijës, ose ka kryer marrëdhënie seksuale me apo pa dhunë, ose i ka premtuar martesë, ose nga një gjykim penal apo civil rezulton në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi atësia e fëmijës së lindur jashtë martesë, si dhe kur dihet publikisht se ai e ka njohur fëmijën si të tijin.

### 3. E drejta e fëmijës së birësuar për të njohur prindërit biologjikë

A ka të drejtë fëmija i birësuar të dijë origjinën e vet<sup>34</sup>? Sipas KF-së mes të miturit, prindërve biologjikë dhe birësuesit qëndrojnë dhe respektohen dy kategori rregullash. Së pari, janë rregullat e mirëbesimit për procesin dhe dokumentacionin e birësimit, si shprehje të respektimit të jetës private<sup>35</sup>

<sup>32</sup> Analiza e ADN-së mundëson përcaktimin e prindërve gjenetikë të fëmijës dhe është bërë prioritare në vend të metodave të mëparshme, të cilat mbështeteshin kryesisht në analizat e grupeve të gjakut. Kjo analizë ka një probabilitet prej 99.99% nëse është bërë mbi bazën e krahasimit të ADN-së së nënës, fëmijës me ato të të atit.

<sup>33</sup> Shih gjithashtu GjEDNj Jäggi kundër Zvicrës, 13 korrik 2006 (58757/00).

<sup>34</sup> Eugena Bisha në punimin e doktoraturës "Birësimi i të miturve nën dritën e zhvillimeve në Shqipëri dhe në Evropë" trajton çështje që lidhen me sekretin e origjinës, të drejtën për konfidencialitetin dhe privatësinë përballë të drejtës për të njohur origjinën. Punimi gjendet në: [http://ëëë.uet.edu.al/images/doktoratura/Eugena\\_BISHA.PDF](http://ëëë.uet.edu.al/images/doktoratura/Eugena_BISHA.PDF). Shih f. 181-184.

<sup>35</sup> Neni 262, paragrafi i parë i KF-së: "I mituri, prindërit biologjikë dhe birësuesit kanë të drejtën e mirëbesimit për procesin dhe dokumentacionin e birësimit, si shprehje të respektimit të jetës private".

dhe, së dyti, ato që kanë të bëjnë me të drejtën e fëmijës që, *nëse është e mundur*, të njihen me të dhënat për prindërit biologjikë. Në rastin e dytë, mundet që e drejta e privatësisë të ketë pozitë më të favorshëm dhe duhet të gjendet një ekuilibër mes të drejtës së fëmijës për të njohur origjinën e vet dhe të drejtës së prindit biologjik për të mbetur anonim<sup>36</sup>. Konventa e re e Këshillit të Evropës<sup>37</sup> gjen një ekuilibër më të mirë midis të drejtës së fëmijëve të birësuar për të njohur identitetin e tyre dhe të drejtën e prindërve biologjikë për të mbetur anonim.

Paragrafi i dytë i nenit 262 të KF-së nënvizon se: "*Kurmoshadhe niveli i pjekurisë e lejojnë, i mituri ka të drejtë të njihet me historinë e tij dhe, nëse është e mundur, me të dhënat për prindërit biologjikë*". Siç vihet re, e drejta e fëmijës për të njohur origjinën e vet sipas KF-së nuk është një e drejtë absolute. E para, kjo është e kushtëzuar me moshën dhe nivelin e pjekurisë së fëmijës. Nga ana tjetër, shprehja e përdorur "*nëse është e mundur*" do të thotë që, sipas rastit, mund të ndodhemi në pamundësi faktike ose/dhe në pamundësi juridike.

### 4. E drejta për të njohur prindin e vdekur

Këto janëçështje qëpleksin një proces të provuari delikat sepse flasim për përcaktimin e atësisë/amësisë kur nëna dhe/ose ati i fëmijës kanë vdekur dhe në ndonjë rast mund të jemi edhe përpara pretendimeve që mund të konsiderohen si cenim i kujtimit të një të vdekuri. Në këtë rast, sipas nenit 625 të Kodit Civil, bashkëshorti i personit të vdekur ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë mund të kërkojnë shpërblimin e dëmit jopasuror. Në këto çështje drejta e fëmijës për të njohur prindërit e tij has nëvështirësitëe procesit të provuarit dhe në konfliktet eventuale që krijohen për shkak të respektimit të të vdekurit dhe përfshirjes

<sup>36</sup> Shih Odièvre kundër Francës, Aktgjykimi i 13 shkurtit 2003 i Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut. Në këtë çështje, aplikantja ishte braktisur nga nëna që në lindje dhe ishte birësuar. Vetë nëna kishte kërkuar që identiteti i saj të qëndronte sekret. Për këtë arsye aplikantes ju refuzua kërkesa për të njohur identitetin e prindërve. GjEDNj vendosi se nuk ka pasur shkelje të nenit 14 në lidhje me nenin 8 të Konventës, pasi aplikantës i ishte dhënë akses për informacion jo-identifikues në lidhje me familjen e saj biologjike, duke i lejuar të gjente paksa rrënjët e saj, ndërsa sigurohej mbrojtja e interesit të palëve të treta. Shih gjithashtu çështjen Godelli kundër Italisë, 33783/09, datë 18.03.2013 ku GjEDNj ka gjetur shkelje të nenit 8 të KEDNj-së.

<sup>37</sup> Konventa Evropiane mbi birësimin e fëmijëve [e rishikuar e vitit 2008] CETC 202 ka zëvendësuar Konventën Evropiane mbi birësimin e fëmijëve të vitit 1967 (ETS nr. 58) dispozitat e të cilës u konsideruan të vjetëruara dhe në kundërshtim me praktikën gjyqësore të GjEDNj-së. Shqipëria nuk ka ratifikuar asnjë prej tyre.

sëinteresave të trashëgimtarëve të tij/saj. Hulumentimi i këtyre rasteve për të parë qëndrimin e gjykatave shqiptare është njëçështje që mund të realizohet në një punim tjetër me këtë natyrë.

Për më tepër po ndalemi në qëndrimin e GjEDNj-së në disa nga rastet që lidhen me vërtetimin e atësisë pas vdekjes. Një e tillë është çështja *Jäggi kundër Zvicrës*<sup>38</sup>. Aplikanti pretendoi se nuk kishte pasur mundësi të realizonte testin e ADN-së te një person që kishte vdekur dhe të provonte nëse ky ishte ati biologjik, çka përbënte sipas tij shkelje të nenit 8 të KEDNj-së. GjEDNj vuri re se autoritetet zvicerane në rastin në fjalë e kishin refuzuar bërjen e testit të ADN-së. Sipas paragrafit 39 të vendimit, GjEDNj nënvizon rëndësinë që ka marrja në konsideratë nga njëra anë e të drejtës së aplikantit për të njohur prindin biologjik dhe të drejtësë palës së tretë që të mos cenohet trupi i të vdekurit, pra e drejta që të respektohet i vdekuri dhe nga ana tjetër interesi publik që lidhet me sigurinë juridike. Në paragrafin 41 të vendimit shënohet se: “*Gjykata Federale vërejt se familja e të ndjerit nuk kishte cituar ndonjë arsye fetare ose filozofike për të kundërshtuar marrjen e një mostre të ADN-së. Duhet gjithashtu të theksohet se ishte falë aplikantit që qiraja e varrit të të ndjerit ishte rinovuar në vitin 1997. Përndryshe, paqja e gëzuar nga i vdekuri dhe paprekshmëria e mbetjeve të tij mortore do të ishin shqetësuar që në atë kohë. Në çdo rast, trupi i të ndjerit do të zhvarroset, sepse qiramarrja skadon në 2016-ën. E drejta për të pushuar në paqe gëzon, pra, vetëm mbrojtje të përkohshme.*” Në paragrafin 44 të GjEDNj-së nënvizon se: “*Duke marrë parasysh rrethanat e rastit dhe interesin kryesor në rrezik për aplikantin, autoritetet zvicerane nuk i siguruan atij respektin për jetën e tij private. Prandaj, ka pasur një shkelje të nenit 8 të Konventës.*”

GjEDNj-ja ka mbajtur të njëjtin qëndrim edhe nëçështjen *Pascaud kundër Francës*<sup>39</sup>. Në këtë rast që lidhet me një hetim pas vdekjes lidhur me atësinë, babai i pretenduar kishte treguar dëshirën për të krijuar lidhje, por rezultatet pozitive të testit të ADN-së nuk u morën parasysh nga Gjykata e Apelit për shkak të një ndryshimi në aftësitë e tij

<sup>38</sup>GjEDNj: Jäggi kundër Zvicrës, 13 korrik 2006, aplikimi nr. 58757/00.

<sup>39</sup>GjEDNj: Pascaud kundër Francës, aktgjykimi nr.19535/08

mendore kur ai pranoi të testohej. Ndërsa babai i supozuar vdiq gjatë procedurës, kërkuesi nuk kishte mundësi të kërkonte ekzaminimin e mëtejshëm gjenetik të kufomës për të provuar atësinë.

## 5. Rastet ekstreme: kimerizmi - kur ADN-ja e nënës biologjike nuk përputhet me atë të fëmijëve të saj

Praktika ndërkombëtare njih pak raste të tilla. Këto e bëjnë edhe më të vështirë njohjen e prindit biologjik. Kimerizmi është një gjendje e rrallë. Janëvetëm 30 raste të dokumentuara në mbarë botën. Në mitologjinë greke, “*chimera*” do të thotë një përbindësh: njëpjesë dhie, njëpjesë luani, njëpjesë gjarpri. Në biologjinë njerëzore, kimera është një organizëm me të paktën dy lloje qelizash gjenetike të dallueshme – pra, duket sikur qëllimi ka qenë të ishte një binjak tjetër. Por, ka ndodhur që në barkun e nënës, dy vezët e fekunduara shkrihen, duke u bërë një fetus që përmban dy kode gjenetike të dallueshme. Binjaku është i padukshëm, por për kimera binjaku jeton mikroskopikisht brenda trupit si ADN.

Një prej rasteve të bujshme lidhet me *Lydia Fairchild*. Asaj iu deshë shumëpërpjekje për të provuar se tri fëmijët e lindur prej saj ishin fëmijët e saj biologjikë. Prova e ADN-së ngriti pikëpyetje të mëdha pasuar nga akuza të rënda penale. Lydia Fairchild kishte dy fëmijë dhe ishte në pritje të fëmijës së tretë, ndërkohë që lidhja e saj me bashkëjetuesin u ndërpre. Në vitin 2002 ajo kërkoi detyrimin për ushqim nga bashkëjetuesi për fëmijët e saj dhe hyri në një procedurë rutinë të testit të ADN-së që të provonte lidhjet familjare dhe detyrimet që burojnë prej tyre. Rezultoi nga testi i ADN-sëse ndërsa bashkëjetuesi ishte babai i fëmijëve kjo nuk ndodhi për aplikanten. Ajo nuk ishte nëna e fëmijëve të saj. Të dhënat e lindjeve të saj të mëparshme u vunë në dyshim. Ajo u akuzua për mashtrim dhe përdorim të fëmijëve të të tjerëve për përfitim. Prokurori urdhëroi që asaj t’i hiqej përgjegjësia prindërore për dy fëmijët. Ndërkohë po afronte koha e lindjes së fëmijës së tretë. Gjykata urdhëroi që një vëzhgues të ishte i pranishëm në lindje me qëllim që të siguronte që kampionët e gjakut të merreshin menjëherë nga fëmija dhe nëna.



Dy javë më vonë nga lindja e fëmijës së tretë, testet e ADN-së tregojnë se ajo përsëri nuk ishte nëna e fëmijës së tretë të sapolindur.

Përpara rastit të Lydia Fairchild, një tjetër grua, **Karen Keegan** nga Bostoni i SHBA-ve kishte nevojë për një transplant të veshkave. Ajo ishte nëna e dy fëmijëve madhorë. Anëtarët e familjes së saj kishin testuar gjakun e tyre për pajtueshmërinë. Rezultoi se fëmijët e saj nuk përputheshin me ADN-në e saj. Mjekët e Bostonit i kërkuan Keegan-it të tregonte se ku kishin lindur dy djemtë e saj, meqenëse kodi i tyre gjenetik nuk ishte i njëjtë me të saj. Dy djemtë e saj nuk kishin trashëguar asnjë gjë nga ADN-ja e nënës së tyre. U ngritën dyshime për spitalin. Mjekët morën kampione të ADN-së nga gjithë trupi i Keegan-it. Ata testuan gjakun e saj, flokët e saj ... . Asgjë nuk përputhej me ADN-në e bijve të saj. Keegan kujtoi se ajo kishte hequr një nodul të tiroides kohë prapa. Pas një kërkimi të gjerë, mjekët gjetën një mostër të indit të tiroides të ruajtur në një laborator. Sipas mjekëve, kjo pjesë e indeve ishte çelësi për zgjidhjen e misterit mjekësor. ADN-ja që përputhet me ADN-në e bijve mund të ketë qenë kudo në trupin e Keegan-it. Por, tetiroidi i saj u gjet përputhja me kodin gjenetik të bijve të saj. Në gjakun e saj ajo ishte një person, por në indet e tjera, ajo kishte prova se ishte një bashkim i dy individëve.

Ky zbulim i bërë më parë ndihmoi edhe Lydia Fairchild-in për të mbajtur fëmijët e saj. Pas kryerjes së testeve, kishte prova se Fairchild ishte edhe binjakja e saj. Lydia Fairchild është e ekspozuar nga kimerizmi. Në qelizat e trupit të saj gjenden dy ADN.

Këto raste e bëjnë me vend atë që mund të na jetë dukur pak jo me vend lidhur me rregullimin mbi të drejtën e gjykatës për të vlerësuar provat dhe nga ana tjetër vlerësimin që GjEDNji jep vendit të veçantë që ka prova e ADN-së.

**Si përfundim**, fusha familjare mbetet një fushë ku bashkëpunimi me shkencën është i domosdoshëm. Nga ana tjetër, janë rregullat e të drejtës ato që synojnë balancën midis të vërtetës biologjike dhe interesit publik, i cili është interesi më i lartë i fëmijës.

## Bibliografi

1. Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 9062, datë 08.05.2003, i ndryshuar.
2. Konventa për të Drejtat e Fëmijës.
3. Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (1966).
4. Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë, ndryshuar
5. Konventa Evropiane mbi birësimin e fëmijëve [e rishikuar e vitit 2008] CETC 202.
6. Konventa Evropiane mbi birësimin e fëmijëve e vitit 1967 (ETS nr. 58).
7. Ligji nr. 8876, datë 04.04.2002 “Për shëndetin riprodhues”.
8. Mandro (Balili), Arta. *Maternity and paternity of the child in the new challenges of gender – discrimination*. Botuar në “In margine al Sinodo 2014. *Riflessioni in punto di diritto su matrimonio e famiglia*”. © 2014 Cacucci Editore, Bari.
9. Mandro (Balili), Arta. “Përcaktimi i atësisë së fëmijës në fokusin e jurisprudencës së GjEDNj-së dhe të legjislacionit e praktikës gjyqësore vendase”, revista “Jeta Juridike”, botim i Shkollës së Magjistraturës, Tiranë, nr. 4, dhjetor 2012.
10. ‘Implementation Handbook for the Convention on the Rights of the Child’ *Fully revised edition* prepared for UNICEF by Rachel Hodgkin and Peter Neëll. © United Nations Children’s Fund 2002.
11. Reservations, declarations and objections relating to the Convention of the Rights of the Child në <http://eeë.refëorl.org/pdfid/3ae6aeda4.pdf>
12. Briand, Solenn., Delarbre, Claire., Krygiel, Anne-Cecile. “*Filiation, genetics and the judge. Conciliation of family stability and the right of biological truth*”. Themis competition 2016.



Prof. Dr. Liri Dinga,  
M.Sc.Klarida Dushi,  
M.Sc.Kamela Mjeshtri

## Bimët në Kulturën e Shqiptarëve

### ...projeksione rreth natyrës, bimëve dhe identitetit psikokulturor të shoqërisë...

**S**hqyrtimi i bimëve dhe i përdorimit të tyre është një nga çështjet parësore të njerëzimit që është aplikuar nga të gjitha kulturat për qindra e mijëra vjet. Njerëzit janë varur gjithmonë nga bimët për plotësimin e nevojave të tyre parësore (ushqim, strehim, ngrohje, mjekësi, dekorim, etj.) kështu, natyrisht ka studjuar përdorimet e tyre. Gjatë shtegtimeve këto njohuri janë shkëmbyer me fiset fqinje, duke u përhapur kudo. Kështu, njohuritë për bimët janë përhapur në të gjithë botën qysh në fillim dhe shpesh elementët klasikë aktualë janë përdorur në kulturën popullore në gjini të tilla si fantazi, literaturë, film, television, kompjuter dhe video lojra, libra komike, madje edhe në muzikë. Që në kohët e lashta lulet kanë luajtur një rol të posaçëm në jetën e njeriut. Motivet lulore zbukurojnë objektet e kultit, dhe tempujt, sarkofagët dhe grataçelat. Shumë lule kanë patur një kuptim të posaçëm, por, ky kuptim ndryshon nga njëra kulturë në tjetrën.

#### **Roli dhe pozicioni i bimëve në kulturën shqiptare**

Shqiptarët, në një terren tepër të ashpër, izoluar dhe vetizoluar gjeografikisht kanë përpunuar një kulturë të pasur origjinale shpirtërore dhe materjale. Një vend të posaçëm në këtë kulturë zënë bimët që përbën një thesar për studimet në etnografi dhe sigurisht për botanistët.

Sipas statistikave, deri në vitin 1990 rreth 80% e popullsisë shqiptare jetonte në fshat, duke u marrë me veprimtari bujqësore, blegtorale ose në shfrytëzimin e pyjeve. Këto kanë qënë veprimtaritë tradicionale të shqiptarëve që kanë përcaktuar edhe raportet e veçanta me bimët, jo vetëm në përdorimin e tyre për ushqim, veshje, ndërtim në prodhimin e veglave të punës. Bimët janë vëzhguar për të njohur kërkesat e tyre për kultivim, për të evidentuar vlerat kuruese, rigjeneruese, aromatizuese. Për

bukurinë, shumllojshmërinë e luleve, ngjyrave, kombinacioneve të tyre, bimët kanë qënë burim frymëzimi dhe modele për zbukurimin e veshjeve, banesave, altareve. Në gojëdhënat, përrallat, këngët çdo gjë e bukur dhe e mirë kishte si model lulet e drurët. Për të konkretizuar sa më sipër po ndalemi në disa aspekte të përdorimit të bimëve

#### **1. Antroponimia.**

Emrat dhe mbiemrat e njerëzve. Përveç emrave me origjinë fetare, emrave paganë, të kombinuar, të krijuar etj. ka njerëz që mbajnë emra bimësh në shqip ose në latinisht, disa prej të cilëve paraqiten në pasqyrën e mëposhtme

Emrat në shqip: blerta, blerina, blerim, bajame, borziloke, burbuqe, dafina, erblin, gonxhe, hurma, ide, karafil, karafille, kumbull, kajsie, kulumbri, lila, lisan, lule, luljeta, lulezime, limone, lejmone, lajthije,

#### **Nga vështrimi i tyre rezulton:**

**1.1. Me emra bimësh thirren kryesisht vajzat, raporti vajza-djem është 9:1 që shpreh dëshirën që vajzat të jenë po aq të bukura sa dhe bimët që i kanë dhënë emrin.**

**1.2 Janë zgjedhur emrat e bimëve që karakterizohen për bukurinë e luleve, frutave apo të trupit si vjollca, shega, selvie. Në rastin e djemve zgjidhen për karakteristikat e bimëve sidomos madhështinë: Rrapi (*Platanus orientalis* L.), Lisian (*Quercus* sp.)**

**1.3 Përdoren kryesisht emra që tingëllojnë bukur. Këto rregullsi vihen re si në rastin e emrave shqip edhe atyre latinë.**

#### **2. Toponimia.**

Duke qënë i lidhur ngushtë me natyrën e bimët,

shqiptari ka studjuar edhe arealin e përhapjes së tyre. Nga rreth 2500 qendra të banuara që ndodhen në Shqipëri rreth 140 prej tyre mbajnë emra bimësh. Janë kryesisht bimë drunore e shkurre rreth 35 specie ku dominojnë Arra (*Juglans regia* L.) llojet e Dushqeve (*Quercus* sp. div.) molla (*Malus sylvestris* Mill), rrapi (*Platanus orientalis* L.) Nga bimët barishtore janë përdorur llojet e ndryshme të Lamiaceae që quhen çajës dhe orizi (*Oryza sativa* L.) emërtim i ri i dhënë pas futjes së tij në kulturë. Bimë të veçanta ose grupe bimësh kanë shërbyer si vende ku bëheshin takime, kuvende, rite fetare, duke shërbyer si sistem referimi edhe për aktivitete të tjera, burim frymëzimi për këngët, gojëdhënat etj. Të tillë mund të përmenden: Rrapi në Mashkullorë, Gështenja e Bajram Currit, Namazgjatë në Tiranë, Elbasan.

### 3. Thëniet popullore

Burim tjetër interesant për të arritur në përfundime me vlerë për biologjinë e bimëve janë edhe thëniet e fjalët e urta popullore. Populli thotë: **Kur vishet mani/Çvishet insani.** që do të thotë që njeriu duhet të heqë veshjet e dimrit kur mani të jetë veshur me gjethe gjë që ndodh pasi të jetë larguar rreziku i ngricave. Ose në thënie: *Shiu në korrik, misri me shinik/Shiu në gusht, misri me grusht*, gjejmë një porosi shumë të vlefshme për rritësit e misrit sipas së cilës ujitja duhet bërë në korrik për të marrë prodhime të larta, në gusht është shumë vonë. Shumë e bukur është porosia: *Nuse prej fisi/dru prej lisi. Rigoni nuk e ka për fis të bëhet lis.* Apo konstatimi: *Të vësh kufirin tek thana.*

### 4. Krahasimet

4.1 Populli është vëzhgues i vëmendshëm dhe i saktë në konstatimet që bën. Duke qënë se njeriu e pëlqen të bukurën çdo gjë që e tërheq tek vetja e tij, dhe dëshiron ta krahasojë me një objekt që e gjykon si më të përsosurin. Dhe për këto, shoqërisë, i kanë ardhur në ndihmë bimët. Bukuria në përgjithësi krahasohet me bimët, gonxhet. Trupi - Selvi, Syri - Rrush, Bajame, Ulli. Buzët - Trëndafil, Shegë, gonxhe. Jetëgjatësia - Rrapi, Dushku, Lisi

4.2 Edhe reagimet e njerëzve krahasohen me bimët, madje, ndryshojnë objektet e referimit në rastet

pozitive e negative. Në rastin kur njeriu skuqet nga turpi thuhet: u skuq si lulekuqe (Papaver) trëndafil (Rosa), kur skuqet nga veprim negativ thuhet: u skuq si spec (*Capsicum annum* L.)

4.3 Pasuria shpirtërore e një populli gjen pasqyrim edhe në pasurinë gjuhësore. Në këtë aspekt për të shprehur shumëllojshmërinë e karakteristikave të objekteve janë përdorur bimë që i saktësojnë ato dhe nuk lejojnë konfondime me të tjerë. Shembull shprehës është përdorimi i bimëve për saktësimin e ngjyrave. Ndërsa për të bardhën dhe të zezën nuk përdoren bimë pasi ato janë pa nuanca për ngjyrat e tjera përdoren një radhë bimësh psh. kuqe – luleshegë, çiklamin, speci, vishnje, hide. vjollcë – manushaqe, jargavani, mëllagë. jeshile – bari, bizele, preshi, ulliri. kafe - gështenjë, patllixhan, arrë. verdhë - shafran, lulekungulli, limon, ftua, potokalli, banane, kaki, kashte.

### 5. Veshjet popullore

Populli shqiptar është nga më të vjetrit në Ballkan, pasardhës i Ilirëve dhe vazhdues i arabëve të Mesjetës, nga të cilët ka trashëguar territorin ku banon, gjuhen e vet dhe tipare thelbësore të kulturës. Një nga këto tipare janë edhe veshjet. Kush ishte shqiptar dallohej edhe në pamjen e vet të jashtme nga mënyra si qe veshur. Veshjet kanë shërbyer si simbol për të shprehur përkatësinë kombëtare. Këto janë arsyt që deri në çerekun e parë të shekullit XX veshjet popullore ishin ende në përdorim të përditëshëm në pjesën më të madhe të popullsisë fshatare dhe pjesërisht të asaj qytetare

Përveç rolit etno-diferencues, veshjet janë objekt i studimit të funksioneve që bartin, modelimeve, larmisë dhe zbukurimeve. Eshte pranuar nga të gjithë se pjesa më e madhe e veshjeve tradicionale shqiptare janë zbukuruar me elemente vegjetative. Nga analiza e elementeve vegjetative të disa prej veshjeve që kemi studiuar kemi konstatuar.

5.1 Element dominues zbukurimi janë lulet. Ato i përkasin kryesisht familjeve Trëndafilore (Rosaceae), Yllore (Asteraceae), Karafiloreve (Caryophyllaceae).

Kjo konfirmohet edhe nga emri që mbajnë veshjet psh. jelek me trëndafila, karafila etj. Lulet



e familjeve Rosaceae e Asteraceae shihen nga lart, kanë numër çift petalesh (zakonisht 6-8), janë të qëndisura në mënyrë të tillë që dalin në relief shpesh duke të krijuar përshtypjen e luleve topçe. Në rastin e qëndismave me karafila, siç thotë populli, ato paraqesin më shumë kupën e lules se sa kurorën dhe shpesh janë më afër Liliaceae-ve. Qëndisja është bërë kryesisht duke përdorur fije ari prandaj edhe lulet e gjethet janë në shumicën e rasteve njëngjyrëshe.

5. 2. Elemente të tjerë shumë të përdorur janë gjethet. Në shumicën e rasteve ato janë të përbërë, pendorë, zakonisht me numër tek gjethëzash, të cilët edhe nga ana e tyre janë të dhëmbëzuar, me vriguj e pothuaj asnjëherë me buzë të plota, që ngjasojnë më shumë me gjethet e trëndafililit ose të Asteraceae. Ka raste kur e gjithë veshja është bërë duke e qëndisur me gjethe. Nga gjethet e thjeshta janë preferuar ato që karakterizohen për madhësinë e tyre dhe buzët e dhëmbëzuara ose vrigëlluara siç janë ato të dushqeve (*Quercus* sp. div.).

GJEDNj: *Pascaud kundër Francës*, aktgjykimi nr.19535/08

5. 3. Në disa veshje mbizotërojnë lulet dhe gjethet me 4 pjesë por në shumicën e rasteve me 3.

Këto populli i quan “veshje me terfajë” që i korespondojnë tërfilit (*Trifolium*). Kur ato

përfundojnë me tre pjesë ka lidhje me efektin e asimetrisë siç rrethohen me ojna shamitë e kokës ose bluzat e qëndisura. Në rastet e 4 pjesëve ato janë të lidhura me besimin që “gjetja e trifilit me 4, konsiderohet gjethe që sjell fat”.

5.4. Elementët vegjetativë janë përdorur jo vetëm për veçoritë dekorative por edhe për mesazhet e dëshirat që transmetojnë. Në (foto 9) veshja është zbukuruar me kallza drithërash për të shprehur ndjesinë e bollëkut.



Fig.9

5.5. Një fenomen shumë i përhapur vihet re gati në të gjitha veshjet është vizatimi me selvi (*Cupressus*). Selvia për hir të veçorive të saj zbukuruese (dru i lartë, i drejtë) gjithmonë e blerët, për faktin që ndodhet në florën spontane shqiptare, është përdorur prej kohësh për gjelbërimin e





institucioneve fetare, myslymane apo krishtere, varreza etj. Po për këto veçori ajo është përdorur për zbukurimin e veshjeve.

Në raste të tjera, duket qartë forma e drurit të selvisë. Në shumë veshje të tjera vizatimet (lule dhe gjethe) vendosen në mënyrë gjatore që të ngjasojnë me drurin e selvisë. Kjo vendosje jo vetëm për veçoritë e sipërpërmendura të selvisë por edhe për faktin që krijon përshtypjen e një trupi të gjatë e të hedhur.

## 6. Pozicioni i bimëve në objektet fetare dhe arkeologjike

Një fushë tjetër për studimin e marëdhënieve të popullit me bimët janë edhe objektet arkeologjike dhe fetare. Për këtë qëllim ne kemi studjuar objektet e qytetit arkeologjik të Apolonisë dhe objektet fetare: Manastiri i Ardenicës dhe Kishat e Xhamitë e qytetit të Beratit, ku, ka, mjaft elementë lulorë të përdorur në zbukurimet e objekteve të ndryshme. Në qytetin antik të Apolonisë (Fig.14)

6.1.1.Dashtra është shumë e përhapur në zbukurimet e kolonave dhe objekteve të tjera arkitekturore të gdhendura në gur, shfaqet gjerësisht si stoli në



kapitelet e Korinthit dhe renditet si përbërje dhe i aplikuar në frizë. (Fig.15). Është një nga bimët më të vjetra të Mesdheut, që përfaqëson jetë të gjatë. Megjithatë në shumicën e historisë së gjatë,

ornamenti gjethor i njohur si dashtë (Acanthus) është në fakt një gjethe imagjinare e përshtatur për shumë përdorime.

6.1.2.Element tjetër i pranishëm në punimet në gur për zbukurimin e fasadave, mbi dritare janë edhe rozetat. (Fig. 16.) Rozeta e ka origjinën e saj nga Rosa – trëndafili, lule me simbolikë shumë të fuqishme, që ze një vend shumë të qenësishëm në mitologjinë e shumë popujve edhe atë të shqiptarëve. Shqiptarët thonë për një vajzë se “kur qante nxirrte lotë trëndafili” ose i kanë dhënë emrin Drande vajzave që do të thotë drandofile = trëndafil.

Në objektet e marra në studim pjesët e rozetave janë të vendosura në dy qerthuj që përfaqësojnë atë të sepaleve dhe të petaleve. Lulet shpesh dalin në relief dhe duken si të ishin të gjalla.

6.1.3.Në objektet e studiura kemi hasur një deri dy raste të përdorimit të zambakut si element zbukurues.



(fig.20)Na duket pak e çuditshme pasi zambaku ka patur një simbolikë shumë të fuqishme në shumë popuj evropianë dhe jo vetëm.

Fig.20

## 6.2. Kishat e qytetit antik të Apolonisë dhe Monastirit të Ardenicës

Në të gjitha zbukurimet e përdorura për mjediset e brendshme të kishës mbizotërojnë elementet



Fig.22

floristike. Këto gjenden në ikonat, në kollonat, në punimet në dru. Gjetja e lidhjeve midis florës shqiptare dhe bimëve të përdorur si element zbukurues është një sipërmarrje e vështirë në shumë raste pasi ato janë përdorur si element zbukurues shpesh të stilizuara. Megjithatë disa prej tyre janë shumë të qarta dhe ne po përpiqemi ti analizojmë. (Fig. 22,)

6.2.2. Hardhia simbolizon lidhjen e shenjtë shpirtërore dhe derdhjen e gjakut nga Krishti (Fig. 23).





Fig. 23

### 6.3. Objektet në qytetin e Beratit

#### 6.3.1. Muzeu Etnografik

Në objektet e studiuara si: veshje, enë metalike dhe druri, sarkofage, etj., vihet re se elementët florealë dominonin mbi ata gjeometrikë.

Në baulet e drurit mbizotërojnë elementet floreal dhe ato zoomorfe. Në të gjitha baulet janë të gdhendura vazo të ndryshme që e quajm "Vazoja e jetës" nga e cila dalin lule të ndryshme si, karafil, zambak, trëndafili dhe lule e tipit 3 + 3, 4 + 4. (Fig. 28, 29)



Fig.28

Fig.29

Dhe në sarkofagët e gurit, elementët lulorë janë shumë të pëdorur, ku dominon gjethja e dashtës e kombinuar me zambakun, lule e tipit 5, karafil, tulipan. Lulja e tipit 4 (Fig. 30, 31) është në formë kryqi, prandaj mendohet të jetë përfaqësuese e familjes Brassicaceae




Fig.30



Fig.31

Në veshjet kryesisht të grave dominon elementi lulor, ku pothuaj e gjithë veshja është e qëndisur me elementë të ndryshëm. Ato që kemi aritur të përcaktojmë janë selvia, degë ulliri, lule (Fig.32, 33,34)



#### 6.3.2. Objektet krisitane

6.3.2.1. Dashtra, është element shumë i përdorur në ikona, në gdhendje druri, objekte metalike dhe perde





vetëm në këtë kishë (Fig. 43), gjendet e pranishme në ikona dhe simbolizon dashurinë e kushtuar, mbillet për të mbrojtur kopshtin nga e keqja. Aroma e lules besohet të sjell ëndrrat e dashurisë dhe pasionit. Nëse është sjellë lule në shtëpi, brenda vitit thuhet se do të ndodh një martesë.

6.3.2.6. Pema e palmës (Fig.44) gjendet në disa ikona dhe është simbol i kopshtit të parajsës.

për përdorim liturgjik. Në ikona gjendet përçarë kokës së shenjtorëve, ndërsa në punimet me dru shërben si bazë mbi të cilën vendosen lulet e tipeve të ndryshme.

6.3.2.2. Element tjetër i pranishëm në punimet në gdhendjet me dru dhe më pak në ikona janë edhe rozetat (Fig. 38), të cilat dalin në relief dhe duken si të ishin të gjalla, e plotësuar kjo pamje dhe nga ngjyrat mjaft të forta, sidomos ajo e kuqe, portokalli, e verdhë, bojqelli.

6.3.2.3. *Hardhia* (Fig. 39, 40, 41) është element shumë i përdorur në këtë kishë dhe gjendet në ikona, në gdhendje druri në ikonostas, ku dallohen qartë bistakët e rushit të ndërthurur me frutat në tre ngjyra, rrush i zi, i kuq dhe i bardhë.

Gjendet i pranishëm dhe në objekte të ndryshme metalike, ku gjethet janë të stilizuara q



Fig.44

6.3.2.5. Dorëzonja - Një element që gjendet





shalqini ,foi, dardha, shega.  
Fruti më i përdorur këtu është molla (Fig.52), e cila paraqitet në ngjyra të ndryshme.

Simbolika e pemës së frutit të mollës është: magji, rini, bukuri, lumturi, pavdekësi, mëkatim.

Fig.53

Elementë tjetër është limoni (Fig.53), i cili simbolizon besnikëri në dashuri.

6.3.4. Në pikturën murale gjenden: pemë ulliri, selvi, zambaku. Në derën e jashtme të teqesë gjendet, zambak, një lule e tipit 4 dhe një yll më 6 cepa.

### 7. Përfundime

Bimët janë element etnobotanik shumë i rëndësishëm që flet për një lidhje të ngushtë të njeriut me to, në kohën e këtyre qytetërimeve, por edhe në një periudhë më të vonë duke patur parasysh praninë e këtij elementi në ikonografinë dhe afresket kristiane.



### 6.3.3. Objektet islamike

6.3.3.1. Në objektet islamike mbizotëron elementi lulor. Ato që kemi identifikuar janë: trëndafili, zymbyla, tulipani.

Karafili, është pikturuar në njëmënyrë shumë të saktë, petalet paraqiten të ndara ndërsa gjethet të përkundërta me një gungë në nyje.

6.3.3.2. *Frutat* janë përdorur shumë si zbukurim në këtë teqe, janë të pikturuara në mënyrë mjaft origjinale, këto janë: molla,





Elementi lular është dominues kryesisht në zbukurimin e mozaikëve, sarkofagëve, dhe kolonave të tempujve antikë, etj.

Në një periudhë më të vonë, këto elemente kanë shërbyer edhe për zbukurimin e ambjenteve dhe objekteve të kultit, ikonave, veprave murale, afreskeve, kolonave të kishave të periudhës bizantine të këtyre qytetërimeve, etj.

Konkluzionet e mësipërme dëshmojnë qartë bashkëjetesën në kohë të elementeve botanikë dhe etnografikë, në këto qytetërime, si edhe origjinalitetin e kësaj ndërthurje duke përbërë bazat e një tradite.

Llojet bimore më të përdorura - një simbolikë për popujt - të identifikuar: ulliri, dashtra, zambaku, zymbyli, hardhia, trëndafili, karafili, selvia, palma, urthi, lulebore, dorëzonjë, iris, tulipani dhe nga frutat: mollë, dardha, ftoi, shega, pjepri, shalqini, limoni.

Ndër llojet më të përdorura të simbolikave janë ato që ndeshen edhe për popujt të tjerë, kryesisht të Ballkanit dhe Mesdheut, por që pa dyshim janë stilizuar edhe me traditën iliro-shqiptare. Të tillë janë: dashtra, ulliri, hardhia, trëndafili, urthi, zambaku.

Llojet e përdorura në disa raste

kanë patur vetëm kuptim dekorativ dhe autorët e tyre nuk iu janë referuar specieve të caktuara botanike.

Prania e elementit lular është dëshmues i komunikimit të kulturës shqiptare me atë evropiane.





## Projeksione dilema & paradokse... që shoqërojnë proceset e edukimit...

**N**evoja për një ...Makro-Optikë ... Edukimi ka qënë është dhe do vazhdojë të jetë “focus” i shoqërive cilido qoftë stadi ekonomik, shoqëror apo profili socio-politik i shoqërisë. Në këtë kontekst, edukimi, si dhe të gjithë proceset që përfshihen në të, po ballafaqohen me dukuritë që ka përfutur shoqëria në fund-shekullin që lamë dhe në dekadat e para të shekullit tonë.

Sfidat e kohës, janë njëkohësisht edhe sfidat e shkollës. Sfidat e kohës përcillen dhe përthyhen edhe brenda shkollës si institucion, duke krijuar situta te reja, psiko-sociale, didaktike, menaxheriale, vlerësuese.... Megjithëse, shkolla vazhdon të mbetet institucion solid, megjithëse shkolla “insiston” të ruajë strukturën e saj të brendshme dhe misionin për të cilin është krijuar, që është: arsimimi i individit dhe zhvillimi i gjithanshëm i personalitetit të individit, përsëri, ky institucion nuk mund dhe as duhet të jetë “ishull” i izoluar.

### **Shkolla mund dhe duhet të ballafaqohet...**

Cdo përpjekje për të hulumtuar dhe identifikuar dukuritë që prodhohen në shkollë, lipset së pari, të bëhet në nivelin makro-social. Shkolla dhe tërësia e proceve që prodhohen aty, janë “derivate” të asaj që shoqëria projekton dhe prodhon. Cdo përpjekje për të hartuar strategji që lidhen me perspektivën dhe zhvillimin e shkollës jashtë identifikimit dhe listimit të problematikës që prodhohet aty, jashtë identifikimit të origjinës prej nga burojnë problematikat, ... nuk mund të rezultojë efikase.

Kjo mënyrë arsyetimi funksionon dhe kur hartohen strategji lokale në edukim. Makro-optika bashkelidhur me specifikat dhe optikat-

lokale janë kusht për të qënë mjaftueshmërisht lucidë kur hartojmë strategji në edukim.

### **Kriteret prej nga nisen ekspertët kur hartojnë strategji edukimi**

- Edukimi si Nevoje e individit për të permbushur qëllimin e jetës,
- Edukimi si Sfide e individit në permbushje të ciklit jetësor,
- Edukimi si Zbulim & njohje e vetevetes,
- Edukimi si zhvillim i kapacitetit vetjak,
- Edukimi si vetë-plotësim i standardit dhe cilësisë së jetës,

Ndërtimi i strategjive në edukim duke projektuar itinerarin që permbushin kriteret e mësipërme mund të garantojë dhe konfirmojnë vërtetësinë dhe cilësinë e strategjiseve në edukim.

### **Edukimi në dy dekadat e para të shekullit tonë ... një vështrim holistik dhe serestik**

Shkolla si institucion dhe edukimi i individi/grupit/komunitetit, parimisht që merr kontekstin historiko-social e ekonomik të kohës kur dhe ku zhvillohet. Kjo konfirmon dhe njeherë nevojën për makro-optika dhe optika-lokale, tek ndërmarrim nisma për të bërë strategji në edukim. Hapi i parë është një skaner i makro-organizmit shoqëror. Cfarë po ndodh sëbrendshmi?

- Cilat janë sfidat?
- Cilat janë paradokset?
- Cilat janë tendencat e shoqërisë?



## Sfidat & paradokset<sup>40</sup>

- Është e konfirmuar edhe nga studiuesit por dhe nga aktorët në shkollë se...Shkolla si institucion po funksionon në një terren të ri: fryma e globalizmit dhe shoqërise së hapur, ... që do të thotë se po prodhohen indikatorë të tjerë të ndryshëm nga ata më parë për të matur cilësinë e shkollimit, vlerat e individit, të grupit, se: profili i qytetarit që do të rritet në shkolla pritet të jetë profili i një qytetari në dimensione të shumta, të tjera, në dimensione të një sjelljeje dhe të një repertori sjellor përtej repertorit të kultures së cilës i përket...se shkolla po projekton qytetarin e globit i lirë për të lëvizur për të ndërtuar një jetë përtej shtratis të tij kulturor.
- Disiplinat tradicionale shkollore, po funksionojnë në një terren të ri: ato gjithnjë e më shumë po interferojnë mes tyre...disiplinat shkollore të ngritura mbi shkencat respektive, po vihen në funksion të njëra-tjetrës dhe *po pikëpriten*. Pikërisht aty ku ndodh pikëprerja, po prodhohet një realiteti i ri shkencor...mësuesit por dhe nxënësët duhet të ndihmohen të përcjellin këtë realitet të ri...paralelisht me këtë process shkolla po badhafaqohet me “ekstrakurrikulen” informacion që nuk vjen nga disiplinat tradicionale shkollore, por nga tendencat që ka prodhuar koha...çështje kauzale si: dimensionimi gjinor në edukim, dimensionimi global, mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm, të drejtat e njeriut, e tjer, janë një tjetër sfidë me të cilën shkolla duhet të ballafaqohet.
- Shkenca e pedagogjisë, e konsideruar si teoria dhe praktika e edukimit, e cila i ka shërbyer në shekuj formimit të të rinjve dhe proceseve në shkollë, gjithnjë e më tepër po gjendet në vështirësi... dukshëm, kjo shkencë nuk po

<sup>40</sup> Auditori është i ftuar të mirëkuptojë parashkrimin. Sfidat dhe paradokset e listuara... janë sfida të milenijumit, janë sfida në nivel evropian dhe përtej. Ndaj lutemi të pranojmë që këndi i shikimit tim sot, është holistic, me përjashtim të disa rasteve ku më është dashur të specifikoj dicka. Më pas në diskutime jeni të ftuar të identifikojmë se si këto sfida dhe paradokse përthihen në terrenin tonë...çfarë ofrojmë dhe cila është kostoja vlerore dhe civile...

perbadhon problemet e shumta të edukimit. “sjellja-model” si fakt i konsideruar në shkencën e pedagogjisë, nuk ka më suksesin e mëparshëm, kështu kjo shkencë, po i lë më shumë hapsirë “sociologjisë së edukimit”, kësaj shkence ndërdisiplinore e cila thërret në ndihmë për analizë me shumë se një faktore, shumë disiplina...

- Aleatët “tradicionale” të shkollës si familja, media, komuniteti, jo gjithmonë dhe jo në mënyrë frekvente dhe jo në mënyrë të qëllimtë po përmbushin “rolet” e tyre tradicionale. Duke u vendosur shpesh në korsi “të kundërta” ku synon të shkojë shkolla si institucion... struktura e familjes ka pësuar metamorfoza të dukshme, por, dhe media e shkruar dhe vizive, priret përherë e më shumë të jetë komercialiste. Media po e këmben misionin e informimit dhe të formimit të shoqërisë me atë të komercializmit. Fitimi, po bëhet fryma e medias duke anashkuar misionin e saj fillestar. Me vjen në mendje “një reklamë me frymë paradoksale” një fëmijë sjell rezultatet e tij shkollore në familje, rezultate tërësisht negative, ndërkohë që reklama fokusohej tek “qetësia” dhe “rehatia” që ju jepte një dyshek i reklamës...prindërve të fëmijës. Reklama për DORMEON ishte shumë më e rëndësishme sesa angazhimi dhe përgjegjësia e prindërve..., Këto reklama e “dhunojnë” gjithë moralin që shkolla synon, duke vënë në pikëpyetje deri edhe rolet prindërore? Media vizive, është një sfidë tjetër të cilën minimalisht duhet ta njohim dhe të ballafaqohemi me të.
- A mundemi? Si? Në çfarë mënyre mundet të ballafaqohemi me median dhe të sinkronizojmë qëllimin e përbashket?
- Është fakt. Teknologjia dhe gjithë “arsenali” teknologjik po i vjen në ndihmë shkollës dhe nxënësit. Vetëm kaq? Ky arsenal teknologjik bashke me risitë që sjell po vë në sprove

- dhe shkencën e “didaktikës”... si shkenca e vetme deri me sot e identifikuar si shkenca e mësimdhënjes.... mësimdhënja dhe gjithë proceset që ndërthuren aty po “struken” ballë teknologjisë dhe reklamës që e shoqëron teknologjinë....!,
- Si mund dhe A duhet të rezonojnë “të bashkëjetojnë” teknologjia me didaktikën, këtë shkencë që ka të njëjtën moshë me shkollën si institucion...teknologjia? Kundër apo në mbështetje të shkollës?!
  - A mundemi të krijojmë paketa trajnimi që ndihmojnë didaktikën dhe teknologjinë të bashkëjetojnë në harmoni dhe të garantojnë cilësinë? A kemi, vëmendjen e mjaftueshme të bëjmë këtë? Kjo është një sfidë tjetër me të cilën nuk e di sa jemi gati të ballafaqohemi....
  - *Metafora... Mësuesi në “trekëndëshin Bermunda”*. Gjithnjë e më shumë po C”mitizohet roli/e e mësuesit në jetën e shkollës. Cfarë pritet të ndodhe me rolet tradicionale, misionin, imazhin e tij/saj? Prej mësuesve kerkohet, vecse kërkohe dhe pritet cilësi? Po çfarë ndihme ju japim dhe si?
  - *Metafora “Shkolla – me dyer në fuqi-N*. Kjo metafore e shumë trajtuar nga sociologë të edukimit kërkon vëmendjen e ekspertëve. Si ta kuptojmë që: Cdo godinë shkollore ka aq dyer sa nxënës ka....si ta kuptojmë dhe menaxhojmë këtë tog-fjalësh metaforik që permban një të vertetë të prekshme...? A kemi ndarë me shkollën qëllimshëm përmbajtjen e këtij fakti. Si e kuptojnë dhe a e percjellin mësuesit këtë fakt sociologjik? A inicojmë politika trajnuese për ti mbështetur mësuesit t’ju vene emrin që kanë “dukuritë” e reja në të përditëshmen shkollore?
  - Sistemi i formimit universitar të mësuesit. A mund dhe si mund të jetë në koherencë me dukuritë që prodhon e përditshmja në shkollë.... Në të përditshmen shkollore jemi dëshmitarë se ndodh që ky realitet i ri, të

verë mësuesin në rate të caktuara, në situatë tragji/komike.

- Institucionet ku prodhohen politikat e edukimit... gjenden në një process “inflacioni” udhëzimesh, urdhëresash, shkresash pa u qederosur se sa dhe si përthyeret në klasë “substancia” e asaj që kërkohe në dokumentet ministeriale...
- “Dilemat etike universal”, janë një peshë e vështirë për tu mbajtur nga mësuesi dhe nga nxënësi njekohësisht... jam dëshmitare e një debate mes mësuesit dhe nxënësve rreth “Klonimit”, “Eutazania” “Ekosistemeve”

### **Edukimi në terrenin shqiptar... si vjen?**

- Predispozita e institucioneve për ndryshim....
- Mania për të percjellë “Risi” kur nuk ka terren
- Kurthet<sup>41</sup>
- Mitizimi & C’mitizimi i shkollës... Alfabetizmi dhe analfabetizmi

<sup>41</sup> Grackat e edukimit ... nuk është e menaxhuar mirë dëshira për të cuar tek shkolla “risi”, Risitë nuk percillen nga lart poshtë, identifikohen poshte dhe pergjithësohen lart nga ekspertët... pëmdryshe biem në “gracka”

# Sfidat e punësimit të të rinjve në axhendën e zhvillimit të qëndrueshëm” ...projeksione rreth zhvillimit të qëndrueshëm nga kënvështrimi i punësimit...

**P**ohim i gjithëpranuar... Faktor vendimtar i rritjes së produktivitetit të shoqërisë për një zhvillim të qëndrueshëm është forca punëtore e mirëkualifikuar që i përgjigjet kërkesave të tregut dhestandardeve në rritje të zhvillimit të teknologjisë, shkencës dhe konkurrencës globale. Dilema e shoqërisë sotme për të balancuar kërkesën e tregut me nivelin aftësive dhe kompetencave të forcave të punës, është një nga temat që ka tërhequr vëmendjen për studime mjaft shkencore, jo vetëm në vendet e zhvilluara, por së fundmi edhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Ky artikull bazohet në studimin “Universities and the Labour Markets” që synon të sjellë një analizë komplekse të impakteve sociale të reformave në arsimin e lartë dhe nevojave për tapërshtatur ofertën që sjell arsimi i lartë me kërkesat e tregut të punës në Shqipëri. Analiza bazohet në një ndërthurje të metodave cilësore të kërkimit shkencor si intervistat dhe fokus grupet, me ato sasiore që i referohen pyetësorit online të drejtuar tek të sapodiplomuarit dhe punëdhënësit e tyre. Këto të dhena parësore janë plotësuar me një shqyrtim të kujdesshëm të dokumenteve zyrtare që nga strategjitë, ligjet, raportet e deri tek të dhëna statistikore të grumbulluara nga Ministria e Arsimit, INSTAT dhe Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri. Konkluzionet tregojnë se futja e sektorit privat në arsimin e lartë, për t’ju përgjigjur sfidave të rritjes së kapitalit social për një zhvillim të qëndrueshëm të vendit, solli rritjen e numrit të të diplomuarve, por edhe rritjen e nivelit të papunësisë së tyre. Reformimi i arsimit të lartë kërkoi rritjen e standardeve të cilësisë dhe lidhje të teorisë me jetën ekonomike e sociale në vend, për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm bazuar mbi njohuritë bashkëkohore dhe inovacionin. Konkluzionet

dhe rekomandimet iu drejtohen të gjithë aktorëve të shoqërisë shqiptare, që nga politikbërësit, universitetet dhe bizneset, që të bashkërendojnë veprimtaritë për të garantuar progresin e vendit përmes rritjes së kapitalit njerëzor.

## I. Hyrje

Këtë çerek shekulli tranzicion 1990-2015, Shqipëri ka qenë e ekspozuar ndaj vështirësish të mëdha në rrugën drejt zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik e social. Ekonomia e tregut të lirë ka sjellë papunësi dhe aktivitet të ulët edhe të fuqisë punëtore me arsim të lartë. Paralelisht, intensifikimi i procesit të integritimit europian ka shtuar presionin dhe përgjegjësinë e Shqipërisë për të siguruar një fuqi punëtore më konkurruese, si brenda rajonit të Ballkanit, edhe ndaj hapjes me shtetet e Bashkimit Europian. Pritshmëritë në këtë drejtim kanë të bëjnë më së shumti me zbatimin e politikave efektive të integruara të arsimit dhe të tregut të punës që të adresojnë veçanërisht sfidat e të rinjve për një jetesë më të mirë përmes punës të kualifikuar. Në objektivat e BE-së për zhvillim të qëndrueshëm, të përcaktuara në Strategjinë Europa 2020, synohen ndryshime në aftësitë që kërkohen në tregun e punës, ku forcat e punës të konkurojnë për të përballuar një zhvillim inteligjent, të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës, bazuar në dije dhe konkurrencë, që vjen si rezultati avancim të shkencës dhe teknologjisë. Rritja e nivelit të kualifikimit të forcave të punës vlerësohet si mënyra më e mirë për të kapërcyer dobësitë strukturore të ekonomisë së vendeve të BE-së, me qëllim që të përballojnë konkurrencën ekonomike globale. Prandaj dhe dy nga objektivat kryesorë të strategjisë Europa 2020 janë rritje e punësimit prej 75% e popullsisë së moshës 20-64 dhe të paktën 40% e atyre të moshës 30-34 vjeç të kenë përfunduar arsimin

e lartë. Në përputhje me këtë strategji, qeveria shqiptare hartoi “Strategjinë për Punësim dhe Aftësi 2014-2020”, ku një nga objektivat kryesore është rritja e aftësive dhe kompetencave të forcës së punës (www.social.gov.al). Në dhjetë vitet e fundit, qeveria shqiptare, e përfaqësuar nga demokratë apo socialistë, e ka konsideruar si një prioritet kombëtar reformimin e sistemit të arsimit në të gjitha nivelet, me një fokus të veçantë në arsimin profesional dhe arsimin e lartë. Politika për një lidhje më të ngushtë të arsimit profesional me punësimin u pasqyrua jo vetëm në strategji, por edhe në ndryshime institucionale pas vitit 2013, ku politikat e arsimit profesional kalojnë nën autoritetin e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë. Ndonëse kuadri ligjor është përmirësuar me harmonizime legjislativore shqiptar me Acqui Communautaire, sidomos pas vitit 2006 kur integrimi në BE u bë prioritet strategjik për vendin me nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizimit dhe Asociimit, ky proces kërkon ndërmarrjen e një programi të gjithanshëm ndryshimesh institucionale, strukturore dhe investimesh në kapitalin social (Xhumari, M., 2011:576). Dilema aktuale për të balancuar kërkesën e tregut me nivelin e aftësive dhe kompetencave të forcave të punës, është një nga temat emjaft studimesh kryesore. Duke iu referuar studimit të McKinsey Center, del qartë se “Me kaq shumë të rinj në kërkim të punës, mund të supozojmë se papunësia e të rinjve nuk është thjesht një çështje e kërkesës së tregut dhe se punëdhënësit do të mund të punësojnë talente të shkëlqyer me kosto modeste. Një arsye thelbësore për të rinjtë në kërkim të punës është mungesa e aftësive të rëndësishme për kërkesat e vendeve të lira të punës. Në Greqi, ku shkalla e papunësisë së të rinjve ka qenë mbi 55% në vitin 2013, punëdhënësit ende ankohen se ata nuk mund të gjejnë forca pune të përshtatshme; e njëjta gjë është e vërtetë për Suedinë dhe Gjermaninë.” Nga një studim tjetër i European Training Foundation konkludohet se vendet e punës të krijuara rishtazi kërkojnë lloje të ndryshme të aftësive, krahasuar me ato vende pune që janë shkatërruar. Ky proces i ristrukturimit dhe i zgjerimit të kërkesës për aftësi të reja, ndodh më shpejt sesa përshtatet sistemi i arsimit dhe formimit profesional, duke rezultuar

në mungesa të të diplomuarve të kualifikuar (ETF, 2014).

Kur dështimet e tregut rezultojnë në pabarazi strukturore të tregut të punës, ndërhyrjet më të përshtatshme për zvogëlimin e kostove të rëndësishme ekonomike dhe sociale të kësaj mospërputhje janë kryesisht politikat arsimore dhe të formimit profesional, politikat e punësimin dhe të industrializimit. Në këtë kontekst, kjo analizë prezanton sfidat e një zhvillimi të qëndrueshëm përmes nevojës së rritjes së nivelit të kualifikimit të forcave të punës, kryesisht në arsimin e lartë universitar në Shqipëri, përmes një planifikimi të integruar të zhvillimit ekonomik e social të vendit. Për të kuptuar më mirë situatën e fuqisë punëtore të kualifikuar, analizohen prirjet e zhvillimit në arsimin e lartë, në krahasim me kërkesat e tregut. Konkluzionet dhe rekomandimet i drejtohen të gjithë aktorëve socialë që, përmes planifikimit të integruar dhe bashkëpunimit, të mundësojnë progresin e shoqërisë shqiptare përmes rritjes së punësimin të të rinjve të cilët kanë investuar për të arritur një shkallë të lartë kualifikimi.

## **II. Oferta në Tregun e Punës nga Arsimi i Lartë në Shqipëri**

Nga viti 2003, Shqipëria ka pranuar zyrtarisht sistemin e Bolonjës dhe Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL) kanë përshtatur kurrikulat dhe futur sistemin ECTS, një proces që ende mbetet i pakompletuar, veçanërisht në drejtim të harmonizimit të kurrikulave (MAS, 2014a). Pas 2003, vala e reformave në arsimin e lartë është intensifikuar dhe vemendja e publikut dhe politikës është rritur krahasuar me vitet e mëparshme” (Xhaferri & Brankovid, 2013:33). Reformat e njëpasnjëshme në arsimin e lartë kanë synuar liberalizimin e tij, si një sferë e politikave publike ku dominonte monopoli i shtetit dhe pas 2004 fillon futja e sistemit privat. Pra, në dhjetë vjetë arin e fundit, politika e arsimit të lartë po ndeshet me dy sfida të mëdha në të njëjtën kohë:

- 1- Liberalizimi i sistemit të arsimit të lartë përmes futjes së sektorit privat për t’iu përgjigjur sfidave të rritjes së kapitalit social për një zhvillim të qëndrueshëm;

2- Transformimi i sistemit të trashëguar për t'iu përgjigjur sfidave politike të integritimit evropian të vendit, vecanërisht pas vitit 2006, me nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit.


Roli i arsimit si pjesë integruese e politikave ekonomike dhe sociale në BE do të pranohetme Strategjinë e Lisbonës në 2000 ku objektivi kryesor ishte që deri në 2010 “BE të bëhej ekonomia më dinamike dhe konkurruese në botë, e bazuar në njohuri, e aftë për një rritje ekonomike të qëndrueshme”. Këto objektiva morën një vëmendje të vecantë në Strategjinë Europa 2020, e cila shërbeu si udhërrëfuese për Strategjinë

INSTAT mbi numrine studentëve të rregjistruar në arsimin e lartë në raport me grupmoshën respektive, Shqipëria duket e vendosur në një pozicion të favorshëm krahasuar menjë serë vendesh të BE-së, ku mbi 60% e të rinjve ndjekin arsimin e lartë.

**Tabela 1. Krahasim Ndërkombëtar: Grupmosha e përfshirë në IAL, 2015**

Burimi: INSTAT2015 dhe Instituti i Statistikave të UNESCO-s 2014, [ëëë.instat.gov.al](http://ëëë.instat.gov.al)

Ndonëse ka një rritje gati trefish të numrit të studentëve të rregjistruar në arsimin e lartë nga



2020 të vendeve të EJL dhe strategjitë kombëtare tështeteve të EJL. Duke ndjekurprirjet evropiane për rritjen e nivelit të kualifikimit të forcave të punës, reformat në arsimin e lartënë Shqipëri synuan masivizimin e tij duke hapur mundësinëe shkollave të larta private. Efektet e liberalizimit të arsimit të lartëduken qartë nërritjen me shpejtësi tëprogrameve të studimit dhe numrit të studentëve. Dukeiu referuar të dhenave të UNESCO dhe

2004 në 2014 për të arritur standardet evropiane, cilësia e arsimit të lartë mbetet një sfidë e madhe, sikurse theksohet edhe në dokumentin politik të reformës së Arsimittë Lartë dhe Kërkimit Shkencor (MAS, 2014a). Duke analizuar të dhënat e grumbulluara mbi arsiminelartë në Shqipëri, rezulton se programet e studimit më të përhapura janë “Biznes, Administrim dhe Juridik” me23.6%,të ndjekura nga “Artet dhe Shkencat Humane”13.8%, ndërsa në IAL private “Biznes,



Administrim dhe Juridik” zenë 42.7%, të ndjekura nga degët “Shkenca Sociale, Gazetari dhe Shkencat e Informimit” me 21.4%. Të njëjtën prirje ndjekin edhe studentët, respektivisht me 26.4% e gjithë studentëve në Bachelor nga IAL publike studiojnë “Biznes, Administrim dhe Juridik”, ndërkohë që

private dhe sistemit part-time me reformën e nisur me 2014 në arsimin e lartë në Shqipëri, sigurisht që numri i programeve të studimit në shkencat shoqërore, ekonomike dhe juridike ka pësuar rënie pasi shumica e programeve të mbyllura ishin në këto fusha. Institucioneve të arsimit të

| Fushat e studimit                                       | Numri i programeve të studimit | Perqindja që zenë programet e studimit |
|---|--------------------------------|--|
| 1. Edukimi  | 162                            | 9.2%                                   |
| 2. Artet dhe Shkencat Humane                            | 243                            | 13.8%                                  |
| 3. Shkencat Sociale, Gazetari dhe Shkencat e Informimit | 200                            | 11.4%                                  |
| 4. Biznes, Administrim dhe Juridik                      | 414                            | 23.6%                                  |
| 5. Shkencat e Natyrës, Matematika dhe Statistika        | 120                            | 6.8%                                   |
| 6. Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit (ICTs)   | 90                             | 5.1%                                   |
| 7. Inxhinieritë, Manifaktura dhe Ndërtimi               | 141                            | 8.0%                                   |
| 8. Bujqësi, Pylltari dhe Veterinari                     | 62                             | 3.5%                                   |
| 9. Shëndetësi dhe Mbrojtja Sociale                      | 214                            | 12.2%                                  |
| 10. Shërbimet   | 111                            | 6.3%                                   |
| <b>Gjithsej</b>   | <b>1,757</b>                   | <b>100%</b>                            |
| HSS (02+03+04)  | 857                            | 48.8%                                  |
| STEM (05+06+07)   | 351                            | 19.9%                                  |

në IAL private studentët në këtë fushë studimi zenë 40% të të gjithë studentëve.

## Tabela 2. Vendi që zenë fushat e ndryshme të studimit në arsimin e lartë, 2014

Burimi: Përpunim nga autori i statistikave zyrtare të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe të IAL

Këto rezultate tregojnë se IAL publike vazhdojnë traditën e zhvillimit të shkencave humane, ekonomike dhe juridike, ndërkohë që pa e kuptuar krijojnë papunësi të të diplomuarve në këto fusha studimi. Pas mbylljes së gati gjysmës së IAL

lartë u mungojnë vlerësimet enevojave të tregut për profesionistë të kualifikuar me diploma universitare nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit që të planifikojnë dhe ofrojnë programe studimi adekuate. Vetëm së fundmi, në kuadrin e projektit të BE IPA II, Shërbimi Kombëtar i Punësimit i mbështetur nga ILO ka realizuar studimin e tregut për të orientuar arsimin profesional. Nga ana tjetër, ende sistemi i pranimit në IAL publike mbetet i centralizuar, ndërkohë që IAL kanë nevojë të rishikojnë kriteret dhe procedurat e pranimit, edhe si rezultat i ndryshimeve që kanë sjellë IAL

private, cilat kanë një proces të hapur pranimit krahasuar me IAL publike. Efektet e zbatimit të Ligjit nr. 80/2015, datë 17.09.2015 “Mbi Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” në vitin akademik 2016-2017 me procesin e pranimeve në universitetet e provuan më së miri këtë konkluzion, pasi koeficientët preferencialë për lëndë të caktuara të vendosura nga fakultetet publike dhe procedura e regjistrimit e aplikuar, i privuan shumë studentë nga e drejta për të vazhduar studimet në degët e tyre të preferuara.

### Tabela 3. Proporcionet e studentëve në IAL publike dhe private, 2012-15

Burimi: Përpunim nga autori i statistikave zyrtare të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe të IAL

Krahas rishikimit të procesit të pranimit, universitetet kanë nevojë t’i kushtojnë vëmendje procesit se ku do të përfundojnë ata pas diplomimit që të realizohet një tranzicion i natyrshëm i tyre nga statusi student në të punësuar. Nëse deri dje, pra në sistemin socialist nga ku filloi ndryshimi, ishte shteti që caktonte emërimet e të diplomuarve sipas një plani tepër të centralizuar, tashmë ata janë në derë të ekonomisë së tregut. Tendencat e rritjes së numrit të të diplomuarve me arsim të lartë në vitet e fundit janë shoqëruar me tendencat e zvogëlimit të punësimit të tyre, punësim i cili deri dje ka qenë i garantuar. Prirjet drejt rritjes së papunësisë së të diplomuarve me arsim të lartë janë një tregues i cili ve në dilemë efektivitetin e investimit të shoqërisë në arsimin e lartë dhe sfidat e zhvillimit të qendrueshëm që kërkon forca punëtore me kualifikim të lartë. Deri tani, në

treguesit e zakonshëm të rezultateve në arsim janë analizuar inputet e sistemit, sa studentë kanë hyrë, sa prej të diplomuarve në arsimin e mesëm ndjekin arsimin e lartë, si dhe outputet, sa studentë kanë përfunduar arsimin, sa prej të regjistruarve në IAL janë diplomuar sipas degëve respektive. Dihet që arsimi i lartë ka efekte afatgjata në progresin e shoqërisë dhe vështirë të matet impakti i investimit në edukim me tregues sporadikë të punësimit apo të papunësisë së të diplomuarve në një treg kaotik. Po ashtu dihet që qendrimi i gjatë në statusin “I papunë” bën që aftësitë e fituara gjatë formimit të profesionit të humbasin gradualisht. Kanë korrelacion të drejtpërdrejtë midis nivelit të arsimit dhe cilësisë së forcave të punës, që do të përballen me zhvillimin e bazuar në dije dhe kompetenca. Prandaj në treguesit e zhvillimit të qendrueshëm janë përfshirë jo vetëm treguesit ekonomikë të rritjes së GDP, por edhe treguesit socialë të rritjes së punësimit dhe të kohezionit social. Rritja e punësimit të të diplomuarve tregon se në ç’masë rritet ose jo produktiviteti i shoqërisë, si rezultat i investimit në arsimin e lartë. Prandaj edhe në standardet e cilësisë për arsimin e lartë janë përcaktuar tregues edhe të procesit të daljes nga universiteti. IAL nxiten qetëndjekin me forma të ndryshme, kontakte me të diplomuarit e tyre, me studime të vazhdueshme drejtimet e punësimit të tyre. Ndërkohë që gjithë procesi i edukimit në nivelet Bachelor e Master, ofron mundësi për lidhje të teorisë me praktikën dhe aftësimin profesional. Nga fokus grupi me studentë që kishin pasur mundësi të përfitonin nga Programi i BE Erasmus Mundusit mobilitetit në universitetet evropiane, rezultoi që një nga pikat e dobëta të universiteteve

|                 | Të Regjistruar Enrolment |         |         | Të Diplomuar |         |         |
|-----------------|--------------------------|---------|---------|--------------|---------|---------|
|                 | 2011-12                  | 2012-13 | 2013-14 | 2011-12      | 2012-13 | 2013-14 |
| % e IAL Publike | 79.3%                    | 79.0%   | 81.7%   | 62.2%        | 72.0%   | 84.4%   |
| % e IAL Private | 20.7%                    | 21.0%   | 18.3%   | 37.8%        | 27.8%   | 15.6%   |

shqiptare është se aty ka shumë mësim teorik në klasë dhe pak projekte kërkimore dhe mundësi internshipi, si dhe shërbime të pamjaftueshme për orientimin e karrierës së studentëve.

### III. Kërkesa për fuqi punëtore të kualifikuar në tregun shqiptar

Prirja e viteve të fundit për rritjen e papunësisë së të diplomuarve të rinj ka thyer bindjen tradicionale në shoqërinë tonë që marrja e një diplome universitare do të sigurojë një punë të mirë, e cila ka qenë e dominuesë në sistemin mëparshëm socialist. Nga ana tjetër, ekonomia e tregut të lirë nuk është duke vepruar në bazë të meritave dhe profesionalizmit, por është e dominuar nga informaliteti i lartë dhe korrupsioni. Prandaj rritja e mundësive për punësim nuk ka të bëjë aq shumë me aftësitë dhe kompetencat e fituara, sepse tregu i punës është i deformuar nga ndërhyrja e faktorëve politikë, ekonomikë dhe socialë. Anketa e Forcave të Punës 2015 vlerëson se, për popullsinë 15-64 vjeç, shkalla e punësimit është dukshëm më e lartë për personat me arsim të lartë dhe ata me arsim të mesëm profesional, ndonëse ka prirje të dukshme drejt rënies nga viti në vit. Nëse në vitin 2011 të punësuarit me arsim të lartë zinin 68.1% të forcave të punës me arsim të lartë, në vitin 2015 niveli i punësimit të tyre bie në 64.4%. Forcat e punës me arsim të lartë u rritësi rezultat i masivizimit të arsimit të lartë, por punësimi i tyre ka ardhur në zbritje dhe niveli i të papunëve me diplomë universitare është rritur në 19.1% në vitin 2015, krahasuar me 14.9% në 2013 (INSTAT, AFP 2015). Duke iu referuar edhe të dhënave administrative nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit, është e qartë tendenca në rritje e punëkërkesve të papunë me arsim të lartë në pesë vitet e fundit, nga 6,626 vetë në 2013 gati dyfishohet në 12,179 vetë në 2015 (SHKP, 2015). Bazuar në të dhënat administrative është e vështirë për të përcaktuar se sa prej të papunëve me arsim të lartë i përkasin të diplomuarve të rinj, të moshës 20-29 vjeç, apo grup-moshës mbi 50 vjeç, por të dy këto kategori kanë tendencë të qartë rritjeje të papunësisë. Megjithatë, në vitin 2014, numri i të diplomuarve të regjistruar si punëkërkes

ishite vetëm 6% e numrit të përgjithshëm të punëkërkesve të regjistruar, pasi ata nuk kanë asnjë lloj përfitiminë rast papunësie. Nga studimi rezulton se vetëm 1.3% e të diplomuarve të anketuar kishin pasur orientim nga zyrat e punës dhe po aq nga qendrat e karrierës të universiteteve, të cilave ju mungon përvoja me shërbime të tilla. Është e qartë se nga njëra anë, tregu i punës nuk është në gjendje për të akomoduar rritjen e fuqisë punëtore me arsim të lartë në fusha të caktuara si administrim biznesi e juridik apo shkencat humane. Nga ana tjetër, jo të gjithë të diplomuarit me arsim të lartë kanë aftësitë e nevojshme për të përballuar kërkesat e tregut të punës. Referuar analizës së programeve universitare rezulton zhvillimi i tepërti degëve/ profesioneve të caktuara në shkencat humane dhe zhvillimi joadekuat i të tjerave si inxhinieritë, IT apo shërbimet, të cilat janë më të kërkuara në tregun e punës. Këto rezultate konfirmohen edhe me statistikat zyrtare të punësimit sipas degëve të ekonomisë të vitit 2015, kupeshën më të madhe në punësimin e popullsisë 15 vjeç e lart, e zë sektori i bujqësisë me rreth 41,3 % dhe sektori i shërbimeve me 40,2 %, ndërkohë që industria punëson vetëm 18,5 % të të punësuarve. Po sipas INSTAT, në punësimin sipas degëve të ekonomisë dhe nivelit arsimor në periudhën 2012-2014, ka një prirje rritjeje në punësim për personat me arsim të lartë tek degët e ekonomisë si manifaktura, industria minerale dhe energjetike, si dhe shërbimet.

#### Tabela 4. Dinamikat e punësimit sipas nivelit arsimor në 2012-2014

Çështja është se programet e studimit të arsimit të lartë duket se kanë nevojë të orientohen në ato fusha të studimit të cilat përgatisin profesionistë si inxhinierë të prodhimit dhe përpunimit të mineraleve, të përpunimit të produkteve bujqësore dhe të manifakturës, si dhe të shërbimeve. Programi i qeverisë “Reforma ekonomike 2015-2017” përcakton si “sektorët më dinamikë të ekonomisë dhe me mundësi për punësim të të sapodiplomuarve në të ardhmen, sektorët e industrisë dhe të shërbimeve (Ministria e Financave, 2015: 8). Këta sektorë kanë rritur

(Në mijë njerëz)

| Sektorët e Ekonomisë | Bujqësia |      | Manifaktura |      | Ndërtimi |      | Minierat & Electriciteti, Furnizimi me Gaz & Ujë |      | Shërbimet tregu |      | Shërbime jo tregu |      |
|----------------------|----------|------|-------------|------|----------|------|--|------|-----------------|------|-------------------|------|
|                      | 2012     | 2014 | 2012        | 2014 | 2012     | 2014 | 2012   | 2014 | 2012            | 2014 | 2012              | 2014 |
| <i>Vitet</i>         |          |      |             |      |          |      |  |      |                 |      |                   |      |
| <b>Gjithsej</b>      | 526      | 443  | 81          | 90   | 93       | 66   | 22   | 25   | 246             | 235  | 171               | 174  |
| 9-Vjeçar             | 400      | 332  | 38          | 37   | 50       | 35   | 6  | 4    | 75              | 66   | 21                | 15   |
| I Mesëm              | 117      | 104  | 39          | 46   | 35       | 28   | 14   | 17   | 131             | 117  | 68                | 55   |
| <b>I Lartë</b>       | 10       | 7    | 4           | 7    | 8        | 4    | 2  | 5    | 40              | 52   | 83                | 104  |

Burimi: Përpunuar të dhenat e INSTAT, Anketa e Forcave të Punës, 2012-2014

punësimin e profesionistëve me arsim të lartë edhe gjatë periudhës 2012-2014. Orientimi i qartë i politikave ekonomike për të siguruar zhvillimin e qendrueshëm të vendit, duhet të planifikohet i integruar me politikat arsimore, vecanërisht të orientohet qartë arsimi i lartë si një investim afatgjatë dhe me kosto të larta për individin dhe shoqërinë. Nga studimi ynë, përmes anketimit të bizneseve të të gjitha llojeve, rezulton nevoja për aftësitë e komunikimit, kreativitetin, aftësitë kompjuterike, aftësitë organizative, aftësi për të punuar në ekip dhe dëshira për të mësuar të reja e profesionit tek punonjësitë rinj me arsim të lartë. Këto gjetje mbështesin gjetjet edhe nga studimi i ILO dhe SHKP “Skills Need Analysis, 2014” në Shqipëri konkludojnë se disa biznese kanë deklaruar që të punësuarve mungojnë aftësitë e duhura për të kryer punën e caktuar në sektorët “informacionit dhe komunikimit”, “aktivitetet financiare dhe të sigurimit”, “aktivitetet e pasurive të patundshme “ dhe”sferave profesionale, shkencore dhe teknike“, pasi ato janë specifike dhe kërkojnë aftësitë lartë profesionale dhe teknike (ILO / SHKP, 2014: 41). Edhe studjuesit e rajonit konstatojnë se të diplomuarit nga institucionet e arsimit të lartë shpesh nuk janë të pajisur me aftësitë që janë të rëndësishme për nevojat e tregut. Si pasojë, punëdhënësit në rajonin e Ballkanit

Perëndimor shpesh ankohen se forcat e reja që hyjnë në tregun e punës nuk kanë gamën e

tyre produktiv (Arandarenko & Bartlett, 2012). Prandaj një nga konkluzionet e rëndësishme është realizimi i studimeve të vazhdueshme për nevojat e tregut që të ketë në fokus të diplomuarit nga arsimi i lartë. Studimet e tregut do të ndihmonin si bizneset ashtu dhe institucionet e arsimit të lartë në zhvillimin e strategjive të tyre për orientimin e aktiviteteve të tyre dhe programeve studimore. Qeveria nga ana e saj duhet të jetë më e ndjeshme ndaj përmbushjes së rolit rregullator në kushtet e ekonomisë së tregut, jo vetëm duke i orientuar institucionet e arsimit të lartë, por mbi të gjitha duke monitoruar standardet e cilësisë së tyre dhe standardet e profesioneve, si për institucionet publike, edhe për sektorin privat. Në procesin e punësimit nuk ka negociata dhe kontrata të qarta individuale dhe kolektive të punës. Në Shqipëri, certifikata e profesionit i cili verifikon dallimet në nivelin e aftësive të nevojshme në procesin e zhvillimit të karrierës mungon për shumicën e profesioneve. Funkcioni i kontrollit social nga ana e shtetit është vendimtar për të shmangur dekurajimin e të diplomuarve të rinj si profesionistë. ILO në Programin e Punësimit Rinor thekson se “Për trajtimin e punësimit të të rinjve kërkohej një qasje e integruar, duke kombinuar politikat mbështetëse ekonomike dhe politikat aktive të punësimit për të siguruar balancimin e kërkesës dhe ofertës në tregun e punës”.



#### **IV. Reflektime mbi politikat për një zhvillim të qendrueshëm**

Nevoja e lidhjes së universiteteve me tregun e punës për të rritur efektivitetin në investimet e shoqërisë për arsimin e lartë është e rendësishme që programet e studimit t'i përgjigjen dinamikës së zhvillimit shoqëror dhe ekonomik, duke lehtësuar edhe tranzicionin e të diplomuarve në fuqi punëtore të kërkuar nga tregu i punës. Disa nga rezultatet këtij studimi dhe rekomandimet janë në lidhje me orientimin më të mirë të fushave, programeve dhe kurrikulave universitare drejt degëve prioritare të zhvillimit ekonomik, orientimi i arsimit të lartë për një lidhje të teorisë me praktikën dherespektimin e standardeve të cilësisë. Po ashtu, orientimi i institucioneve të arsimit të lartë në projekte kërkimore, ku stafi akademik dhe studentët të angazhohen në zgjidhjen e një problemi të vërtetë të shoqërisë shqiptare, do të rrisë aftësimin e të sapodiplomuarve për shprehitë e kërkuara në treg. Universitetet dhe studentët kanë nevojë të kenë më shumë informacion rreth punëve në dispozicion, rreth degëve prioritare të zhvillimit shoqëror, që ata të dinë se ku do ta drejtojnë formimin e profesioneve dhe programet/kurrikulat e studimeve universitare. Universitetet dhe të diplomuarit duhet të vazhdojnë komunikimet mbi destinacionet e punësimit të të diplomuarve si një mënyrë për të vlerësuar më mirë nevojat e tregut të punës. Paralelisht, të përmirësohen shërbimet këshilluese të karrierës nga IAL-të dhe nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit. Po ashtu, vlerësimet e dinamikave të zhvillimit ekonomik e shoqëror dhe nevojave të tregut të punës duhet të fokusohen në rritjen e punësimit të fuqisë punëtore me arsim të lartë. Aktivizimi i politikave të tregut të punës për të diplomuarit e rinj, nxitja e praktikave profesionale dhe internshipeve përmes lidhjeve të IAL me jetën ekonomike dhe sociale në vend, do të rrisë kualitetin e të sapodiplomuarve, do t'i shërbejë përmirësimit të perspektivave të ardhshme të punës së të diplomuarve dhe do t'i kursejë kosto biznesit. Ndryshimet në Kodin e Punës në fund të vitit 2015 pritet ta lehtësojnë këtë zbatim të praktikës profesionale dhe internshipeve. Një politikë e re industriale është e

nevojshme për të lidhur investitorët vendas dhe të huaj për të nxitur bizneset vendase që punësojnë të diplomuar. Politika industriale duhet të mbështesë punëdhënësit për të investuar në risitë dhe proceset që rrisin kërkesën për punëtorë me kualifikim të lartë dhe hapjen e vendeve të punës që kërkojnë aftësi dhe njohuri bashkëkohore. Vetëm kështu bizneset e brishta shqiptare do mund të përballojnë konkurrencën në rajon dhe në hapjen e tregut ndaj vendeve të BE. Qeveria ka nevojë të mbështesë programet e sipërmarrjes për të ndihmuar të diplomuarit në ngritjen e bizneseve të tyre me subvencione për pajisje, që ata të mos shohin vetëm mundësinë e punësimit, por edhe të vetëpunësimit. Po ashtu, të mbështeten punëdhënësit, sidomos bizneset e vogla që dominojnë tregun shqiptar, për të ofruar programe trajnimi për të sapodiplomuarit. Punëdhënësit t'u sigurohen stimuj për të marrë praktikantë dhe programi i qeverisë në këtë drejtim i nisur me Vendimin Këshillit të Ministrave nr. 873, datë 27.12.2006 për të diplomuarit e rinj, të zbatohet plotësisht. Të diplomuarit të inkurajohen për t'u punësuar jashtë Tiranës, për të mundësuar një zhvillim harmonik të territorit të vendit. Universitetet rajonale kanë nevojë për një orientim më të mirë në promovimin e zhvillimit rajonal të qendrueshëm. Reforma e ndarjes së re territoriale do t'i vendosi bashkitë e mëdha përballë sfidave të planifikimit rajonal dhe nevojës së bashkëpunimit më të ngushtë mes institucioneve të arsimit të lartë që veprojnë në territoret e tyre, me agjencitë publike dhe privatetëpunësimit, organizatat e biznesit apo dhomat e tregëtisë dhe industrisë. Të gjithë aktorët, si politikbërësit, universitetet, zyrat e punësimit, bizneset dhe shoqatat e studentëve të bashkërendojnë aktivitetet e tyre në nxitjen e faktorëve që çojnë në një zhvillim të qendrueshëm, në rrugën e Shqipërisë drejt integritimit rajonal dhe evropian të vendit, mundësuar zhvillimin e kapitalit social si faktori kryesor i suksesit.

## Thesare me monedha antike të gjetura në Shqipëri (shek. V-I p.e.sonë) ...thesare me monedha antike që konfirmojnë qëndrueshmërinë në kulturën tonë...

**O**bjekti i studimit tim në këtë punim është monedha e shprehur në gjuhën e përditëshme, pra paraja.

Ky botim kontribuon në fushën e Numizmatikës. Numizmatika është një degë e veçantë e arkeologjisë. Çdo ditë në gërmimet arkeologjike dhe gjatë botimeve gjenden një numër i madh monedhash. Një pjesë prej tyre patën humbur rastësisht: këto janë në përgjithësi monedha prej bronzi, që nuk kishin ndonjë vlerë të madhe. Të tjerat, prej argjendi, kanë qenë fshehur nga pronarët e tyre për t'i siguruar: janë pikërisht këto që numizmatët i quajnë “thesare”; ato që nuk kanë qenë marrë përsëri nga pronari i tyre para se të vdiste kanë mbërritur deri te ne, 20 apo 25 shekuj pas fshehjes së tyre.

E kam botuar në gjuhën shqipe ....

Qysh në lashtësi njerëzit kanë qenë të ndërgjegjshëm për ndikimin e madh që kishte paraja. Sipas Platonit, shumica e njerëzve ka dëshira dhe nevoja të pafundme, edhe pse kanë mundësinë të kenë fitime të mëdha, pushtohen nga dëshira e pangopur e fitimit, “asnjë nuk ngopet kurrë nga pasuria: vetëm paraja nuk të pështiroset kurrë”.

Jashtë këtij aspekti, monedhat kanë vlerë si dokumente historike, për vetë mënyrat dhe paraqitjet e tyre të ndryshme, gjithmonë në funksion të detyrës së lehtësimit të shkëmbimeve. Edhe si një monedhë e thjeshtë, ajo shpreh një gjuhë simbolesh që dëshmojnë për historinë.

Në territorin e Shqipërisë, të banuar në lashtësi nga ilirët edhe epirotët, zhvillimi i shkëmbimeve



tregtare ka sjellë shkallë-shkallë përdorimin e monedhës, si pasojë edhe daljen, në një periudhë të caktuar, nga sistemi i thjeshtë i këmbimit mall me mall, i cili nuk përshtatej më me nivelin e zhvillimit ekonomik që kishte bërë hapa përpara. Thesari i Torovicës, i përbërë nga 124 sèpata, të cilat kanë përmasa afërsisht të përngjashme, përbën një nga dëshmitë e rëndësishme të këtij këmbimi paramonetar, realizuar qysh në periudhën e hershme të hekurit. Zbulimi i tyre në formën e thesarit, tipologjia dhe teknika standarde e punimit të tyre, peshat përafërsisht të njëjtoja dhe në mjaft raste identike e kanë lejuar prof. Prendin, studiuesin e këtij thesari, që ta përfshijë këtë gjetje në një farë sistemi metrologjik organik për atë kohë. Ky thesar me sopata, si dëshmi e sistemit paramonetar, ka paraprirë librin tim mbi thesaret

Rrënjët e monedhës ose, thënë ndryshe, zanafillën e historisë së parasë në Ilirinë e Jugut dhe në Epirin e Veriut duhet ta kërkojmë shumë larg në kohë, rreth 2400 vjet më parë, kur ajo u pre për herë të parë në këto troje në të cilat ne banojmë sot, ose akoma

edhe 100 vjet më herët, kur ajo filloi të përdorej këtu e futur nga jashtë, pra nga treva me një zhvillim më të hershëm politik dhe ekonomik.

Qarkullimi monetar në territorin e Shqipërisë (Iliria e Jugut dhe Epiri i Veriut) në shek. V-I p.e.s përbën një nga burimet e informacionit më të rëndësishme mbi ekonominë dhe politikën në territor. Ky qarkullim na është bërë i njohur nga tre burime:

- Monedhat e gjetura në gërmimet arkeologjike që përbëjnë edhe burimin kryesor.
- Monedhat e gjetura rastësisht në qendrat antike, të dhuruara nga koleksionistë privatë ose edhe të blera prej tyre.
- Thesaret e gjetura në territorin shqiptar gjatë gërmimeve arkeologjike ose edhe rastësisht. Janë 41 thesare, që u përkasin shekujve V-I p.e.s.

Në këtë vëllim janë trajtuar thesaret, si dhe në problemet shumë të rëndësishme që dalin prej tyre. Në kuadrin e një studimi të plotë të thesareve që ndodhen në kabinetin numizmatik të Institutit Arkeologjik, janë rimarrë për studim edhe disa thesare të botuara më parë, dhe kjo për dy arsye: së pari, sepse një pjesë e tyre në botimet e mëparshme nuk është shoqëruar me një dokumentacion të plotë dhe me fotot e monedhave ose, edhe në ato raste kur shoqërohet me to, ato janë të një niveli mjaft të dobët, dhe së dyti, sepse është ndër nevojshme të bëhet një studim tërësor për të arritur në përfundime të rëndësishme lidhur me rolin që ka pasur monedha në territorin iliro-epirot në periudha të caktuara historike, duke ndjekur dinamikën e brendshme të historisë politike dhe ekonomike të popullsisë që e përdorte. Shumë herë monedha ka shërbyer si një burim i rëndësishëm për historinë politike të territorit ilir, për më tepër në mungesë të burimeve të shkruara.

Jashtë aspektit kryesor të rolit të monedhës për lehtësimin e shkëmbimeve brenda qytetit ku ishte prerë apo dhe jashtë tij, tërësia e thesareve flet njëherazi edhe për ngjarje politike, ekonomike, diplomatike dhe ushtarake, si dhe për marrëdhënie midis qytetesh e shtetesh në periudha të caktuara historike.

Në përbërjen e thesareve të gjetura në territorin

shqiptar ka staturë të Eginës, të tipit me breshkë, të prera për herë të parë në botën greke nga ky qytet në vitet 550-525 p.e.s., pra, pas Lidisë në Azinë e Vogël, të cilat luajtën një rol shumë të rëndësishëm në qarkullimin monetar në antikitet. Këto janë monedhat më të hershme të gjetura në thesarin e Hollmit. Një monedhë e njëkohshme me ato të Eginës është edhe monedha me dy delfinë, e prerë në Tera dhe që bën pjesë gjithashtu në thesarin e Hollmit. Nuk mbeten jashtë thesareve tona as edhe tetradrahmet e famshme të Athinës, të quajtura ndryshe “bufat e Athinës”, që ndodhen në thesarin e Hijes së Korbit, ku ato përfaqësohen me prerjet më të hershme të këtij qyteti, në shekullin V p.e.s. “Pegasët e Korinthit” dhe të kolonive të tij bëjnë pjesë në thesaret e Butrintit, Kreshpanit, Foinikes, Antigonesë dhe Dërmishit. Këto monedha, pavarësisht nga ndryshimet stilistike që pësuan në kohë, patën një ndikim të madh në qarkullimin monetar në Iliri.

Maqedonia, e përfaqësuar me mbretërit e saj, zë edhe ajo një vend të rëndësishëm, sidomos në thesarin e Hijes së Korbit dhe në atë të Durrësit.

Tetradrahmet dhe drahmet e Filipit II, Filipit III dhe të Aleksandrit të Madh, të prera pas vdekjes së tij, dhe sidomos drahmet të pasuara nga tetradrahmet e Antigon Gonatës, e zgjeruan zonën e qarkullimit të tyre. Në thesarin e Hijes së Korbit përfaqësohen monedha të prera në më shumë se 20 punishte monetare të Azisë së Vogël, gjë që i jep atij vlerën e një dokumenti historik për njohjen e politikës monetare të Maqedonisë pas vdekjes së Aleksandrit të Madh.

Janë të pranishme edhe monedha të tjera të botës greke mjaft të njohura, si monedhat e Korkyrës, Histias, Halkisit, Sikionit, Thasosit etj.

Është fjala, pra, për prani të monedhave më përfaqësuese të botës greke, të cilat luanin një rol shumë të rëndësishëm ndërkombëtar, i lidhur ky jo vetëm me famën e qytetit që e kishte prerë, por edhe me dëshirën për të favorizuar një treg më të gjerë. Këto monedha, jo vetëm që lehtësonin shkëmbimet tregtare, por u përgjigjeshin edhe nevojave të luftërave, të cilat kërkonin shpenzime të mëdha financiare.

Gjetja e monedhave më të rëndësishme të botës greko-maqedonase në thesaret tona nuk është e lidhur detyrimisht edhe me kohën e prerjes së tyre. Për vetë vlerën dhe rolin që kanë luajtur në qarkullimin monetar ndërkombëtar, ato kanë qarkulluar në një periudhë më të gjatë kohore se sa koha e prerjes së tyre.

Në thesaret e gjetura në Shqipëri në shekujt V-I p.e.s. vendin kryesor e zënë monedhat e prera në vend dhe pikërisht drahmet prej argjendi të dy qyteteve të mëdha, si Dyrrahu dhe Apolonia, të cilat luanin rolin kryesor në qarkullimin monetar dhe në marrëdhëniet midis tyre dhe qyteteve ilire, si dhe më gjerë me Korkyrën, Korinthin, Maqedoninë dhe botën greke në përgjithësi.

Thesaret e gjetura në Shqipëri përbëhen kryesisht nga monedha argjendi ose bronzi, por ka edhe thesare në të cilat janë të përziera monedha argjendi dhe bronzi. Statistikisht na rezulton se 21 thesare përbëhen nga monedha argjendi, 13 prej bronzi, 6 janë të përziera dhe vetëm një thesar, për të cilin të dhënat i kemi të pakta (thesari i Kupa 1939, CH. 32), përbëhet nga një monedhë ari dhe 21 monedha argjendi.

Në bazë të natyrës së përbërjes së tyre, thesaret i kemi ndare në katër kategori:

1. Thesare rastësore, të gjetura kryesisht në lartësi, në zona të pamësuar me përdorimin e monedhës, që pasqyrojnë periudha trazirash politike në territoret fqinje të Ilirisë. I tillë është thesari i Hollmit (Kolonjë), i cili duhet të jetë fshehur rreth vitit 430 p.e.s. gjatë pushtimit të Eginës nga athinasit.

2. Thesaret me qëllim kursimin / kapitalizimin. Bëhet fjalë për grumbuj homogjenë monedhash, të cilat pronari i ka hequr nga qarkullimi muaj pas muaji apo vit pas viti. Në këto thesare ndodhen monedha që i përaftron sistemi metrologjik (ponderal), pra janë monedha të prera me të njëjtën peshë nga qytete që kishin marrëdhënie midis tyre ose nga zona homogjene që përdornin të njëjtin sistem monetar (thesari i Kreshpanit, Durrës 2006, Cakran 1962, Pllanë (Lezhë) 1960, Finiq 2008). Një aspekt tjetër është se këto thesare përbëhen nga monedha të përzgjedhura, duke favorizuar metalin e çmuar dhe me vlerë më të lartë në krahasim me

atë me vlerë të ulët. Si rrjedhim, ato na krijojnë një vizion që deri diku nuk përputhet me realitetin e qarkullimit monetar në vend, mbështetur në gjetjet e gërmimeve apo në ato të rastit. Bëhet fjalë zakonisht për monedha me vlerë të madhe, si argjendi, të cilat na japin të dhëna të rëndësishme për marrëdhëniet midis qyteteve tona dhe botës përreth, kryesisht Korkyrës e Korinthit.

3. Thesare të luftës, Këto thesare karakterizohen nga prania e një numri monedhash me vlerë që kanë shërbyer për të paguar ushtarët ose mercenarët. Ato gjenden shpesh sidomos në zonat e përfshira nga ngjarje të mëdha politike-ushtarake. Të dyja grupet e thesareve janë të lidhura me ngjarjet ushtarake të zhvilluara në territoret përkatëse në 171-168 p.e.s., siç është rasti i fushatës ndëshkuese të vitit 168 p.e.s., të ndërmarrë nga konsulli romak Pal Emili në Epir, i cili shkatërroi atje një numër të madh qytetesh.

Me ngjarjet e luftës së tretë iliro-romake ku Genti ishte protagonist janë të lidhura thesaret e gjetura në Shkoder, Jubice, Kopluk, Lezhe dhe Renc, të cilat janë të perbere teresisht ngadrahme të Dyrrahut dhe Apollonise me perjashtim të thesarit të Rencit që ka monedha të mbretit Gent dhe Balaj në sasira të vogla.

Sipas Tit Livit, mbreti Gent, pasi kishte grumbulluar në Lisos 15000 veta, u hodh në sulm kundër qytetit Basania që ishte vetëm 5 milje larg tij. Qëndresën e fundit ndaj romakëve Genti e bëri në Shkodër, por edhe aty pësoi një disfatë dhe u detyrua të dorëzohej.

Nje nga momentet me të rëndësishme të historisë është periudha e luftimeve civile për pushtet midis Cezarit dhe Pompeit që filloi në Itali, kaloi në Ilirine dhe jugut dhe një pjesë e ngjarjeve luftarake u zhvilluan në krahinat midis Apollonise dhe Dyrrahut. Në fushatën e tij në Iliri, Cezari pati si baze kryesore në veprimet e tij Apollonine.

Prania e gjatë e ushtrisë së Pompeit dhe Cezarit në territorin e Dyrrahut dhe Apollonise dhe me gjere krijoi një gjendje të vështirë ekonomike por edhe një pasiguri për gjithë territorin që u prek nga kjo luftë. Sipas Cezarit mesojmë se në përfundim të luftës ai duhet të shkonte në Apolloni për të lenë të plagosurit, për të paguar ushtarët, për të vendosur garnizone etj. Ky tregim i Cezarit na lejon të mendojmë se një sasi



e konsiderueshme e monedhash romake duhet te kete mbetur ne Apolloni si pagese e bere ushtareve. Jemi te prirur te mendojme se thesari i Apollonise, i perbere nga 1875 denare romake, duhet ti perkase kesaj pagese, per me teper se pjesa me madhe e monedhave i perkasin viteve 48-45 p.e.s. d.m.th kohes se sundimit te Cezarit. Pra ne kohen e Cesarit kemi nje vershim te madh te denarit romak, i cili eshte shkaktuar nga nevoja qe i dilte atij per te perballuar shpenzimet e luftes dhe per te mbajtur ne kembe ushtrine e tij. Edhe punishtja e Apollonise u kthye ne sherbim te tij.

4. Thesare me monedha bronzi të prera nga Dyrrahu dhe Apolonia, të thesaruara në periudhën e mesit të shekullit I p.e.s. Ato përfaqësojnë tipat kryesorë të monedhave të këtyre dy qyteteve, që qarkullojnë me shumicë në tregjet kryesore ilire dhe që kanë një ndikim të madh në qarkullimin monetar vendas. Rastet e thesarizimit të këtyre monedhave shpjegohen me situatat e vështira ekonomike të periudhës, të lidhura me reforma të mëdha monetare të ndërmarra kryesisht nga Apolonia, e cila është e detyruar t'i heqë nga qarkullimi dhe t'i zëvendësojë me monedha të tjera, qe i pershtaten sistemit monetar romak. (denarit dhe as dypondius etj) Të tilla janë thesari i Dimalit, 5 thesare bronzi gjetur në Apoloni me rreth 1354 copë monedha, si dhe thesari i Cakranit me 2352 copë.

Në studimin tonë jemi munduar të bëjmë dallimin midis një thesari që shpreh qarkullimin monetar në vend dhe një thesari që është akumuluar si rezultat i grumbullimit shumëvjeçar dhe i kursimeve për një kohë të gjatë të poseduesit të tij. Kjo është e lidhur edhe me metodologjinë e kërkimeve sot në fushën e numizmatikës, ku shihen arritje të mëdha. si dhe dallimin e një thesari me destinacion kryesisht ushtarak, monedhat e të cilit kanë shërbyer për të paguar mercenarët që merreshin në luftëra. Pra, jo gjithnjë një thesar i gjetur në një zonë të caktuar është ekuivalent me qarkullimin monetar në atë zonë.

Permbajtja e thesareve flet per tre kategori pronaresh te tyre: te paret mund te jene ushtare vendas, te rekrutuar ne luftrat qe zhvillonte Roma ne Iliri, Epir apo Maqedoni, te dytet lidhen perseri me vendas

por qe aktivitetin e tyre ushtarak e kane kryer jashte territorit ilir apo epirot. Ne te dyja rastet pronaret pasurine e tyre te perfituar nga luftrat si shperblim ia kane besuar tokes ne vendin e tyre. Kategoria e trete perfshin ata pronare vendas apo te huaj qe pasurine e tyre te grumbulluar ne vite e fshehin per arsye te situatave te pasigurta qe krijojne luftrat ne territorin ku banojne.

Studimi i thesareve në tërësi ka bërë të mundur që të njohim historinë e monedhës dhe evolucionin që ajo ka ndjekur në etapa të ndryshme, qarkullimin monetar në zonën ku ato janë gjetur; të dallojmë diferencat midis zonave ku ka qarkulluar monedha, rolin që ajo ka luajtur në tregun e brendshëm, por edhe atë të jashtëm.

Botimi i këtyre thesareve është bere mbi bazën e një klasifikimi të mbështetur në një literaturë bashkëkohore. Konsultimi i kësaj literature dhe krahasimi i thesareve midis tyre ka konfirmuar dhe, në ndonjë rast, edhe ka ndryshuar kronologjinë e dhënë më parë për monedhat e prera në punishtet e qyteteve antike të territorit tonë. Nga ana tjetër, studimi i vulave të monedhave të prera në Dyrrah dhe Apoloni, na ka bërë të mundur të njohim intensitetin e prerjeve në punishtet e tyre, monedhat e të cilave përbëjnë pjesën më të madhe të thesareve dhe kanë luajtur rolin kryesor në qarkullimin monetar vendas.

Katalogu i monedhave, i cili shoqëron çdo thesar, është hartuar mbi bazën e një skede teknike që përmban tipin e monedhës, të përshkruar si për faqen, ashtu edhe për shpinën, numrin rendor, peshën, diametrin, referencën bibliografike kur kjo ekziston dhe numrin e inventarit. Monedhat e përzgjedhura për t'u ilustruar në tabelat që ndodhen në fund të vëllimit mbajnë numrin e tabelës krahas numrit rendor të monedhës. Çdo thesar ka tabelat ilustruese të veçanta dhe të emërtuara.

Ky punim është nje kontribut edhe ne fushen e Onomastikes, nga studimi i emrave te perdorur ne faqe dhe ne shpine te monedhave është perpiluar nje listem midis te cilave vlen te permendim emrat ilir si Boiken, Gent, Monun etj.

Prof. dr. Mimoza Gjokutaj,  
Universiteti i Tiranës, Fakulteti Filologjisë  
Dr. Irida Hoti, Dr. Drita Kadriu

## “Fjalor termash në Edukim”

### Risi në fushën e Terminologjisë

**F**jalori “Fjalor termash në edukim” me karakter shpjegues, krahasues, vjen si një vepër e kërkuar dhe e domosdoshme për një rreth të gjerë përdoruesish. Në këtë fjalor, me 874 faqe përfshihen 5000 terma në 11000 shpjegime. Në përgjithësi të gjithë termat janë me mbi dy kuptime, të cilat në fund të fjalorit grupohen në tregues termash, ku secilës fjalë a grup fjale i pranëvitet edhe shumësia e shpjegimeve përkatëse. Kjo është edhe një risi në fushën e terminologjisë që vjen përmes këtij fjalori. Nisur nga fjala çelës që e kanë të përbashkët janë të grupuara grupe fjalësh duke shtuar terminologji të fushës duke krijuar edhe fusha semantike dhe familje fjalësh. Termat krahas shpjegimit përkatës janë shoqëruar edhe me një tog shembujsh, ku jepen përdorimet kryesore të termit përkatës në fushën e edukimit. Termat e vjelë nga fjalorë dhe enciklopedi, libra në fushën e edukimit (edhe me glosarë), burime nga interneti dhe organe periodike, të shoqëruar edhe me fjalorth a fjalëshpjegues paraqesin një hulumtim shterues të autoreve, të cilat i kanë pasuruar edhe me shpjegime autoriale (1000 shpjegime autoriale), qofshin shpjegime të reja apo kuptime shtesë. Termat e përkthyer nga fjalorë të huaj (përgjithësisht në gjuhën angleze) kanë pasuruar struktura fjalësh me kuptimin që mbartin në vetvete, me qëllim përdorimin dhe pasurimin e terminologjisë në fushën e Edukimit. Risi tjetër e këtij fjalori është edhe referenca përkatëse për secilin term të shpjeguar, e cila mund të shërbejë jo vetëm si burim për studiuesit në kërkimet e tyre, por edhe në pasurimin e këtij fjalori në të ardhmen nga vetë autorët. Fjalori është ndërtuar mbi kriteret shkencore dhe hartueset përmes metodës krahasuese kanë kërkuar dhe hulumtuar në terminologjinë e fushës së edukimit, duke vjelë nga një fjalor në tjetrin, nga një botim në një tjetër e deri tek termat autorialë, me qëllim gjetjen e kuptimeve të



përafërta, (sinonimike, antonimike, homonimike etj.) të një termi a grupi termash.

Fjalori është praktik: Termat / fjalët janë renditur alfabetikisht.

Fjalët që i përkasin një çerdheje, janë vendosur alfabetikisht. p.sh. kërkim, kërkuj, kërkuar (i,e).

Për çdo term është shënuar me shkurtimet përkatëse pjesa e ligjëratës (emër, mbiemër etj.), veçoritë gramatikore të saj, ligjërimi (libror, bisedor etj.), të cilit i takon termi dhe fusha e përdorimit të tij. Kuptimet e termave kanë një numër rendor, i cili përkon me të njëjtin numër reference të vendosur poshtë shpjegimeve. Për lehtësi përdorimi ndihmon fjalësi i vendosur në fund të fjalorit. Nëpërmjet këtij fjalori mund të shihet edhe evoluimi i termave në vite, si edhe terminologjia e re, fjalë që nuk gjenden në Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe, por që përdoren dendur në fushën e edukimit. Tipari themelor i këtij fjalori, prirja për t’u thelluar në shumëkuptimësinë e fjalëve a grupeve të fjalëve, në paradigma dhe struktura të shumëllojshme përdorimi bën që ky fjalor të ketë një shtrirje të madhe përdorimi.





*Dhjetor 2012, themelimi i Rrjetit Shqiptar të Grave në Shkencë*





Fondacioni "Friedrich Ebert" – Zyra e Tiranës  
Rr. Abdi Toptani, Torre Drin, Kati III  
P.O.Box 1418  
Tel: 00355 (0)4 2250986 / 00355 (0)4 2273306  
E-mail: [info@fes-tirana.org](mailto:info@fes-tirana.org)  
Homepage: <http://www.fes-tirana.org>